

Truth-seeking and Truth-telling Mechanisms for Establishing the Truth about Past

**Përkthimi i ligjeratave të Mark Freeman-it¹ në trajnimin për
aktivistë të organizatave joqeveritare për të drejtat e njeriut,
organizatave të rinjëve dhe anëtarëve të shoqatave të viktimave**

26-27.05.2008, Bëograd

**I Njohje me komisionet për të vërtetën dhe organeve
tjera të ngjashme.**

Quhem Mark Freeman dhe punoj për Qendrën Ndërkombëtare për Drejtësinë Tranzicionale me seli në Bruksel. Kam kënaqësinë që sot kam rastin të jem këtu me ju! Në fillim do të falënderoja partnerët tanë dhe nikoqirët e kësaj ngjarjeje, Fondin për Drejtën Humanitare, Qendrës Hulumtuuese-dokumentuese dhe Dokumenta-së. Gjithashtu dua që të falënderojë të gjithë ju, disa prej të cilëve vini nga jashtë Serbisë vetëm për këto dy ditë. Në esencë, ideja është që gjatë këtyre dy ditëve të prezantohen komisionet për të vërtetën dhe organet tjera të ngjashme, por në veçanti komisionet e së vërtetës ngaqë jemi të vetëdijshëm që ekzistojnë ide të ndryshme lidhur me komisionet për të vërtetën. Në fakt në veçanti në këtë rajon unë mendoj që ka shumë moskuptime lidhur me komisionet për të vërtetën, dhe sëkëndejmi unë do të mundohem që gjatë këtyre dy ditëve të prezantoj fakte lidhur me komisionin për të vërtetën dhe gjithashtu uroj që programi i përpiluar të na mundësojë një gjë të tillë. Unë këtë gjë e bëj jo pse komisionet për të vërtetën janë gjëja më e mirë apo më e keqe por ngaqë dua që të prezantoj fakte dhe që ju ti keni në dispozicion për të qenë në gjendje që vetë të gjykoni. Unë gjithashtu e di që shumë prej jush tashmë jeni të njohur me punën e komisionit për të vërtetën, dhe supozoj që shumë prej jush kjo që do të prezantoj sot mund të mos jetë gjë

e re, andaj ju lus që të kenë durimin në fillim që unë të sqarojë disa terme themelore për të kaluar më pas në disa terme më konkrete. Dhe ja duke shikuar këtë program, unë tridhjetë apo dyzet minutat e parë do ti kalojë duke folur për gjëra themelore të nevojshme për të krijuar një bazë të mirë për ato që do të dëgjojmë më pas, posaçërisht për disa përzgjedhje që i kanë bërë disa shoqëri. Pastaj, natyrisht do të keni mundësinë që të parashtroni pyetje dhe të diskutoni etj. Në seancën e parë do të ketë mjaft kohë për në gjë të tillë por në fillim do të njoftoheni me të dhënat elementare. Në seancën e dytë pasdite do të fillojë nga komisioni i parë i filluar që nga fillimi duke parashtruar këtu të dhënat kryesore, ato pozitive dhe negative për komisionet e së vërtetës që nga fillimi i themelimit të tyre deri më sot, kështu që do të keni një pasqyrë historike të cilin do ta ndërlidhni me teori dhe koncepte të ndryshme. Gjatë ditës së nesërme di të flasim për dy aktivitete themelore të caktuara të komisionit për të vërtetën, dhe njëra nga ato aktivitete janë dëgjimet publike. Siç do të mësojmë jo të gjitha komisionet e së vërtetës kanë mbajtur dëgjime publike, por që janë pikërisht dëgjimet publike meritore për interesimin e madh që kanë zgjuar sot në botë komisionet për të vërtetën. Në fund të prezantimit tim do tua shfaq një film timin njëorësh për katër komisione të ndryshme të së vërtetës dhe aktiviteteve të tyre-bisedat me viktimat dhe dëshmitarë, mbajtjen e dëgjimeve publike, përpilimi i draft raporteve si dhe aktivitete tjera ,të cilat shpresoj do të ju japin një pasqyrë më

1. Mark Freemani është drejtor i zyrës së Qendres Ndërkombëtare për Drejtësi në Tranzicion në Bruksel

të thelluar të njohurive konkrete mbi atë se çfarë bejnë dhe me se merren komisionet për të vërtetën, dhe posaçërisht, në fund të ligjëratës sime do të flas për raportet finale të komisionit për të vërtetën. Secili komision për të vërtetën ka për mandat të jap raportin e vet përfundimtar ku do ti jap konkluzionet e veta për faktet dhe rekomandimet për tu përballur me krimin, si dhe masat që duhet ndërmarrë për tu siguruar që krimi më mos të ngjajë. Pra do ti prekim disa aspekte shumë praktike të komisionit për të vërtetën. T'u them serish që nuk e kam për qëllim të ju bind në asgjë, por që t'u paraqes të dhëna të diskutojmë dhe ju të parashtroni pyetje. Gjatë ditës së nesërme që do të jetë ligjëratë ime e fundit do të ndajmë një orë e gjysmë nga koha, varësisht nga interesimi juaj mund ta zgjasim apo shkurtojmë për të kaluar edhe njëherë nëpër ligjëratën time dhe të mundohemi që ato të dhëna ti vëmë në shërbim të një diskutimi më të thellë mbi idenë që ka lindur në këtë rajon për të themeluar komisionin për të vërtetën, për të parë se cilat përvoja pozitive apo negative, gjithnjë sipas mendimit tuaj, mund të merren parasysh gjatë realizimit të këtij projekti madhor. Në fund do të ndajmë kohë për disa vërejtje përmblyëse, përfundime dhe diskutime për hapat e mëtuqeshëm. Kjo është përafërsisht ajo çfarë desha të them në hyrjen time. Do të mundohem të flas më ngadalë për përkthyesit apo dikë tjetër, vetëm ngritni dorën dhe më bëni me dije, unë do të ngadalësojë. Tani jam i gatshëm të kalojë në ligjëratën e parë por para kësaj, do të doja të theksojë edhe njëherë se cili është qëllimi i këtij programi. Në rregull.

Në fakt në fillim do të flas për të drejtën ndërkombëtare. Dhe jo pikërisht për të drejtën ndërkombëtare sepse shumica këtu nuk jeni juristë dhe kjo nuk është tema e kësaj punëtorie, por konsideroj që është e rëndësishme të dimë se çfarë thotë e drejta ndërkombëtare sa i përket të vërtetës dhe vërtetimit të fakteve. Secili shtet ka një kornizë të gjerë të obligimeve të drejtave të njeriut – duke pasur të drejtën që penalisht të ndjekin kryesit e veprave penale dhe kanë gjithashtu për obligim që të sigurojnë riparimin për viktimat të caktuara të krimeve, kanë për obligim që të implementojnë reforma të caktuara dhe të hulumtojnë krimet e kryera në atë shtet dhe të hulumtojnë faktet lidhur me ato krime. Madje në një kuptim më të gjerë disa pohojnë që shtetet kanë obligime edhe më të mëdha specifike për të hulumtuar tërë periudhën kur kanë ngjarë krimet, që të vërtetojnë emrat dhe shkaqet e vdekjeve të viktimave, dhe krimet të tjera që nuk kanë për pasojë vetëm vdekjen, që të vërtetojnë identitetin e viktimave dhe dhe në kuadër të atyre obligimeve që të hulumtojnë krimet dhe të zbulojnë krim-bërësit. Pra ekzistojnë terme të ndryshme por secili shtet ka obligimet e veta sado të pakta që janë dhe pikërisht kjo përbën bazën e diskutimeve tona të sotme. Gjithashtu duhet të përmendim që këto obligime të shteteve paraqesin edhe të drejtat e dikujt. Në këtë kuptim, individët, më

konkretisht viktimat dhe familjet e viktimave, kanë të drejtë që të dinë të vërtetën. Vetëm para disa vitesh Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave të Kombeve të Bashkuara për herë të parë ka miratuar Rezolutën për të drejtën për të vërtetën, kështu që ky obligim përbën veten e dytë të viktimave dhe familjeve të viktimave që të mësojnë dhe të dinë për krimet e tmerrshme të kryera. Por nocioni e drejta për të vërtetën është më i gjerë dhe nënkupton që edhe idenë që edhe shoqëria të dijë të mësojë për të vërtetën, Do të thotë jo vetëm viktimat dhe familjet e viktimave e kanë të drejtën për të mësuar të vërtetën, por edhe shoqëria në tërësi duhet që të dijë për shkeljet e rënda të drejtave të njeriut. Pra nuk do të flas më për të drejtën, por desha që ta shfrytëzojë këtë si pikë fillestare për të sqaruar sesi shtete të ndryshme kanë interpretuar apo janë përpjekur të interpretojnë të drejtën e individit apo të shoqërisë për të vërtetën. Ky seminar mban titullin „Seminar mbi Komisionin e së vërtetës dhe organeve të ngjashme“ dhe tema e tij është komisioni për të vërtetën përkatësisht disa fakte, dhe mite mbi komisionin për të vërtetën. Është shumë me rëndësi që të kuptojmë që mund të ekzistojnë një sërë organesh të cilat mund të kenë për synim të verifikojnë faktet dhe të tregojnë për to. Madje edhe në këtë rajon mund të marrim disa shembuj të organeve të tilla të themeluara qoftë në nivelin zyrtar apo jozyrtar. Në nivel zyrtar këtu në Serbi ka qenë themeluar Komisioni për të Vërtetën dhe Pajtim dhe pa qëllim të jem i paedukatë, mendojë që ky komision shënon shembullin më të mirë sesi nuk duhet të jenë komisionet apo si nuk duhet punuar në to. Por ka qenë një komision tjetër këtu në këtë rajon. Dhe pranë saj ka patur komisione të tjera dhe organe hetuese që janë themeluar. Edhe para formimit të MKTJ-së, Këshilli i Sigurimit ka themeluar komisionin Hetimor në terren. Ai nuk ka qenë një komision për të vërtetën por ka qenë analoge dhe ka paraqitur një organ për vërtetimin e fakteve. Qëllimi i saj ka qenë që të gjej kuptimin e këtij obligimi, gjegjësisht të kësaj të drejte. Gjithashtu janë themeluar organe që kanë patur për qëllim të hulumtojnë ngjarje të caktuara, p.sh është themeluar Komisioni për Srebrenicën e cila prapë teknikisht nuk ka qenë Komision për të Vërtetën por ka qenë një organ i rëndësishëm që ka zhvilluar një hetim të rëndësishëm. Komisioni për persona të pagjetur në rajon gjithashtu zhvillojnë hetime dhe punën më të madhe e kryejnë OJQ-të dhe si shembull i mirë mund të merret Qendra Hulumtuese-Dokumentuese në këtë rast dhe projektet në lëmin e të drejtave të njeriut të cilat zhvillohen nga këto tri organizata partnere. I përmenda të gjitha këto për të treguar se komisioni për të vërtetën është vetëm një nga opsionet. Në disa raste ato janë opsioni i duhur e në disa tjera nuk janë, por asnjëra nga këto opsione nuk do të duhej që të përjashtonte ndonjërin nga modelet e mundshme të organeve për të zhvilluar modele për zhvillimin e hetimeve dhe vërtetimin e fakteve. Dhe në fund të them

vetëm që rol kyç në zhvillimin e hetimeve dhe vërtetimin e fakteve kanë gjykatat. I përmenda këto përkundër asaj se sa të qarta mund ti keni ato.

Dhe tani të flasim për komisionet për të vërtetën. Komisionet për të vërtetën paraqesin mekanizma i cili sipas mendimit tim është i lidhur me drejtësinë tranzicionale me të gjitha lëmitë me të cilat merret siç janë ballafaqimi me të kaluarën me shtetet në tranzicion. Ky rajon është i veçantë për shumë arsye. Zakonisht komisionet për të vërtetën themelohen pas përfundimit të konfliktit apo pas përfundimit të regjimit autoritar dhe në fillim të periudhës së tranzicionit. Këtu janë duke u zhvilluar disa tranzicione në të njëjtën kohë, tranzicioni, tranzicioni post-konfliktit, tranzicioni për sundim të demokracisë dhe kalimi prej ekonomisë socialiste në ekonomi të tregut. Të gjitha këto zhvillohen njëkohësisht, kështu që komisionet për të vërtetën në secilin rast dhe në rrethana të këtylla përbëjnë organe të cilat luajnë rol të caktuar në momentin e tranzicionit dhe përbëjnë një urë lidhëse në mes të asaj se çfarë ka ngjarë dhe çfarë është dashur të ndodhte, dhe këtë rol pikërisht e synojnë edhe vet komisionet. Deri tani janë themeluar rreth 30 komisione për të vërtetën dhe siç ju thashë gjatë ligjërimit tim të pasdites unë do ti shtellojë disa modele të komisioneve për të vërtetën. Ato kanë pasur edhe emra të ndryshëm. E di që për disa prej jush vet emërtimi Komisioni për të vërtetën ju frustron dhe mund të tingëllojë shumë arrogante. Dhe vërtet nëse një Komision për të vërtetën është themeluar për të vërtetuar të vërtetën si nocion për një të vërtetë të vetme të mundshme atëherë e vërteta e plotë ka dështuar. Komisionet për të vërtetën janë themeluar për ti ndihmuar komisionet për të vërtetën. Disa madje nuk mbajnë fjalën 'e vërtetën'. P.sh Në Guatemalë ky komision quhet Komisioni për Ndriçimin e së Kaluarës. Janë përdorur emërtime të ndryshme, p.sh komisioni për të vërtetën dhe drejtësi, komisioni për pajtim etj. Pra ka patur emërtime të ndryshme. Sot funksionojnë dy komisione për të vërtetën në Liberi dhe Ekuador. Dy komisione tjera janë në themelim, një në vendin tim, mund të duket e çuditshme që vie nga Kanada. Kanada më 1 qershor do të themelojë Komisionin për të vërtetën dhe pajtimin, i cili do të merret me krimet dhe diskriminimet e trashëguara me dekada ndaj vendorëve të lashtë. Nuk do të ndalem në detaje këtu. Vetëm desha që t'u them që ekzistojnë numër i madh i komisioneve. Edhe në Keni duhet të themelohet Komisioni për të vërtetën.

Pra çfarë është komisioni për të vërtetën? Për mendimin tim, komisioni për të vërtetën ka **10 karakteristika themelore**, të cilat shpjegojnë në vija të trasha sqarojnë çfarë janë komisionet për të vërtetën. Ekzistojnë pikëpamje të ndryshme mbi atë se çfarë janë komisionet për të vërtetën

por këto dhjetë karakteristika që do ti sqarojë i japin një definicion komisionit për të vërtetën.

- Karakteristika e parë, që dua të theksojë posaçërisht në këtë grup është që komisioni për të vërtetën është në thelb një komision hetues. Nuk bëhet fjalë për komisione të cilat synojnë të shërojnë botën dhe as organ që do ti bashkojë viktimat dhe krim-bërësit, dhe as organ për ndërmjetësim. Në esencë, sipas emërtimit që ka fjala është për një organ hetimor. Kështu edhe duhet të jetë dhe ju duhet të mbani në mend edhe pas gjithave që do të dëgjoni këto dy dite. Do të thotë komisionet për të vërtetën janë komisione hetuese dhe kjo është karakteristika e tyre fillestare.

- Karakteristika tjetër është që ato paraqesin **organe të themeluara apo të autorizuar**. Do të mundohem të ju sqaroj këtë me një shembull. Le të marrim për shembull qendrën hulumtuese-dokumentuese. Kjo organizatë paraqet organin i cili ka bërë më së shumti punë për vërtetimin e fakteve për atë çfarë u ka ndodh viktimave por kurrë nuk do të jetë një komision për të vërtetën. Komisioni për të vërtetën është organ zyrtarisht i themeluar i cili deri në një masë e financon dhe e zyrtarizon vet shteti.

- Karakteristika e tretë për komisionin, e cila shpreh edhe shkakton konfuzion, prandaj do të mundohem ta sqarojë sa më mirë. Jo vetëm që komisioni është organ hetues, i themeluar zyrtarisht por është edhe organ i cili funksionon me një shkallë të caktuar të autonomisë dhe pavarësisë nga themeluesi i vet. Supozoj që kjo shkakton huti të shumë prej jush dhe mund të parashtroni pyetjen "Nëse është fjala për një organ të themeluar nga shteti si mundet pra që të jetë autonome dhe e pavarur?" Në anën tjetër edhe gjykatësin e emëron shteti dhe ai funksionin e tij e kryen në mënyrë të pavarur. Në gjuhën angleze ekziston termi gjatësia e krahut (autonomia) Me fjalë tjera qeveria mundet që të themelojë një organ i cili ka autonomi në veprim karshi qeverisë. Niveli i autonomisë dhe pavarësisë është i ndryshueshëm. Disa organe gëzojnë pavarësi më të madhe por komisioni për të vërtetën është menduar si organ i cili i cili posedon nivel të caktuar të pavarësisë dhe autonomisë gjë që paraqet një aspekt të rëndësishëm. P.sh nëse Ministri e Drejtësisë inicion një hetim për disa krime të kryera dhe i ndërmerr masat e duhura, ky mund të jetë një hetim i rëndësishëm por nuk është komision për të vërtetën. Komisioni për të vërtetën është i pavarur nga themeluesi i tij. Ai përbën një organ të pavarur zyrtar. Sa më shumë pavarësi të ketë aq më mirë.

- Karakteristika e katërt e Komisionit për të vërtetën është që ai është një **organ i përkohshëm**. Kështu që komisioni për të drejtat e njeriut për shembull mund të kryejë një punë të rëndësishme në një vend të cakt-

uar por ai është një organ i përhershëm kështu që nuk mund të jetë një komision për të vërtetën. . Ajo mund të hulumtojë fakte të njëjta si edhe komisioni për të vërtetën por sërish kjo nuk e bën të jetë komision për të vërtetën. Komisioni për të vërtetën është i përkohshëm i themeluar për një periudhë të caktuar kohore pas së cilës pushon së funksionari.

- Karakteristika e pestë e Komisionit është gjithashtu e lidhur me fokusin e tij të përkohshëm. Komisioni për të vërtetën nuk merret me kryesitë e krimeve, por me ato krime që ndodhin në një kohë të caktuar në të kaluarën dhe që i ndihmojnë së ardhmes. Edhe pse e ardhmja lidhet me ngjarje nga e kaluara, komisioni nuk merret me to. Kështu për shembull nëse ka ngjarë një masakër një javë pas formimit të komisionit, komisioni nuk merret me të, me të merren hetuesia e policisë, gjyqësori apo organe të tjera dhe jo komisioni për të vërtetën. Komisioni për të vërtetën ka mandat të caktuar dhe merret me të kaluarën.

- Me cilat ngjarje nga e kaluara merret ajo? Dhe kështu vijmë deri tek karakteristika e gjashtë për komisionin për të vërtetën. Objekt i hetimeve të komisionit për të vërtetën nuk është secila gjë e keqe që ka ngjarë në të kaluarën, dhe jo secili diskriminim që ka mund të ngjajë. Komisioni për të vërtetën ka objekt të kufizuar të hetimit. Ato hetojnë vepra që mund të kualifikohen si si vepra të rënda penale në një periudhë të caktuar. Kjo nuk do të thotë që veprat tjera anashkalohen. Në kuptim të caktuar, përjashtimi i grupeve sociale, i cili zgjatë me dekada mund të paraqes një krim të tmerrshëm, por komisioni në praktikë për shkak të kufizimeve edhe kohore edhe kadrovike merren vetëm me aktet më të rënda të dhunës. Dhe kjo është edhe një gjë që duhet të kemi parasysh, komisioni për të vërtetën gjithashtu..

- Kjo është karakteristika e shtatë. Komisioni fokusohen në mënyrë të **veçantë tek viktimat**. Komisioni për të vërtetën interesohet edhe për dëshmitarët, kryesitë e veprave, madje në disa raste tregojnë interesim edhe për personat që kanë tregime pozitive, për shembull personat që i kalojnë kufijtë etnik dhe përmbushin një të mirë për fqinun e tyre etj. Në përgjithësi komisionet për të vërtetën fokusohen në përvojën e viktimave dhe të familjeve të tyre por që realiteti dikton edhe gjëra të tjera. Edhe pse duhet të jemi të vetëdijshëm që komisioni rrallë herë realizojnë ndonjë bashkëpunim me kryesitë e krimeve. Nuk do të ishte reale që të presim që kryesitë e veprave të rënda të dalin dhe të flasin mbi atë çfarë kanë bërë. Edhe pse gjithmonë do të ndodhë të dalë dikush dhe të bëjë një gjë të tillë, por këtë e bëjnë zakonisht në mënyrë të fshehtë dhe të mbuluar ku komisioni mund të marrë mjaft informacione por puna është se komisioni fokusohet në viktima, bazon punën e vet te viktimat.

- Karakteristika e tetë e komisionit për të vërtetën është që komisioni nuk fokusohet në një ngjarje të vetme. Më herët solla shembullin e Komisionit për Srebrenicën. Komisioni për Srebrenicën ka qenë i fokusuar gjatë atyre javëve në Srebrenicë dhe jo në krimet tjera që kanë ngjarë le të themi në vitin 1992 apo 1995. Do të thotë është fokusuar në ngjarje të caktuara. Komisioni për të vërtetën, përkundrazi, merret me ato krime që kanë shënuar një periudhë më të gjatë kohore e cila përputhet me kohën kur janë kryer krimet më të rënda. Por duhet gjithashtu të përmendim që ato nuk kthehen tre shekuj pas, madje jo as 50 vite në të kaluarën. Por natyrisht ekzistojnë komisione të caktuara që objekti i studimeve të tyre mbulon periudhën 44-45 vite le të themi deri në pavarësi, vitet nga 1950-ta , 60-ta e deri më sot. Do të thotë komisioni heton ngjarjet e një të kaluarë të afërt, që kanë ngjarë në një të kaluar relativisht të afërt.

- Dy karakteristikat e fundit të komisionit për të vërtetën – kërkoj falje nuk kam ndërmend të jem shumë pedant por ama do të doja të sqaroja se çfarë në mendojë dhe çfarë nuk mendojë kur flas për komisionin për të vërtetën. Kështu dy karakteristikat e fundit, **bazohen në atë që komisionet themelohen në territorin kur janë kryer krimet**. P.sh jo si MKTJ, nuk mendoj ta kritikojë por vetëm të përmend që nuk është fjala për ndonjë organ të themeluar jashtë por brenda. Është fjala për një organ të bazuar dhe të fokusuar në territorin ku janë kryer krimet. Dhe të sqarojë edhe një gjë që komisioni nuk është organ nga jashtë por organ i cili ekskluzivisht por jo edhe obligativisht fokusohet në territor ku janë kryer krimet si rasti kz këtu. Por p.sh , një shembull i njohur për ju , në Afrikën Jugore nuk janë hetuar vetëm krimet në territorin e Afrikës Jugore por edhe ato krime që paraqiten ti kenë kryer shteti apo apart'heidi edhe jashtë kufirit, apo rajonit në shtete tjera. Edhe një shembull tjetër tua sjellë:: Komisioni për të vërtetën në Çili ka hetuar edhe rolin e SHBA-ve në kohën e pushtetit të Pinochesë. Por këto organe kanë pasur për fokus të merren me çështje të brendshme. Është fjala për organe që dëshirojnë të nxjerrin mësim nga brenda. Dhe kështu edhe duhet të jenë. Dhe nëse ndonjëherë fillojnë punën komisionet për të vërtetën dhe heton vetëm gabimet e të tjerëve atëherë sepse atëherë nuk do të ishte komision. Edhe gjëra të tjera sigurisht që janë me rëndësi por më e rëndësishmja është që ato duhet të shqyrtojnë atë që ka ngjarë nga brenda.

- Karakteristika e fundit për të vërtetën është që ato paraqesin komisione hetuese. Dhe nuk e marrin rolin e gjykatës. Ato janë organe jashtëgjyqësore. Ato mund ti posedojnë disa kompetenca në hetim por janë si të tilla jo-gjyqësore. Dhe siç e përmenda **komisioni për të vërtetën ka mandat që në fund të ekzistimit të tyre jo**

nxjerrë konkluzione ligjore por që të nxjerrë konkluzione mbi faktet mbi atë se çfarë ka ngjarë dhe në bazë të tyre të japë rekomandimet e veta për parandalimin e krimeve të tilla në të ardhmen.

Pra ky është mendimi im mbi atë sesi janë të definuar komisionet për të vërtetën. Dhe këto baza bien ndeshë me të gjitha organet tjera që ne i njohim.

Pse duhet të formojnë një komision për të vërtetën? Ekzistojnë arsye të ndryshme për këtë. Së pari që në mënyrë kualitative dhe kuantitative të kontribuohet në zbulimin e së vërtetës. Komisioni duhet që në masë të konsiderueshme të kontribuojë për zbulimin e të vërtetës. Dhe këtë kontribut komisioni mund ta bëj në shumë mënyra, dhe siç thashë ekziston dimension i kuantitativ dhe kualitativ. Kështu një komision i cili nuk zbulon të dhëna për krimet e luftës apo për shkeljet e të drejtave të njeriut është për tu dështuar pavarësisht sa i suksesshëm mund të jetë në fusha tjera. Dhe nëse nuk ka të reja të zbuluara atëherë të gjitha në tërësi do të dështojnë. Dhe këtu shpesh përmenden fjalët e bashkëshortit tim Majkël Ignacio i cili thotë që komisionet mund të ngushtojnë rrethin e gënjeshtreve të lejuara. Me fjalë tjera, nëse komisioni kryen punën si duhet që të mos lejojë më që në opinion publik të dalin gënjeshtër mbi gjëra apo edhe nëse janë paraqitur në publik atëherë që ato të mos përsëriten dhe që të humb besueshmëria tek to.

Dhe do ju sjellë sërish disa raste, p.sh në Afrikën Jugore apo në Çili, askush më s'mund të thotë që njerëzit nuk janë gjuajtur të droguar nga helikopterët në oqean. Kjo më nuk mund të mohohet, komisioni për të vërtetën nuk i ka zbuluar të gjitha por së paku ky fakt tanimë nuk mund të mohohet. Ngjashëm ka ngjarë edhe në Afrikën Jugore, Njerëzit thonë që pavarësisht nga dobia e raporteve të komisionit, ajo çfarë është me rëndësi është që raporti për herë të parë përshkruan tmerrin e apart'heidit dhe tani nuk mund të gjendet ndonjë person dhe të pohojë që apart'heidi nuk ka qenë regjim i tmerrshëm apo që ska qenë edhe aq i keq. Dhe pas dy apo tri viteve të dëgjimit të fakteve nga raporti është tanimë e pamundur të pohohet diçka e tillë. Për komisionin mund të thuhet shumë e shumë gjëra tjera por ky është njëri prej vështirësive. Komisionet për të vërtetën janë themeluar për të dhënë kontribut jo vetëm për të vërtetën por edhe për drejtësinë/gjyqësorin. Komisioni i parë në Argjentinë është themeluar me qëllim të arritjes së drejtësisë. Dhe ka përbërë bazën për hyrje/pikënisje në ndjekje penale. Qeveria asokohe ka menduar që kjo nuk mund të bëhet për shkak të numrit të madh që kërkohet që gjyqësori ti procedojë në një periudhë të shkurtër. Kanë dashur që krim-bërësit ti dënojnë por kanë themeluar një komision për i cili nuk është emërtuar si komision për të vërtetën, por si Komisioni për Nacional për Persona të Pagjetur i cili ka patur 7000 dosje dhe raste- dhe këto dosje pastaj ia ka

dorëzuar gjykatës që ato të ndërmarrin veprime gjë që edhe e kanë bërë në shumicën e rasteve.

Komisionet për të vërtetën janë menduar që të kontribuojnë ndoshta jo menjëherë por në një afat më të gjatë, gjykatave penale. Kjo detyrë e komisionit realizohet përmes hetimit të rasteve, organizimit të dosjeve dhe dorëzimit të tyre në gjykata. Do të thotë këto janë mënyrat sesi Komisionet mund të ndihmojnë në shumë raste. Shpesh komisionet themelohen si hap në drejtim të riparimit/kompensimit të viktimave apo bisedave që ato i zhvillojnë me viktimat i pyesin ata çka kërkojnë nga komisioni që të bëj dhe ato i përmendin riparimet/kompensimet. Si kërkesa themelore. Shumë shpesh këto komisione formojnë një kornizë rekomandimesh për qeveritë për veprimet që duhet ndërmarrë në rastet e dhënies së kompensimeve he shpesh këto rekomandime miratohen. Riparimi duhet ta dimë nuk do të thotë gjithmonë dhënia e kompensimeve por edhe të kërkohet falje, ndërtimi i përmendoreve, qendrave memoriale, kthimi i të drejtave dhe lirive, programet rehabilituese për viktimat dhe familjet e tyre.

Pajtimi e dimë që paraqet një prej qëllimeve për shumë komisione për të vërtetën. Por më pak se gjysma e tyre, them më pak se gjysma e tyre kanë parashtruar pajtimin si objektivë. Nga Komisioni për të vërtetën dhe pajtimin në Afrikën Jugore shumë komisione tjera të themeluara kanë shtuar edhe këtë fjalë. Unë e di që në këtë rajon është e rrezikshme të përdoret ajo fjalë por unë dua të sqarojë pse futet edhe kjo fjalë dhe pse disa komisione nganjëherë e vënë për objektivë. Pajtimi bëhet objektivë për Komisionin sepse përveç vërtetimit të së vërtetës ato shihen të jenë më shumë sesa një organ empirik dhe ligjor por në fakt perceptohen dhe janë organe që gjeneron një proces të ri shoqëror, proces të reflektimit shoqëror nganjëherë edhe ngritje të vetëdijes dhe katarzë. Dhe pajtimi si term që e përdorin shumë komisione për të vërtetën këtë synojnë, do të thotë kanë idenë që të rikthehet besimi i qytetarit, të rritet solidariteti mes grupeve ku një grup pohon „ne kemi qenë viktimat më të mëdha“. Komisioni për të vërtetën duke bërë punën e vet siç duhet sjellin deri tek pajtimi në këtë kuptim, dhe jo që kriminelit dhe viktimat tani të shfaqen si njerëz që përqafohen në televizion, por në një kuptim tjetër, në kuptim të krijimit të një procesi shoqëror, kontributi ndaj një procesi të tillë shoqëror i cili ka për detyrë që të tejkalojë ndarjet shoqërore dhe mosbesimin ekzistues në shoqëri. Pra komisionet për të vërtetën mundën por nuk obligohen, por në të shumtën e herëve ku ato japin një kontribut të tillë nuk vjen deri tek pajtimi por kjo përbën një pjesë të një procesi nëse puna kryhet si duhet. Përfundimisht, komisionet për të vërtetën munden, dhe kjo mendojë unë është arsyeja që komisionet hapin debatet publike dhe ndërlihen me këtë çështjen e fundit. Pra duhet të nis debati i cili është tejet i ndjeshëm për dinjitetin njerëzor që është humbur,

dhe fjalime dhe debate të caktuara do të bëjnë ndryshime nga natyra. Sërish komisionet për të vërtetën nuk e arrijnë gjithmonë këtë, dhe as ata që organizojnë dëgjimin e viktimave. Mendoj që duhet të theksohet që në disa vende dhe në vende të caktuara ku njerëzit presin me javë dhe me muaj që të dëshmojnë për krimet e tmerrshme dhe tragjeditë që u kanë goditur, me kohë ndryshon natyra dhe cilësia e debateve publike, dikund tjetër mund të tjetër edhe tabu biseda për gjëra të tjera dhe diku tjetër nuk mund të flasim disa të gjëra për të kaluarën dhe nuk mund të fajësojmë palë të caktuara. Komisioni për të vërtetën i cili bën punën mirë mund të ndihmojë në tejkalimin e tabuve të ndryshme shoqërore. Dhe këto janë disa prej dobive potenciale: Dhe natyrisht çdo gjë varet nga ajo se sa mirë e kryejnë detyrën e vet.

Në rregull, Vetëm edhe 10 minuta dhe do të keqpërdor pozitën time të panelistit. A pajtoheni apo jeni lodhur a dëshironi që të vazhdojë? Mirë vetëm desha.. Deri tani kam dhënë shumë informata dhe do të më bënte mirë një pauzë por para kësaj do të doja të bëjmë një ushtrim. Le të themi p.sh „të paramendojmë që ndonjë shoqëri dëshiron që të themelojë komisionin për të vërtetën apo ndonjë organ të ngjashëm me komisionin e së vërtetës“. Kur them dëshiron të themelojë nuk e kam fjalën për komisionin që mban emrin komisioni i së vërtetës por organi që do të kryejë detyrat e komisionit për të vërtetën.

6 | Çfarë duhet të kenë parasysh shoqëria civile, akterët politikë apo ata ndërkombëtar? Si organizohet një organ i tillë? Ideja e parë pra del që të mendohet një komision për të vërtetën apo ngjashëm me të – atëherë kush e financon atë? Ka modele të ndryshme. Ekzistojnë modele që bazohen në pushtetin nacional, disa i themelojnë ato së bashku me qeveritë nacionale dhe ndërkombëtare, madje ka modele që një komision është themeluar me marrëveshje të paqes, anëtarët e të cilit komision i kanë emëruar Kombet e Bashkuara. Dhe siç e thashë duhet të ketë një nivel të caktuar kompetencash nacionale sepse në të kundërtën nuk bëhet fjalë më për komisionin për të vërtetën. Duhet të them që që është një gjë tjetër të përmendet qeveria dhe një gjë tjetër ekzekutivi, legjislativi apo kombinimi i këtyre dyjave – prej të cilave varet mandati i komisionit për të vërtetën. – në rast se dëshironi që të dërgoni ftesa nga gjykata, bastisje apo arrestime. Nga ana tjetër dega e ekzekutivit ka autoritetin më të lartë moral në kohë të caktuar dhe për kredibilitetin dhe dhe legjitimitetin e organit ndoshta është më mirë të themelohet nga ndonjë ekzekutiv. Ekzistojnë shumë mundësi por në fakt rrethanat janë shumë të rëndësishme. Së dyti, ... në rregull kjo ka rëndësi me atë çfarë thashë më sipër, kush jep dekretin kush formëson mandatin etj. Ndërsa është plotësisht çështje tjetër se kush janë anëtarët e komisionit. Nganjëherë vendimi se kush do të jetë në përbërje të komisionit merret posa të miratohet ligji për

komisionin për të vërtetën. Ky është një model që ne nuk e rekomandojmë sot dhe se mësimi i nxjerrë nga përvoja të ndryshme është që anëtarët e komisionit të emërohen nga një këshillë i pavarur i cili i merr nominimet nga opinioni publik, që i vlerëson kandidaturat, interviston kandidatët dhe jep rekomandimet për pushtetin politikë që veprojnë sipas atyre rekomandimeve. Këto në esencë ndikojnë në rritjen e kredibilitetit të anëtarëve të komisionit dhe nëse ka diçka që ndikon më së shumti në kredibilitetin e komisionit janë përbërja e vet komisionit. Nuk guxojmë të anashkalojmë këtë faktor kyç të procesit.

Dhe tani për kushtet e zgjedhjes së tyre. Cilat janë kriteret që duhet plotësuar? Komisioni për të vërtetën e përbëjnë persona që përmbushin kriteret e caktuara. Për shembull anëtar në komision nuk mund të jetë një kryes i krimeve, le të themi që ka kryer dhunime. Kjo dihet. Por në disa raste qeveritë emërojnë persona që nuk i përmbushin kriteret e dinjitetin njerëzor dhe as elementet themelore të integritetit njerëzor. Prandaj them unë, duhet të ketë një prag aty. Dhe natyrisht meqë kemi të bëjmë me organ të pavarur ai organ nuk mund të jetë i përbërë nga anëtarë të partive politike. Kjo nuk i ndihmon autonomisë së një komisioni, por do ta shkatërronte atë. Kështu që anëtarë të Komisionit duhet të jenë individët dhe jo partitë politike, por personalitete të njohura nga komuniteti. Ata nuk duhet patjetër që të jenë heronj, por që të jenë qytetarë të ndershëm. Por as ky kriter nuk është i mjaftueshëm dhe duhet të ketë të përmbushura një sërë kriteresh të tjera. Sepse nuk është fjala vetëm për persona të dinjitetshëm por duhet menduar edhe përkatësitë etnike, racore, fetare, nivelin e kualifikimit të pjesëtarëve të komisionit. Ndoshta ju duhet një person i duhur me punë me viktimë. Dhe nuk është e nevojshme që të gjithë anëtarët e komisionit të kenë nivele të njëjta të ekspertizës. Ju duhet juristi, dikush me përvojë në media etj. Por më e rëndësishmja është që të kemi parasysh që duhet të ketë kriteret e vendosura që duhet të respektohen.

Në rregull, dhe çfarë sa i përket kohëzgjatjes së komisionit? Ju thashë më herët që komisionet për të vërtetën janë organe të përkohshme. Kanë ekzistuar komisione që kanë punuar edhe nëntë vite e më gjatë. Por unë nuk e rekomandoj. Disa komisione tjera kanë funksionuar edhe për gjashtë muaj. As këtë nuk e rekomandoj. Sepse edhe komisioni i cili stërgjatë punën e vetë nuk mund të mbajë gjithmonë në nivel vëmendjen e opinionit publik, sepse edhe kjo është me rëndësi, dhe nuk mund të ushtrojë ndikimin e vet gjithmonë njësoj. Në anën tjetër sa dëgjime, hetime mund të organizohen për gjashtë muaj nëse para vetes keni më shumë se 80.000 raste? Jo shumë. Pra marrë në përgjithësi, për të gjetur ndonjë balancë, shumica e qeverive sot mundohet që të gjejë një baraspeshë mes një vit e

gjysmë dhe tri vite mesatarisht, duke marrë parasysh edhe rastet më ekstreme.

Çfarë lidhur me ... më lejoni të kthehem edhe njëherë në aspekte tjera dhe pastaj do të ndalem. Nesër do të flasim për dëgjimet publike dhe nuk dua që tani të flas për to, por dua të them që dëgjimet publike nuk janë gjithmonë pjesë obligative e komisionit për të vërtetën. Kanë ekzistuar shumë komisione për të vërtetën që nuk kanë mbajtur dëgjime publike, por nëse vendoset që ato të mbahen atëherë ato duhet të jenë në mandatin e komisionit. Kjo është një gjë.

Çështje e emërtimit të individëve, dhënia e emrave të kryesve të krimeve si përgjegjës për krime në kushte ku ka shkallë të lartë të mos dënimit, e deri tek sprovat që në komision të thuhet që 'zotëriu x ka bërë këtë' dhe kjo të futet në raport. Kjo është gjë në rregull, por nëse komisioni ka këtë mandat atëherë duhet të respektojë procedura dhe norma të caktuara të cilat mundësojnë që personi në fjalë të mbahet në dijeni dhe të jetë në gjendje që të mbrohet apo të argumentojë të kundërtën. Kjo pikë është shumë e rëndësishme. Ju mund të thuani që „këta njerëz do të emërtojnë vetëm të këqijtë dhe ne i dimë se kush janë ata, dhe për çfarë janë përgjegjës.“ Mund të ju them që komisionet kanë patur mundësi edhe të emërojnë individë që kanë gëzuar të drejtën të përgjigjen atyre individëve, pastaj në fund kanë hequr dorë nga këto plane sepse ose e kanë parë që nuk kanë rast të fortë siç mund të ketë menduar. Pra edhe një gjë që duhet të kemi parasysh. Dhe më lejoni që të të shtjellojmë edhe një temë, nuk është e ngarkuar por për fillim të them diçka për obligimet që duhet ti ndërmarë qeveria në fund të këtij procesi. Është dhënë raporti përfundimtar. Në disa raste publikohet raporti në disa jo. Por do të duhej që të publikohej në të gjitha rastet. Ky është një obligim për qeverinë sa i përket rekomandimeve që përmban. Më e keqja që mund të ngajë është që të kalohet nëpër tërë këtë proces dhe që në fund viktimat dhe familjarët e viktimave të shohin që ato rekomandime nuk po përfillen, dhe kjo do të paraqiste një formë tjetër sekondare të diskriminimit ku shpresat janë rritur gjatë tërë kohës dhe zakonisht ekzistojnë dy ekstreme. Në disa raste mund të thuash që ekzistojnë rreziqe që ky proces të shëndrohet në një proces jodemokratik. Në disa raste mund të thoni që qeveritë 'kanë marrë raportin, kanë themeluar organin dhe është dashur të implementojnë rekomandimet'. Por fatkeqësisht, ekziston mundësia që të shëndrohet në proces jodemokratik meqë nuk janë anëtarët e komisionit ata të cilëve u jepen rekomandimet, të cilat janë ide jo të mira p.sh që nuk i ka pranuar as opinioni publik, për shembull mund të dalin me propozime për reforma juridike dhe ata as që janë ligjvënës, dhe kështu parashtrajnë obligime për qeverinë dhe këto nuk shihen të jenë bazuara në parime demokratike

Ekstremi tjetër është që komisioni për të vërtetën

ka mandat të mos thotë asgjë, dhe qeveria e injoron apo zbaton vetëm ato rekomandime që i shkojnë për shtati. Natyrisht ky nuk është një skenar i dëshirueshëm. Në vend të kësaj duhet të gjendet një qasje që të obligohet shteti të shqyrtojë rekomandimet dhe që kohë pas kohe të dal me raporte në shoqëri mbi atë se si po zbatohen ato rekomandime, apo pse nuk po zbatohen, edhe që të japin afatin kur do ti zbatojnë ato, apo nëse thonë "do ta bëjmë më vonë" të japin afatin kur dhe si do ti plotësojnë ato. As kjo gjë nuk është e përkryer, akoma ka hapësirë për shumë lëshime dhe shpesh në fund të punës së komisionit themelohet një organ që ka për detyrë të kryejë monitorimin për zbatimin e rekomandimeve nga ana e qeverisë. Kaq.

*

A ekziston ndonjë shembull i komisionit për të vërtetën e cila mbulon shumë shtete sepse ne po mendojmë të themelojmë një në territoret e ish Jugosllavisë? Ka dy pjesë të përgjigjes këtu. Përgjigja e shkurtër do të ishte jo. Dhe përgjigja më e gjatë do të ishte që për një gjë të tillë nuk mendohet për herë të parë. Në fakt në Timorin Lindor dhe në Indonezi janë themeluar Komisionet për të Vërtetën dhe Miqësinë. Me rezervë po përmend këtë sepse nuk është ndonjë model i mirë. Dhe duhet të jeni të vetëdijshëm për këtë që të mësoni nga përvojat e tyre. Çfarë ka ngjarë në të vërtetë? Timori lindor ka patur komisionin për të vërtetën që ka bërë shumë punë, dhe pak para përfundimit të mandatit të tij, Qeveria e Timorit Lindor e cila kërkonte me çdo kusht një pajtim me Indonezinë, kolonizatorin e dikurshëm vendosi që ekzistonte diçka tjetër dhe që ky komision që ka ekzistuar në Timor vetëm e kritikonte qeverinë e Indonezisë për shkak të rolit të saj, dhe kritika me vend ishin, për të shkatërruar kështu marrëdhënien me Timorin Lindor dhe Indonezinë, dhe qeveria e Timorit Lindor dhe ajo e Indonezisë kanë themeluar –Komisionin për të vërtetën dhe pajtimin. Shoqëria civile dhe posaçërisht këshillat për të drejtat e njeriut i kanë diskredituar këtë komision për shkak të asaj çfarë është bërë.... Mendoj që ekziston droja që të legjitimohen mosdënimi, në vend se të mos lejohet mosdënimi. Kjo ka qenë një ndërhyrje diplomatike për të harruar të kaluarën dhe që përgjegjësia e Indonezisë të lihet anash. Dhe komisioni për të vërtetën nuk e ka atë kuptim. Por komisioni nuk është aty për të hulumtuar vetëm ngjarjet për vitin 1999, kur kanë ngjarë dhuna më e madhe ju kujtohet kur Timori, ka dalur në referendum për shtet të pavarur. Pra Komisioni merret vetëm me këtë e deri diku për arsye teknike. Akoma mendoj që ky komision të studiohet, por vetëm për të mësuar nga ai pësim. Ideja për komision rajonal është sfidë por është edhe interesante. Unë mendoj që këtu për herë të parë mund të themelohet një komision efikas rajonal. Dhe një gjë e tillë më së shumti varet nga ju, por nga ajo që kam paraqitur më herë nuk ka asgjë që në veçanti do të pengonte ekzistimin

e një komisioni të tillë në një nivel të tillë. Gjithashtu është folur edhe për regionin Great Lakes në Afrikë ku konflikti ka dalur jashtë kufijve të Ugandës, në R. Demokratike të Kongosë, Burundi, Ruandë dhe këtu janë analizuar ide të tilla. Pra kjo do të ishte përgjigja e gjatë. Ndërsa e shkurtra do të ishte vetëm jo.

Në suaza të rolit investigues si funksionon, si punon. Mendoj se ekzistojnë një mori pjesësh të ndryshme investiguese të komisionit për vërtetësi- natyrisht ekziston edhe pjesa e forenzikës, dhe zakonisht kryhen me mijëra e dhjetëra mijëra intervistash individuale, pra, merren dëshmi, deklarata, kryhen investigime, pastaj jo rrallë aplikohet edhe analiza raportete të mediave, dhe shumë shpesh shqyrtohen gjyqësia dhe aktet gjyqësore. Ngjashëm, dhe në këtë kontekst, mbase është me rëndësi që të potencohet se edhe atëherë kur një trup nuk e posedon autorizimin që të thërras apo edhe të mbledhë prova. E pakta që do të dëshironit në këtë rast është që komisioni për vërtetësi të ketë mandat dhe që të gjitha autoritetet shtetërore janë të obliguara që të ofrojnë të dhëna nën kërcënimin me dënime nëse nuk veprojnë ashtu siç ju kërkohet. Pra, nëse nuk e keni, këtë, atëherë nuk keni dhe shume, nuk mund të mbështeteni në vullnetin e mirë dhe vullnetarë. Ekzistojnë mënyra të ndryshme me anë të të cilave mund t'i detyroni që të shkëmbejnë informata të cilat i posedojnë. Përveç kësaj, ekzistojnë edhe gjëra të tjera bazë. Si shembull, mund ta përmend një rast nga Maroku. Ata kanë vizituar secilin morg në vend dhe secilën varrezë dhe janë takuar me drejtuesit e varrezave nga të cilëve ua kanë kërkuar regjistrat. Në disa raste ishin shumë mirë të organizuar, vende vende regjistrat fare nuk ekzistonin, ndërsa dëshmitë të cilat i ofronin mbi viktimat ishin ato të ilat mund të të dërgonin deri te lokacionet në të cilat janë kryer masakrat apo gjërat tjera. Pra ekziston një mori teknikash me anë të të cilave mund të shërbehëni. Në përgjithësi do të thoja se bëhet fjalë për një investigim multidiciplinar.

Sa i përket transparencës në punë e komisioni, është mëse e qartë se komisioni për të vërtetën do duhej të ishte transparent në punë e tij. Këtë nuk do duhej ta potencojmë. Mënyra më e mirë për ta arritur këtë është shoqëria civile, e cila, pas themelimit të komisionit, insiston që komisioni të kryej punën për mediat dhe që t'i ftoj njerëzit në zyrat e veta, që të vijë në pah me punën dhe mos të kthehet në vetëm edhe një laborator të vockël investigues, i cili provon të zgjidh nga jashtë problemet shoqërore. Ky do duhej të ishte një proces shoqëror. Komisionet për vërtetësi do duhej të kenë programin për komunikim (*outreach*) dhe duhet të cyten që të punojnë në këtë drejtim

Dhe tani sa i përket përmendjes së emrave dhe parimeve bazë të një gjykimi të drejtë. Sërish, ato parime

nuk vlejné në këtë rast meqenëse ne nuk po merremi me ...askush nuk do të përfundoj në burg për shkak të vendimeve të komisionit për të vërtetën. Individëve të caktuar mund të ju gjykohej në bazë të rekomandimeve të cilat do t'i kompiloj komisioni. Mirëpo pasoja të llojit "tani do të shkoni në burg" nuk ka ngase komisioni nuk është gjykatë. Kjo nënkupton se edhe më tej duhet të sigurohen standarde të caktuara në kuptimin procedural, mirëpo komisioni nuk duhet dhe as që mund të siguroj që të gjitha procedurat gjyqësore. Komisioni nuk e gjykon askën. Më e keqja që mund të ju ndodhë është që ky komision t'ju përmend me emër dhe që më pas të ndiqeni penalisht, mirëpo ky nuk është një vendim të cilin e merr komisioni për të vërteta, ngase ky komision bënë vetëm rekomandime. Kjo do të ishte përgjigja në këtë pyetje.

Sa i përket vullnetit politik, mos mendoni se në vendet tjera ku janë themeluar komisionet për të vërtetën ka ekzistuar ndonjë vullnet i fortë politik dhe se qeveritë e sapo formuar e para që do të bëjnë do të jetë themelimi i komisionit për të vërtetën. Ka disa shembuj të tillë, mirëpo ato paraqesin përjashtim dhe jo rregull. Gati në të gjitha rastet keni shoqërinë civile, e ndonjëherë edhe akterët ndërkom-bëtar, të cilët bëjnë presion te shteti që të ndërmarrë hetime. Shteti mund ta bëjë këtë përmes komisionit për të vërtetën apo përmes mekanizmave të tjerë, mirëpo në cilindo rast presioni nga shoqëria civile do të jetë vendimtarë. Pyetja e vetme që mund të parashtrohet është, a dini të bashkëpunoni me akterët politik të cilët në parim nuk e kanë ndërmend të ndryshojnë, apo jeni duke punuar me akterët politik të cilët mund të binden apo të shtyhen që të besojnë se komisioni për të vërteta mund t'ju shërbej. Duke folur në mënyrë hipotetike, ju mund të bëni me një qeveri e cila nuk ka dëshirë që të hulumtohen punët e saja, mbase ndonjë qeveri e ndien se as shtetet tjera nuk kanë dëshirë që ta investigojnë përgjegjësinë e tyre dhe në këtë mënyrë ta gjejnë interesin e përbashkët apo argumentet e përbashkëta në llogari të shtetëve të ndryshme ku investigohen rastet e viktimave të tyre në shtete tjera. Kjo, sërish duhet të mendohet mirë, mirëpo askush nuk duhet të besoj se në shtetet tjera ka ekzistuar një vullnet i plot politik ku janë themeluar komisionet.

Dhe tani disa fjalë për marrëdhëniet mes komisionit për të vërtetën dhe procesin gjyqësor. Mirë, mbase edhe është dashur që ta përmend që në fillim të këtij ekspozije mbi komisionin oër të vërtetën se deri më tani vetëm një komision e ka poseduar autorizimin që të ofroj amnesti, dhe ky është komisioni për të vërteta në Afrikën e Jugut. Asnjë komision tjetër nuk e ka pasur këtë autorizim. Shumica e komisioneve në kuadër të mandatit të tyre kanë pasur si obligim që në fund të punës së tyre jo vetëm t'ia dorëzojnë

dosjen autoriteteve publike, por që edhe, nëse gjatë punës së tyre kanë hasur në dëshmi mbi krimet e kryera, që ato dëshmi t'ia dorëzoj autoriteteve në mënyrë që të njejtat të mund të ndër marrin masa adekuate gjatë kohës së punës së komisionit. Komisioni për të vërtetë nuk është hiq më pak kundërthënëse karshi proceseve gjyqësore se sa do të ishte komisioni për të drejtat e njeriut, apo siç ishte komisioni për Srebrenicën. Këta trupa nuk mund ta zëvendësojnë njëra tjetrën, përkundër roli i tyre është që ta plotësojnë njëra tjetrën. Këto trupa mund kenë funksione të ndryshme mirëpo nuk i kundërvihen njëra tjetrës për shkak se kanë mandate të ndryshme, pastaj role të ndryshme, funksione të ndryshme, e kështu me radhë.

*

Edhe një herë do doja ta potencoj faktin se para themelimit të komisionit për të vërtetën mediet provojnë që të krijojnë sa më shumë pakuptimësira, mite dhe ekzagjerime të cilat do t'i ndër lidhin me ngjarjet nga e kaluara. Nëse komisioni e kryen punën ashtu si duhet, me kohën kjo fillon të ndryshoj. Mendoj se sikur mediat të angazhoheshin të themi në konferenca për shtyp, në konsultime, forume, dhe të tilla, dhe sikur të mund të bëheshin pjesë e procesit, ngase të jesh observues duket sikur nuk mjafton, them se kjo gradualisht do të hap perspektiva të reja, dhe kjo mund të arrihet me pjesëmarrje në seancat e hapura dëgjimore në të cilat do të dëshmojnë viktimat. Është shumë e lehtë të mohohet dhe për këtë të raportohet, por është shumë e vështirë që të mohohet fuqia e rrëfimit njerëzor i viktimës në ndonjë tubim publik. Dhe, konsideroj se është shumë e vështirë si për intelektualët ashtu edhe për mediet që të mohojnë diçka të tillë. Sikur edhe e kam theksuar dhe më herët, është e dëshirueshme që të ngushtohet rrethi i gënjeshtrave të tolerueshme. Dh, konsideroj se kjo mund të bëhet ... Fatkeqësisht, kjo nuk mund të bëhet përmes statistikës, edhe pse statistika do të duhej të ishte e mjaftueshme. P.Sh. në Bosnje kishte 100.000 të vdekur dhe kjo do duhej të ishte e mjaftueshme, por, megjithatë ishte e nevojshme fuqia e rrëfimit njerëzor për të arritur efektin e caktuar, dhe kjo është fusha në të cilën komisioni për të vërtetën, komisioni regional, apo sido që të quhet ai trup, mund të luaj një rol vendimtar.

II Tezat mbi komisionet për të vërtetën, të mëparshme dhe ato të sotme

Do të doja t'ua prezantoj një analogji. Komisioni për të vërtetën nuk paraqet ilaçin, por parasë gjithash paraqet rëntgenin apo dhe vet diagnozën. Ajo mund të krahasohet me rengenin ne dy kuptime— nëse komisioni e bën punën e tij ashtu siç duhet, atëherë i ngjan rëntgenit në kuptimin e na ofron një pasqyrë mbi një pjesë të së vërtetës së gjendjes mjekësore, mbi sëmundjen e individit apo shoqërisë

së tërësi, por që nuk është ilaç. Ilaçi merret në bazë të asaj diagnostifikimit dhe mund të na paraqitet në forma të ndryshme. Mund ta ketë formën e vendosjes së drejtësisë, apo formën e reparacionit, apo formën e reformës, apo dhe ndonjë formë tjetër, mirëpo vetë komisioni për të vërtetën, vendimet dhe rezultatet e saja më shumë i ngjanë filmimit rëntgenologjik të situatës. Besoj se ky përshkrim krahasues do të ndihmoj në krijimin e një pasqyre të saktë të asaj se çfarë është komisioni dhe çfarë nuk është.

Dhe tani, do t'ua prezantoj vetëm disa nga elementet më të rëndësishme, kështu që ky do të jetë një vështrim i shpejtë dhe historik i komisionin mbi të vërtetën. Gjithashtu do të dëshiroja që t'ua prezantoj edhe historinë dhe përvojat e ndryshme të komisionit për të vërtetën deri më sot ngase ka pasur përvoja si pozitive ashtu dhe negative për të cilat ju duhet të dini në mënyrë që të nxjerrin mësim nga ato, që të përfitoni apo dhe inspirohëni në mënyrë që ta shihni se disa nga përvojat thonë se duhet jeni të kujdesshëm e disa të tjera se duhet të ju shmangëni. Arsye tjetër për shkak të së cilës mendoj se është me rëndësi që të kemi një vështrim në modelet e ndryshme gjatë historisë është që në të kaluarën ka pasur shumë komisione, se sot ka shumë komisione dhe se në të ardhmen do të krijohen edhe më shumë komisione për të vërtetën dhe se që të gjitha do të jenë të privileguara ngase ato do të mbështetën në përvojat nga e kaluara, gjegjësisht modelet nga e kaluara do të ndikojnë në formësimin e modeleve në të ardhmen. Do ta shihni gjatë prezantimit të disa modeleve se komisioni për të vërtetën i themeluar në vendin X është mbështetur në komisionin e vendit Y, mirëpo që në të janë futur disa risi dhe ndryshime interesant dhe që në fund secili komision është i veçantë ngase krijohet në kontekst të veçantë, dhe këtë do ta shihni nga prezantimi im në vijim.

E kam thënë se komisioni i parë për të vërtetën është themeluar në **Argjentinë**. Është themeluar në vitin 1983. dhe në të vërtetë si e tillë nuk kishte as edhe një model të vetëm në të cilin do të mund të mbështetej. Në Bolivi është themeluar diçka e cila mund t'i ngajë komisionit për të vërtetën, mirëpo ajo ka mbaruar me punën menjëherë pas themelimit. Komisioni argjentinës është i pari i këtij lloji dhe ën kontekstin për të cilin kemi folur sot. Gjithashtu, po e përmend komisionin argjentinës në lidhje me ndjekjet penale. Ky komision paraqet hapin e parë në strategjinë e ndjekjes penale. Si e tillë është themeluar. Disa nga komisionet e më vonshme janë shërbyer me këtë model. Komisioni ka funksionuar shumë shkurt, krejt tetë muaj. Kryetar i komisionit ka qenë një shkrimtar i njohur argjentinës. Ka funksionuar shumë shkurt, në ndërkohë që është dashur të merrem me mijëra e mijëra raste. Ky komision nuk ka organizuar seanca dëgjimore të hapura dhe në fakt seancat e para dëgjimore janë organizuar në Afrikën E jugut 12 vjet më vonë, mirëpo komisioni argjentinës ka pasur

ndikim të madh ngase vendi ka kaluar nëpër disa ndryshime rrënjësore dhe të thella. Regjimi në vend ka ndryshuar në tërësi dhe ndërsa në sipërfaqe kanë dalur me mijëra raste të njerëzve të zhdukur të cilat është dashur të hulumtohen. Komisioni ka pasur ndikim të madh ngase ka bërë edhe punën e mediave. Edhe më herët kam folur për këtë por ata kanë organizuar konferenca për shtyp, intervista, programe komunikuese dhe gjatë gjithë kohës janë paraqitur në medie gje që ju ka ndërtuar një profil shumë domethënës. Mbi këtë komision mund të thuhet shumë çka por ajo që ja vlenë të thuhet është se përmbajtja e raportit përfundimtar është bërë bestseller kombëtar, dhe se edhe sot e asaj dite është libri më i kërkuar në historinë librare të Argjentinës. Konsideroj se ky është një rezultat i pabesueshëm, dhe se një rezultat i tillë nuk mund të arrihet gjithandej. Një rezultat i tillë mund të arrihet në vendet me arsimim të ultë, mirëpo kjo është një e arritur e pabesueshme. Ky komision raportin e tij e ka titulluar *Nunca Mas*, gjegjësisht raport *Kurrë më*. Dhe në këtë mënyrë ky komision e ka filluar punën. Mirëpo, kishte edhe probleme të cilat e përshkonin punën e këtij komisioni të parë dhe kryesisht kanë të bëjnë me faktin se rrëfimet janë marrë nga dorë e dytë dhe si të tilla nuk janë analizuar sa duhet as nga organizatat joqeveritare dhe as nga shoqatat etë zhdukurve dhe familjarët e tyre. Mbase më vonë do të mund të ju ofroj edhe të dhëna tjera mbi komisionin e Argjentinës, mirëpo këto ishin përvojat më relevantet.

Komisioni i radhës mbi të vërtetën është themeluar në **Ugandë**, dhe është me interes të dihet se sot në Ugandë po planifikohet themelimi i komisionit tjetër ngase ai i pari ka funksionuar për nëntë vjet. Më heret e kam përmendur këtë komision si një shembull kur kam thënë se një komision ka punuar nëntë vjet. Ky ishte ai shembull. Është themeluar në Ugandë dhe shumë shpesh i ka mbyllur dhe rihapur zyrat e veta në mungesë fondesh. Kjo në të kaluarën ka ndodhur shumë shpesh, gjë që sot edhe nuk është gjendja e tillë, ngase në të kaluarën janë themeluar komisionet por që mos të ketë fonde të mjaftueshme gjë që është një prej elementeve bazë për funksionalizimin e punës së tyre. Antarët e komisionit mund të jenë engjuj, mirëpo nëse nuk ka mjete, nëse komisioni nuk ka në dispozicion një buxhet të caktuar, ajo nuk do të arrijë suksese të dëshirueshme. Komisioni në Ugandë ka shënuar disa të arritura të konsiderueshme; mendoj se e arritura kryesore ishte rekomandimi që të themelohet komisioni kombëtar për të drejtat e njeriut, e cila nuk ka ekzistuar më herët. Ky rekomandim është aprovuar menjëherë pas publikimit të raportit të këtij komisioni. Ky ishte rekomandimi bazë. Gjithashtu ky ishte edhe komisioni i parë që organizoi dëgjime publike. Dhe, tani më lejoni që ti hap kllapat dhe të them se në rastin konkret dëgjimet publike i ngjanin seancave gjyqësore. Pra, nuk ishin seanca dëgjimore si ato të organizuara në Afrikë

e Jugut dhe në disa vende tjera, të tilla ku do të dëgjoreshin viktimat, mbi të cilat do të flasim më shumë dhe më në detaje nesër. Në një numër të madh shtetesh, sidomos në ish anëtarët e Federatës, dëgjimet publike janë menduar si marrje në pyetje, të cilat do të udhëhiqeshin nga gjykatësi, i cili në të vërtetë edhe do të ishte gjyqtar; ai do të udhëhiqte komisionin hetimor, do të thirrte dëshmitarët dhe seancat e tilla më shumë i ngjanin seancave gjyqësore se sa dëshmive të viktimave. Sidoqoftë, ky ishte komisioni i parë i cili organizoi dëgjimet publike.

Komisioni i radhës mbi të vërtetën... Vetëm se, duhet ta theksojmë se këto trupa nuk janë quajtur komisione mbi të vërtetën; kjo ka ardhur më vonë, por ishin të organizuar dhe funksiononin si komisioni për të vërtetën. Komisioni i radhës është themeluar në **Nepal**, në të cilin edhe sot po paraqitet një trend, e ky është themelimi i edhe një komisioni për të vërtetën ngase e para thjesht nuk e ka kryer punën në mënyrë efikase. Çfarë ka ndodhur në të vërtetë? Diçka e tillë ka ndodhur edhe me komisionet e mëhershme të cilat qoftë për mungesë të mjeteve, apo për shkak të mungesës së mbështetjes publike apo politike, i kanë mbyllur dyert e tyre para përfundimit të punës. Sikur edhe e keni të njohur tashmë, këtu në Serbi komisioni mbi të vërtetën dhe pajtimin ka shënuar pak të arritura dhe i ka mbyllur zyrat eveta para përfundimit të mandatit. Në Nepal ka ndodhur e njëjta gjë.

Komisioni tjetër i radhës është ai i **Qiles** të cilën e kam përmendur dhe më parë. Qile e ka themeluar këtë komision në vitin 1990. i cili për herë të parë e ka marrë emrin e Komisionit për të vërtetën; ishte i pari i cili u shërbye me këtë term. Sërish është paraqitur idea e thjeshtë se për të arritur deri të pajtimi i mundshëm së pari duhet të dilet në shesh me të vërtetën, dhe kjo ishte ideja e ndërlihdjes së këtyre dy koncepteve, i të së vërtetës dhe pajtimin. Ky ishte një komision shumë i rëndësishëm për të vërtetën. Komisioni i ka studiuar përvojat e arritura në Argjentinë, në shoqëri dhe në qeveri. Pra e kanë studiuar përvojën e Argjentinës, mirëpo është dashur që ta zgjedhin një qasje tjetër. Ky ishte një komision shumë i rëndësishëm i cili e ka analizuar atë se çfarë ka ndodhur në Argjentinë gjatë m,arjes së vendimeve. Qeveria e Çilit e ka studiuar këtë model, mirëpo të njëjtën gjë e ka bërë edhe shoqëria civile. Ata kanë pasur njohuri mbi modelin Argjentinës, mirëpo është dashur të aplikojnë një qasje tjetër ngase sihte në fuqi amnestia, e cila është në fuqi edhe sot e asaj dite. Në të vërtetë bëhet fjalë për një vetëamnesti e cila është aprovuar gjatë regjimit të Augusto PinoShetit. Gjë që nënkupton se ky komision nuk ka mund të garantoj një gjykim të drejtë të rasteve për shkak të amnistisë gjë që i ka krijuar imazh të keq që në fillim. Meqenëse njerëzit këtë komision e konsideronin si zëvendësim për drejtësinë e munguar, por që nuk mund ta sjellë këtë drejtësi në vend për shkak të amnistisë

dhe disa pengesave tjera, Pinochet pas largimit nga posti i presidentit, mbeti për një decaenë udhëheqës i lartë i forcave të armatosura, kështu që edhe ju vetë mund ta merrni me mend nëse ka qenë e mundur të punohet në kushte të tilla, në kuptimin politik. Mirëpo, megjithatë kanë vendosur që të dalin në shesh me të vërtetën. Mirëpo që të gjithë ju duhet ta keni parasysh se sa kontarverse ka qenë ajo kohë, ngase është fokusuar në një rreth të ngushtë të krimeve të rënda – është marrë me rastet e zhdukjeve, zhdukjeve nën presion dhe rasteve të torturave të cilat për pasojë kishin vdekjen. Viktimat të cilat e kanë mbijetuar këtë torturë nuk ishin nën mandatin e komisionit çilean për të vërtetën dhe pajtimin. Ekzistonin dhjetëra mijëra njerëz të cilët i kanë mbijetuar torturës, mirëpo ato nuk ishin të përfshira në mandatin e komisionit. Atëherë është vendosur se duhet të zgjidhet fati i njerëzve të zhdukur, numri i përgjithshëm i të cilëve ishte diku mes tremijë dhe katërmijë, dhe ky ishte hapi i parë. Gjithashtu pjesë e një rëndësie të veçantë; sot do të fokusohem në Çile ngase edhe sot e asaj dite paraqet një model shumë me rëndësi. Ajo ka aprovuar një qasje vërtetë interesante në përzgjedhjen e anëtarëve të komisionit – ky është komisioni i parë dhe i vetëm që ka pasur numër qift të anëtarëve. Kjo është vërtetë e pazakontë. Pra janë zgjedhëtetë anëtarë të komisionit. Të gjitha komisionet tjera, nëse e shihni, kishin tre, pesë apo shtatëmbëdhjetë anëtar; pra gjithnjë numër tek të anëtarëve. Ky komision kishte tetë anëtar; katër anëtar të komisionit në publik ishin të njohur si simpatizues të regjimit të Pinochetit, ndërsa katër të tjerët ishin kundërshtarë të këtij regjimi. Sidoqoftë, ishte kjo një qasje shumë e rrezikshme, megjithëse doli se ishte një vendim i mençur ngase ishte pikërisht ky komision i cili konfirmoj se p.sh. 95% e rasteve të zhdukjeve nën presion dhe të vrasjeve mund t'i atribuohen shtetit. Ky ishte rezultat i raportit, i cili u aprovua në mënyrë unanime, ashtu që në fund anëtarët e komisionit të njohur në opinion si ihtarë të regjimit të Pinochesë janë pajtuar me rezultatet gjë që këtyre rezultateve ju dha një kredibilitet të lartë. Është shumë interesant se ky model nuk është aplikuar askund tjetër edhe pse kishte një ndikim të madh dhe i dha një kredibilitet rezultateve përfundimtare në Çile. Sërisht më duhet ta them se nuk mund të flas edhe shumë mbi këtë komision, mirëpo do të thoja se ajo ka lënë pas dy rekomandime shumë të rëndësishme – e para ka të bëjë me aplikimin e një programi për reparacion për familjet e të zhdukurve dhe të vararëve e që më vonë është bërë si model, por që ka mbetur paksa kontravers ngase me dhjetëra mijëra të mbijetuar nga torturat në vend se të jenë të privilegjuar gjatë trajtimeve mjekësore në qendrat e klinikave mobile të cilat janë ndërtuar vetëm për viktima, ngelën jashtë programit për reparacion. Më pas komisioni gjithashtu ka sugjeruar themelimin e një trupi tjetër i cili do të vazhdonte me hulumtimin e rasteve të cilat ky komision nuk ja ka dalë që t'i zgjidh. Dhe kjo trupë e ka

vazhduar këtë punë shumë të rëndësishme.

Komisioni i radhës për të vërtetën,... unë po shkoj sipas një rendi kronologjik. Fitohet përshtypja se unë po kërcejë sa prej një vendi në vendin tjetër, por unë në të vërtetë po e përcjellë qasjen kronologjike. Komisionet janë themeluar në vende të ndryshme, ndonjëherë përtej oqeanit, përtej dy oqeanëve, në mënyrë që të shihet se si komisionet tjera janë ballafaquar me trashëgiminë e tyre. Komisioni tjetër është themeluar në **Çad**, në Afrikë, dhe ishte ajo e para e cila kishte të drejtë t'i thërriste me emër kriminelët e caktuar, në mënyrë që të vejë në pah përgjegjësinë e tyre në raportin final.

Ky komision ka shkuar edhe më larg ngase i ka publikuar edhe fotografitë e personave të përmendur me emër. Që atëherë asnjë komision tjetër nuk e ka bërë një gjë të tillë. Ky komision, fatkeqësisht është konsideruar si politikisht e anshme, gjë që mund të shihet edhe nga vet emërtimi i këtij komisioni. Pastaj ky komision ka punuar në kushte vërtetë të vështira të sigurisë. Shumë anëtarëve të komisionit ju kanë drejtuar me kërcënime me vdekje. Disa nga at, respektivisht një numër i madh i tyre, ka dhënë dorëheqje dhe janë zëvendësuar ngase ishte shumë me rrezik ta bësh punën e tyre. Buxhetin e kishin shumë të vogël ndërsa intervistat është dashur t'i bëjnë në ish llogoren ngase ishte e vetmja ndërtesë të cilën e kishin në dispozicion, gjë që i ka bërë viktimat që të kthehen në vendin ku janë torturuar. Mund ta paramendonin se si ka ndikuar kjo në këto viktima, por kjo ndërtesë ishte vërtetë e vetmja me të cilën ata dispononin. Pra, kjo ishte dikur, mirëpo edhe ky komision ka disa aspekte interesante të cilat duhen përmendur.

Pas kësaj është themeluar komisioni i parë për të vërtetën në Evropë. Unë jo gjithmonë pajtohem me atë se ky ishte një komision për të vërtetën, mirëpo është konsideruar si i tillë. Është themeluar në **Gjermani**. Është themeluar në Gjermani më shumë si një komision hetues kuazi-parlamentar i cili është marrë vetëm me krimet e kryera gjatë periudhës së socializmit dhe në lidhje me Stacin. Ishte ky një komision për të vërtetën, mirëpo ka funksionuar në mënyrën tipike gjermane, si një ushtrim intelektual, janë organizuar debate publike dhe dëgjime publike, mirëpo ishte kjo një qasje vërtetë intelektuale e komisionit e cila nuk përzihej shumë me publikun. Mirëpo, krahas këtij komisioni, ekziston edhe shembulli i komisionit për të vërtetën dhe pajtimin i Serbisë. Janë këta dy shembuj të vetëm që kanë ekzistuar në Evropë dhe të cilët janë zhvilluar. Mirëpo pr ju mbase më me rëndësi është modeli gjerman. Ky komision *per se* nuk ishte regjional, por në një farë mënyrë është themeluar pas ribashkimit të vendit dhe kishte të bënte me dy shtete dikur të ndara. Kështu që edhe ja vlen që të përmendet.

Komisioni i radhës është themeluar në **El Salvador** dhe, edhe ky komision ishte i ndryshëm në shumë mënyra. Ky komision është themeluar në bazë të një marrëveshje për

paqe. Ky është komisioni i parë krijimi i të cilit mbështetet në një marrëveshje për paqe dhe konsideroj se është i rëndësishëm në një aspekt, e që ka të bëjë me komisionin regjional për të cilin jeni duke menduar ju këtu, për të cilin është e nevojshme një marrëveshje multilaterale, dhe mund të themi se ekziston një precedent në rastin e nënshkrimit të këtyre marrëveshjeve, në rastin e El Salvadori ishte kjo marrëveshja për paqe. Kombet e Bashkuara në këtë rast, gjithashtu e kanë nënshkruar marrëveshjen si një lloj mbështetje morale në këtë praktikë. Siguria në El Salvador ishte aq e keqe sa që të tre anëtarët e komisionit, të cilët ishin ndërkombëtarë (ky është rasti i vetëm ku nuk është arritur një marrëveshje për anëtarët vendorë të komisionit, kështu që janë vendosur anëtarë ndërkombëtarë), është dashur ta lëshojnë vendin dhe që pjesën më të madhe të punës ta bëjnë nga Uashingtoni. Situata e sigurisë ishte shumë e keqe. Ishte aq e keqe sa që çdo viktimë apo anëtar i familjes së viktimës, është dashur të dëshmoj apo të intervistohet në fshehtësinë më të lartë. Njerëzit nuk kanë guxuar t'i vizitojnë zyrat e komisionit për shkak të rrezikut që ju kërcënohej. Nëse do të shiheshit në afërsi të lokalëve të komisionit, kjo do të paraqiste një rrezik potencial për kërcënim me vdekje. Megjithatë ky komision për të vërtetën e ka kompiluar raportin përfundimtar në një afat shumë të shkurtër, ngase në atë kohë komisionet për të vërtetën në Afrikën e Jugut, kanë funksionuar për vetëm tetë apo nëntë muaj dhe nuk kishte dëgjime publike por vetëm është ndërmarrë një hetim intensiv. Ky raport kishte ndikime pozitive dhe negative. Ndikimi pozitiv ka të bëjë me faktin se komisioni ia doli që t'i dëshmoj një numër të madh rastesh të cilat i quajti raste ilustrative. Komisioni e kuptoi se nuk mjafton të mbledhësh shumë informata, por se në raste të veçanta duhet të hynë më thellë me shpresë se këto raste do të shërbejnë për edukimin dhe informimin e publikut mbi përvojat e njerëzve dhe kjo është ajo që ata e bëjnë. Problem ishte fakti se anëtarët e komisionit ishin të huaj kështu që e tërë qeveria i është kundërvënë duke insistuar në atë se „ata nuk dinë asgjë mbi situatën e vërtetë në vend.“ I tërë personeli i komisionit përbëhej nga të huajt, gjë që ishte shumë me rëndësi për neutralitetin e komisionit, por në anën tjetër ishte hendikep karshi legjitimitetit të rezultateve përfundimtare. Do ta përmendë vetëm një gjë. Komisioni ka propozuar që të gjithë anëtarët e Gjykatës supreme të tërhiqen nga pozitat e tyre, gjë që ata natyrisht nuk e kanë bërë, mirëpo është interesant se që të gjithë anëtarët e Gjykatës Supreme gjatë viteve në vijim janë tërhequr një nga një nga pozitat e tyre; kanë dhënë dorëheqje, ose u është kërkuar që të japin dorëheqje, ose janë dërguar në pensione të parakohshme. Fakti të cilin komisioni e ka vërtetuar, e që ka të bëjë me moskompetencën dhe lëshimet e Gjykatës Supreme, megjithatë ka pasur ndikim të madh. Fatkeqësisht, vetëm një javë pas publikimit të raportit final,

në të cilin sugjerohet ndjekja penale, prezantimi i individëve të caktuar, pastaj është sugjeruar largimi i gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, qeveria ka miratuar ligjin për amnesti, i cili është edhe sot në fuqi.

Do doja ta bëjë një pushim prej disa sekondash që t'ju them se unë po provoj që t'ua prezantoj anët pozitive dhe ato negative. Unë nuk dua që t'ua rrisë shpresat e as të ju zhgënej, por vetëm t'ua prezantoj disa anë të mira dhe disa të këqija ngase mendoj se është i një rëndësie të veçantë që të njoftoheni me të dy anët.

Shri Lanka është vendi tjetër ku është themeluar komisioni për të vërtetën dhe atë në mes të luftës. Aty është bërë një gjë shumë interesante të cilën duhet ta përmendim në kuptimin e idesë për komision regjional i cili është prezent edhe këtu, në ish Jugosllavinë. Ky komision kishte tri nënkomisione, apo ndoshta do duhej t'i përshkruanim si komisione nën-nacionale puna e të cilave ka qenë e harmonizuar, por që zhvillohej në pjesë të ndryshme të vendit. Ky komision ka organizuar edhe dëgjime publike, por prap se prap edhe këto dëgjime i ngjanin shumë seancave gjyqësore. Komisioni, fatkeqësisht, nuk kishte ndikim më të madh ngase luftë ende po vazhdonte; lufta qytetare i cila po vazhdonte e pamundësonte punën e komisionit në një masë të konsiderueshme, ngase nuk mund t'i qaseshin viktimave, fakteve dhe dëshmitarëve. Komisioni disa herë ka qenë shënjestër e sulmeve me bomba, të cilat ndoshta nuk kanë qenë të drejtuara kundër komisionit, por lufta po vazhdonte, gjë që e vështirësonte punën e komisionit. Pra, siç mund ta shihni, siguria është një element i rëndësishëm, jo vetëm që viktimat të ndjehen të sigurta në mënyrë që t'i drejtohen komisionit, por ka të bëjë edhe me sigurinë e vet anëtarëve dhe personelit të komisionit. Dhe sërish, mendoj se nuk ka as edhe një shembull, ku anëtarët e komisionit e kanë kryer punën në kushte të plota të sigurisë. Mendoj se nuk ka as edhe një komision anëtarët e të cilit nuk kanë qenë të kërcënuar dhe të cilët nuk kanë punuar nën presionin e frikës. E tëra që ka ndryshuar është niveli i pasigurisë, por pasiguria edhe ashtu ka qenë gjithnjë prezentë, mirëpo konsideroj se është mëse e domosdoshme të thuhet se komisioni për të vërtetën paraqet, sidomos për autorët e krimit, një nivel të caktuar të kërcënimit. Dhe, në vijim vetëm edhe një gjë që ka të bëjë me komisionin për të vërtetën në Shri Lankë. Atje, këtij komisioni i janë bërë thirrje të rreme për bomba apo sulme me bomba, vetëm e vetëm për ta parë se si do të reagoje ky komision në rast të një sulmi të vërtetë.

Vendi i radhës në të cilin është themeluar komisioni për të vërtetën është **Haiti**. Ky ishte komisioni i parë i cili e ka përcjellur një model të ndryshëm. Komisioni kishte përbërje hibride; atë e përbënin anëtarët ndërkombëtarë dhe vendor. Gjithashtu, ishte ky komisioni i parë dhe i vetëm i cili merrej me dhunën seksuale të kryer ndaj femrave dhe

meshkujve. Komisioni obligohej që t'i kushtoj një vëmendje të veçantë dhunës seksuale. (është e vërteta, komisioni, as në këtë rast nuk ka shfaqur ndonjë sukses. Së shpejti do të flasim për disa shembuj pozitiv, edhe pse komisionet si në Argjentinë ashtu edhe në Qile, në parim paraqesin shembuj shumë të rëndësishëm dhe pozitiv. Mirëpo në mandatin e komisionit për të vërtetën të Haitit –dhe kjo është shumë me rëndësi të përmendet - ky komision urdhërohej që raportin final t'ia dorëzoi kryetarit, ndërkohë që nuk flitet për të drejta e kryetarit, dhe as obligimi i publikimit të raportit. Dhe, siç edhe është parashikuar, raporti final i komisionit është publikuar vetëm shumë vjet më vonë pas trysnisë së madhe dhe pas shtimit të disa të dhënave konfidenciale, të cilat deri më ditën e sotit kanë ngelur si të tilla. Dhe, fatkeqësisht në shembullin e Haitit, puna e komisionit nuk qon kah ndjekja penale edhe përkundër rekomandimeve të komisionit. Mirëpo, mendoj se kjo më parë ka të bëjë me qeverinë, e cila nuk mundet gjithmonë të kontrollohet ngase ndonjëher një qeveri e themelon komisionin për të vërtetën ndërsa më pas, në pushtet vjen qeveria tjetër e cila nuk e mbështetë punën e komisionit. Në rastin konkret, komisioni nuk ka marrë mbështetjen e mjaftueshme politike që në start, e besa edhe Kombet e Bashkuara nuk ishin dhe shumë këmbëngulëse në raport me qeverinë gjë që i ka shkaktuar dëme shumë të mëdha vetë komisionit.

Pra këto ishin të gjitha përvojat e komisioneve për të vërtetën deri në **Afrikën e Jugut**. Dhe, tani në radhë është një komision për të cilin jam i sigurt se keni dëgjuar, e ky është komisioni jugafrikan për të vërtetën dhe pajtimin. Ky është komisioni i parë me ndikim global. Komisionet nga Argjentina, Qile, El Salvadori janë të njohura, mirëpo në Amerikën Jugore sikur ekziston një traditë e themelimit të komisioneve mbi të vërtetën dhe kjo traditë është ruajtur edhe sot e asaj dite. Komisioni jugafrikan është komisioni i parë për të cilin thuhet se ka pasur ndikim global. Sa i përket madhësisë së tij, gjegjësisht numrit të personelit, ishin mbi 300 njerëz në personelin e komisionit, 17 anëtar të komisionit, buxheti vjetor i komisionit në atë kohë ishte 18 milion dollarë; mandati i tij ka qenë i dokumentura në 63 faqe; ky komision e ka zvogëluar rëndësinë e të gjitha komisioneve pararendëse në kuptimin e gjerësisë së mandatit, funksioneve të tija dhe gjithë tjerave. Siç e keni të njohur, ky ishte komisioni i vetëm i cili kishte autorizimin e dhënies së amnistisë – amnisti këto të kushtëzuara, sikur edhe mund ta dini individët e caktuar është dashur të paraqiten vetë para komisionit dhe t'i bëjë publike krimet të cilat i ka kryer, që të ballafaqohet me avokatin e komisionit dhe që të ballafaqohet me vetë viktimat, t'i përgjigjet pyetjeve; dhe ajo që do duhej ta përmendja për fund është se janë dorëzuar 7.500 paraqitjeve për amnisti dhe se rreth 80% të këtyre kërkesave janë refuzuar. Gjithsej rreth 1.700 persona e kanë fituar amnistinë me anë të kësaj procedure.

Kjo procedurë e ofrimit të amnistisë në Afrikën e Jugut në një farë mënyre ka qenë e suksesshme për shkak të proceseve të gjyqimit, të cilat zhvilloheshin në të njëjtën kohë dhe paralelisht ngase që në fillim krijuesit e komisionit e kanë ditur se kryesit e veprave kriminale duhet të frikësohen me ndjekje penale në mënyrë që të dalin para komisionit. Në të kundërtën ata vetëm do të heshtnin. Pse do të dilnin ata para familjes suaj e të dëshmojnë se janë ata të cilët e kanë torturuar dhe të ballafaqohen me komunitetin, kolegët për të cilët ju keni konsideratë. Pse do të rrezikonin që t'i nënshtrohen turpërimit publik kur rreziku për të dalë para gjyqit kështu është më i vogël? Pra, gjykimet paraqisnin një pjesë të konceptit të komisionit mbi të vërtetën në Afrikë e Jugut. Edhe ky komision është themeluar vetëm pas dy vjet debatesh publike, dhe pas dy vjet konsultash. Secili anëtar i komisionit është dashur t'i nënshtrohet intervistimit publik, gati sikur kur të emërohen në Gjykatën Supreme. Komisioni është ... Kjo është gjithashtu me interes, ... Ky është komisioni i parë i udhëhequr nga një lider fetar, peshkopi Tutu. Në parim kjo ka funksionuar mirë në Afrikën e Jugut, por ka pasur edhe anët negative ngase është krijuar.....mendoj se peshkopi Tutu në një farë mënyre është konsideruar si dikush i cili ka insistuar në atë që viktimat t'ia falin mëkatet kryesve të veprave të krimit. Kjo qasje ishte temë e debateve kushtetuese më ç'rast gjyqi e ka mbështetur amnistinë e cila gjendet në statutin e komisionit mbi të vërtetën, por që në fund peshkopi Tutu, si lider fetar, i cili edhe mbante rroba të udhëheqësve fetar në dëgjimet publike, ka ndikuar që komisioni mos të shikohet si trupë për dëshminë e vërtetësisë, por më parë si një trup për pajtim. Edhe në disa komisione tjera janë përdorur figura fetare, edhe pse është goxha me rrezik, biles edhe për Afrikën e Jugut, por, megjithatë Tutu në parim ishte personi i duhur. Komisioni mbi të vërtetën në Afrikën e Jugut e ka hulumtuar, punuar dy vjet e gjysmë në disa detaje dhe i ka verifikuar disa fakte mbi 23.000 raste individuale me ndihmën e personelit, i cili numëronte 350 njerëz, të cilët kanë punuar për dy vjet e gjysmë. Komisioni gjithashtu i ka organizuar mbi njëqind ditë të dëgjimeve publike gjatë të cilave janë dëgjuar rreth 2.000 persona, pra më pak se 10%, të viktimave kanë pasur mundësi që t'i drejtohen këtij komisioni. Do ta shpjegoj se pse janë më pak se 10% por gjithashtu do ta shihni se dëshmia e 2.000 viktimave deri më tani është numri më i madh i viktimave që kanë dëshmuar publikisht. Mbase kjo është një prej gjërave të rëndësishme që duhet të thuhet në lidhje me komisionin, edhe pse për Afrikën e Jugut ka edhe shumë për tu thënë, por mbase duhet përmendur një inovacion i cili është futuri nga komisioni i Afrikës së Jugut – ky komision nuk e ka organizuar vetëm dëgjimin publik të viktimave, por ka organizuar edhe një mori dëgjimesh tjera. Që të jemë më i saktë, komisioni ka organizuar diçka që njihet si e dëgjimi kushtetues në të cilin janë ftuar një mori institucioneve të caktu-

ara, medie, përfaqësues të profesionit të mjekësisë, policisë, ushtrisë, që të vinë, jo si individ por si përfaqësues të atyre institucioneve dhe që t'i ofrojnë qëndrimet e tyre mbi rolin e këtyre institucioneve në ngjarjet e të kaluarës, si dhe mbi rolin që këto institucione duhen ta kenë në të ardhmen, me fjalë të tjera që vëmendja të drejtohet jo vetëm nga individët por edhe nga përgjegjësia institucionale me anë të këtyre dëgjimeve.

Ky komision gjithashtu ka organizuar dëgjime në lidhje me raste konkrete. Në të kaluarën e Afrikës së Jugut kanë ndodhur disa ngjarje të caktuara të cilat kanë kërkuar vëmendje të veçantë, si psh. Masakra e Sharpwillit, rebelimi i Sowetos, kështu që komisioni përveç dëgjimeve individuale ka organizuar edhe dëgjime që kanë të bëjnë me ngjarje të caktuara ngase kanë konsideruar se është e nevojshme që duhet të dëgjohet për disa ngjarje në mënyrë që të krijohet një pasqyrë më e gjërë. Edhe at ngjarje kanë pasur një rëndësi të veçantë në historinë e këtij vendi saqë kërkojnë një vëmendje të veçantë. Komisioni gjithashtu ka organizuar seancë dëgjimore të partive politike. Përveç këtyre dëgjimeve komisioni ia ka kushtuar një vëmendje të veçantë temave të caktuara. Janë organizuar dëgjime publike tematike mbi krimet që janë kryer mbi gratë ose fëmijët. Edhe në këtë aspekt ky komision ka qenë inovativ. Pas këtij komisioni janë krijuar edhe dy komisione në Amerikën Latine. Siç ua kam thënë edhe më herët, atje ekziston një traditë në themelimin e komisioneve. Një është themeluar në Ekuador. Ajo është liruar pas disa muajve dhe sot në Ekuador funksionon një tjetër komision mbi të vërtetën, pasi që e para nuk ka punuar ashtu siç duhet.

Tjetra është themeluar në **Guatemalë**. Guatemala gjithashtu është shumë specifike dhe do të përmend vetëm disa tipare që mendojë që janë të rëndësishme për rajonin. Ky është një komision në krye të të cilit është një i huaj dhe vendor, do të thotë tre anëtarë në tërësi. Është themeluar me marrëveshje paqësore. Komisioni ka funksionuar 18 muaj, por nuk ka mbajtur dëgjime publike sepse po përcillte traditën e Amerikës Latine që të mos organizohen dëgjimet publike dhe për shkak të sigurisë së përgjithshme gjithashtu nuk janë lejuar dëgjimet publike. Edhe pse situata e sigurisë shpesh mund të mos lejojë mbajtjen e dëgjimeve publike ato mund të mbahen në një rreth të ngushtë por ja që kjo është një gjë tjetër. Edhe pse komisioni në Guatemalë nuk ka organizuar dëgjime publike prap ka ushtruar ndikim të fuqishëm. Ai ka organizuar ceremoni të ndryshme dhe ngjarje në tërë vendin, me qëllim të promovimit të raportit përfundimtar. Në raportin përfundimtar komisioni ka vërtetuar që për një periudhë të shkurtër kohore në një pjesë të caktuar të territorit të shtetit është kryer gjenocid. Dhe kjo ka qenë tejet me rëndësi për kontekstin e Guatemalës i cili ka kaluar pa patur shumë dënime madje edhe në ditët e sotme. Qeveria ka hedhur poshtë këto

përfundime por me kohë ka ardhur deri tek pranimi i faktëve që aktet e gjenocidit me të vërtetë janë kryer. Raportet përfundimtare të Komisionit për të vërtetën në Guatemalë janë unike sepse nuk i ka definuar vetëm faktet për viktimat por edhe përgjegjësinë institucionale. Komisioni gjithashtu ka nxjerrë dhe publikuar mostra, tregime, tregime të qindra viktimave. Nuk ka qenë vetëm raport ligjor me fakte por edhe raport me dëshmi me emrat e personave që janë futur në një pjesë të veçantë të raportit. Kështu një pjesë të raportit e përbëjnë faktet, tjetra dëshmitë të cilat gjithashtu konsiderohen të rëndësishme.

Në rregull. Tani duhet të vazhdojmë për shkak të kohës. **Nigeria** ka themeluar një komision të rëndësishëm për të vërtetën. Konsideroj që është me rëndësi që ky komision na ka dhënë një mësim të dobishëm për formimin e komisioneve për të vërtetën. Ky komision ka angazhuar qindra dëgjime publike që kanë qenë aq të popullarizuara ku njerëzit kanë shkruar dhe kërkuar nga stacionet televizive që të përsërisin vazhdimisht këto dëgjime. Por problemi fatkeqësisht qëndron në atë që komisioni nuk ka organizuar në mënyrë paralele edhe hetimet e rasteve që ka prezantuar në dëgjimet publike, dhe jo vetëm viktimat por edhe kryesit e veprave kanë mundur të thonë çfarë të donë. Nuk ka ekzistuar ndonjë arbitër për faktet sepse komisioni nuk ka siguruar që rastet që prezantohen, njerëzit që paraqiten kanë mundur të thotë gënjeshtër apo të vërteta. Dhe kështu vëmë tek ato që kemi përmendur më herët, që komisionet e së vërtetës duhet të zhvillojnë hetime, në të kundërtën nëse nuk keni fakte atëherë ekziston rreziku që në dëgjime publike të prezantoni raste për të cilat nuk keni fakte dhe njerëzit mund të paraqesin çkado nëse nuk ekzistojnë kriteret nëse është e vërtetë dhe apo prezantohet një e vërtetë faktike.

Edhe në **Kore** është themeluar një komision për të vërtetën. Ky është komisioni i parë i së vërtetës në Azinë Lindore. Ka qenë ky një komision i çuditshëm i cili është fokusuar në vetëm 85 raste. Dhe dimë fare pak për të. Gjëja më e rëndësishme që mësuam ishte që komisioni nuk pati profil nacional, nuk ka kryer ndonjë punë me media, nuk ka pasur kontakte me komunitetin dhe nuk ka zhvilluar komunikime. Pastaj e di që po ju shetis nëpër tërë rruzullin tokësor, por e bëj këtë për të treguar në modele të ndryshme. Komisionet janë themeluar edhe në Uruguaj, Panama dhe ato kanë pasuar traditën e komisioneve në Amerikën Latine që janë të shkurtra dhe pa dëgjime publike.

Në vitin 2001 Kryetari Koshtunica ka themeluar **Komisionin famoz për të vërtetën dhe pajtimin në ish Republikën Jugosllave**. Për atë komision nuk do të duhet të thoja asnjë gjë përveç që kemi nxjerrë mësim. Duhet të përmend një gjë që më ka mbetur thellë e ngulitur në kokë që Komisioni nuk do të hetojë përgjegjësitë e shtetit serb por vetëm atë të shteteve tjera dhe të studiojë jo vetëm

shkaktarët që iu referohen RSJ por edhe shkaqeve nga shtetet tjera. Dhe mendoj që kjo prek një prej vlerave të idesë rajonale dhe kjo është që duket të jetë e vështirë në një kontekst rajonal qll komisioni të jap të dhëna të besueshme jashtë kufijve të vet pa patur bashkëpunimin edhe të shtetit tjetër. Në rrethana të tilla vështirë mund të vihet deri tek faktet e pranuar prandaj mund të jetë kontraproduktive. Por ka edhe mësim të tjera, fatkeqësisht negative që i kemi nxjerrë nga kjo përvojë

Pastaj, në **Peru** është themeluar një komision shumë, shumë i rëndësishëm. Ky është komisioni i parë në Amerikën Latine e cila ka organizuar dëgjime publike. Do të shihni shembuj të atyre dëgjimeve publike për të cilat mendoj që janë më të fuqishmet prej të gjitha komisioneve për të vërtetën. Nesër, gjithashtu do të shihni dëgjime publike nga Afrika Jugore, Timori Lindor dhe Maroku. Atëherë do të flasim për këtë. Komisioni në Peru ka fituar aq shumë kredibilitet që nëpër anketa lidhur me hulumtimet në atë vend është konfirmuar që ajo përfaqëson një institucion të cilit qytetarët i kushtojnë më së shumti besim, që është një tregues i keq i besimit të qytetarëve në institucione publike, por mund të paramendoni se sa ka ndikuar kjo në forcimin e kredibilitetit të hulumtimeve të tyre përfundimtare dhe dëgjimeve publike. Në Peru kjo vlen për çdo lloj kontributi të cilin komisioni për të vërtetën mund të jep konfirmim të së vërtetës, njerëzit gjithmonë kanë besuar që kanë qenë rreth 35.000, mendoj midis 35.000 dhe 40.000 raste të vrasjeve dhe zhdukjeve që kanë ndodhur gjatë kohës së luftës civile dhe qeverisë autoritare. Për dallim nga Bosnja ku është konfirmuar që numri i viktimave nuk është as gjysma e asaj që është besuar që është, Komisioni për të vërtetën në Peru ka vërtetuar që ai numër është dyfish më i madh, që ka shkaktuar shok në tërë vendin. Njerëzit s'kanë mundur të besojnë, e as vet anëtarët e komisionit kanë qenë të shokuar me përmasat apo domenin e krimeve të kryera. Do të shihni shembuj të dëgjimeve publike, por mendoj se është një mënyrë shumë e rëndësishme përmes së cilës komisioni ka organizuar dëgjime publike të cilat kanë qenë aq të fuqishme, por këtë do ta lë për nesër.

Gjëja tjetër të cilën dua ta përmend në lidhje me Perunë është që ky është komisioni i parë që ka organizuar rreth 35 apo 360 dosje të cilat kanë qenë jashtëzakonisht mirë dhe në mënyrë të detajuar të organizuara dhe të cilat i ka kompiluar njësia për veprime ligjore pranë komisionit dhe të cilat ajo i ka proceduar. Unë kam parë disa prej atyre dosjeve dhe ato janë shumë voluminoze. Ato dosje iu kanë dorëzuar prokurorive nacionale dhe lokale dhe në të shumtën e rasteve janë ngritur aktakuza të cilat siç edhe vet e pranojnë, kanë qenë të një vlere të madhe për faktin që kanë dosje të organizuara. Kanë vendosur të përqendrohen në 350 raste për të cilat kanë pohuar të jenë të njohura dhe këto raste janë tani për tani duke u proceduar. Pra, ky ka qenë komisi-

oni i parë që ka sugjeruar jo vetëm riparime të veçanta, por edhe riparime për komunitete, dhe ai program tani fillon të implementohet.

Tani i afrohem i sotmes dhe në shembujt në vijim nuk do të përmend data por vijmë deri në të sotmen dhe do të flas vetëm edhe tre-katër minuta. Pra, nuk do zgjasë shumë. Gjatë disa viteve të fundit janë themeluar komisioni posaçërisht në Afrikë. Një është themeluar në **Ganë** e tjetra në **Siera Leone**. Nuk do flas shumë për komisionin në Sierra Leone vetëm se do të them që ka qenë komisioni i parë për të vërtetën që ka punuar paralel me gjykatën ndërkombëtare në Sierra Leone nën emrin Gjyqi Special i Sierra Leone. Mendoj që është me rëndësi të përmendet që nëse këtu themelohet një komision rajonal, ndoshta, por jo ndoshta por me siguri që në Kosovë do të mbetet gjyqi ndërkombëtar, e ndoshta edhe Këshilli për krime lufte në Bosnje. Në këtë rast kanë ekzistuar sfida të caktuara ligjore e teknike, por Komisioni për të vërtetën në Sierra Leone dhe Gjyqi special kanë vendosur që është më së miri për ta të provojnë të mbeten të pavarur njëri prej tjetrit, por komplementarë në mënyrë që të mos përzihen njëri me tjetrin. Në një mënyrë ky është një model i suksesshëm. Edhe një çështje në lidhje me Sierra Leone, e cila është e rëndësishme është që komisioni... në të vërtetë, ekzistojnë dy gjëra. Njëra është që shumë komisione për të vërtetën sot nuk kufizohen vetëm në vërtetimin e fakteve dhe dëgjimeve publike dhe intervista, por organizojnë aktivitete paralele me qëllim të përhapjes së pjesëmarrjes së publikut. Në këtë mënyrë komisioni peruan ka organizuar një ekspozitë me fotose e cila në fund ka mebur një muze i përhershëm në të cilën janë ekspozuar fotose të vendeve në të cilat janë kryer tortura, vrasje e masakra në tërë vendin. Edhe komisioni në Sierra Leone ka organizuar garë me emrin "Vizioni kombëtar". I kanë bërë thirrje të gjithë qytetarëve të dërgojnë veprat e tyre artistike (fotose, vargje, romane etj) përmes të cilave do të shprehin atë se çfarë dëshirojnë për Sierra Leone në të ardhmen. Komisioni ka pranuar me qindra fotose, vargje e piktura të cilat përfundimisht janë bërë pjesë e një muzeu të përhershëm i cili gjithashtu e mban emrin "Vizioni kombëtar".

Komisioni në Sierra Leone jo që e ka hartuar raportin përfundimtar, por e ka bërë edhe një version filmik, si edhe një version për fëmijë pasi që siç mund të jetë e njohur për ju, një numër i madh i kryesve dhe viktimave kanë qenë fëmijë. Pra, këto janë disa aspekte interesante.

Në fund, mendoj se ka edhe komisione tjera për të vërtetën që kam dashur t'i ndihmoj. Themi, komisionet për të vërtetën që janë themeluar në Republikën Demokratike të Kongos, Paraguai dhe një funksionon në Liberi. Vetëm dua që shkurtimisht t'ju kthehem dy komisioneve për të vërtetën. Njëra në Marok e tjetra në Kanada. Komisioni i parë për të vërtetën dhe pajtimin në **Marok** ka bartur emrin

Komisioni për drejtësi dhe pajtim, dhe ka përfaqësuar komisionin e parë i cili është themeluar në Lindjen e afërt dhe Afrikën Veriore. Ky komision gjithashtu ka qenë e para që ka pasur 17 anëtarë dhe të cilën e ka udhëhequr një njeri i cili poashtu ka qenë viktimë e torturës dhe i cili i ka kaluar 17 vjet në burg, një një burg joligjor në një vend që ka qenë i ekspozuar një torture të tmerrshme.

Ka pasur edhe më shumë anëtarë të Komisionit që kanë qenë viktima dhe kanë mbijetuar dhe kjo i ka dhënë komisionit një legjitimitet të jashtëzakonshëm. Megjithatë, e di nga përvoja gjatë punës me këtë komision, që një problem i caktuar e ka bërë fakti që viktimat dhe të mbijetuarit, anëtarë të komisionit të cilët i udhëheqin hetimet, lexojnë, intervistojnë etj. Për shkak të tmerrit të rasteve në të cilat kanë punuar, ata shpeshherë kanë shkuar në mjekime pasi që kanë përjetuar kriza dhe përsëri kanë kaluar nëpër trauma. Natyrisht, edhe nëse një person s'ka qenë viktimë e torturave apo dhunimeve, gjithmonë ka ekzistuar një nivel i caktuar i traumës vetëm gjatë dëgjimit të rrëfimeve. Por, nëse është në pyetje vet viktima, atëherë rreziku rritet dhe disa prej tyre janë të paafte për t'i kryer detyrat e tyre. Kryetari i komisionit ka qenë në gjendje të punojë gjatë tërë kohës por ai është një lloj i mbi-njeriut në shumë mënyra, por mendoj se kjo është një pjesë interesante.

Pra, komisioni i parë që ka pasur autorizim jo vetëm të udhëheqë hetime por edhe autorizim të ndajë shpërblime individuale pasi që i ka hetuar 22.000 raste dhe ka pranuar mendoj diku rreth 16.000 kërkesa. Njerëzit kanë marrë shpërblime individuale në procedura individuale në të cilat janë futur kriteret të shkathta për miratimin e shpërblimeve. Pra, ky ka qenë komisioni i parë për të vërtetën i cili qëllimisht ka futur qasjen në bazë të përkatësisë gjinore, mendoj në qasje të riparimeve, por tani nuk do të kem kohë të flas për këtë, por në përgjithësi ky është një komision interesant. Nesër do të dëgjoni për të më shumë.

Dhe në fund të them diç për komisionin e të së vërtetës në **Kanada**. Siç thashë, në Kanada do të themelohet komisioni i parë për të vërtetën. Në vëmendje është një vend për të cilin shumica e njerëzve nuk do të mendonin se ka nevojë të themelohet një komision për të vërtetën, por kjo ka kuptim në Kanada sepse ne kemi trashëguar një sistem shkollash në të cilat, nuk e dimë por paramendojmë që ai numër sillet midis 300.000 dhe 500.000 fëmijë që janë përzënë me dhunë nga shtëpitë e tyre dhe janë dërguar në shkolla në të cilat kanë qenë të ekspozuar keqtrajtimit sistematik, keqtrajtimit fizik dhe seksual dhe represionit kulturor. Të gjitha viktimat janë fëmijë. Ka ende rreth 80.000 viktima që kanë mbijetuar nga këto shkolla. Nuk e di a ka kjo ndonjë kuptim, por këto shkolla atje i kanë drejtuar kishat. Qeveria dhe kishat nuk kanë dashur që të themelohet komisioni për të vërtetën dhe pajtimin. Çfarë ka ndodhur në të vërtetë? 12.000 të mbijetuar nga këto shkolla kanë ngritur padi kundër shtetit dhe

kishës duke kërkuar dëmshpërblimin prej disa miliardë dollarë dhe kjo e ka shtyrë shtetin që të përmbyllë ujdinë prej 2 miliardë dollarësh në dëmshpërblime dhe 16 milionë dollarësh për themelimin e komisionit për të vërtetën dhe pajtimin. Pra, komisioni i cili nuk themelohet nuk kërkon kurrfarë vullneti politik. Ai do të themelohet me 1 qershor dhe atëherë do të fillojë me punën. Me 12 qershor Qeveria është përkushtuar që të kërkojë falje publikisht në dhomën e ultë të Parlamentit kanadez dhe do të shohim se çfarë do të ndodhë me këtë komision për të vërtetën dhe pajtimin. Këtë komision e kanë themeluar viktimat dhe të mbijetuarit, por për ata ajo s'do të ekzistojë. Kam menduar që ta përmbyll ligjëratën me këtë vërejtje pozitive.

*

... për rolin e shoqërisë civile. Ekzistojnë, unë gjithmonë e bëj dallimin mes tre llojesh të roleve të shoqërisë civile në periudhën para se të themelohet një komision i tillë, gjatë periudhës së punës së komisionit dhe rolit pasi komisioni ta ketë kryer punën e tij. Secili prej këtyre roleve është në mënyrën e vet i rëndësishëm. Sa i përket pjesës së parë, rolet që i luan në masë të madhe shoqëria civile, por mendoj që ekzistojnë disa tema të përbashkëta, por një është gjithsesi roli në atë masë që shoqëria civile në masë të madhe përmes organizatave joqeveritare dhe asociacioneve të viktimave është thjesht roli i përfaqësimit, ku ata flasin "ne mendojmë që kjo është me rëndësi për shoqërinë tonë dhe për këtë edhe jemi të përkushtuar", pra, strategjia bazë e përkushtimit është roli i parë. Roli i dytë është natyrisht dokumentimi sepse situata më e keqe është që komisioni për të vërtetën të themelohet dhe të fillojë prej asgjëje, që të mos ketë një set ekzistues të dosjeve dhe të dhënave dhe që duhet të punojë prej pothuajse asgjëje. Në anën tjetër, shoqëria civile, posaçërisht organizatat joqeveritare mund të zbatojnë një punë mjaft të mundimshme në dokumentimin dhe të posedojnë të dhëna të vlefshme dhe të bazuara, të dhëna të organizuara të cilat mund t'ia dorëzojnë komisionit për të vërtetën në origjinal apo kopje. Ky është një kontribut i rëndësishëm i cili në të vërtetë do të ndihmonte resurset të cilat do ta ndihmonin komisionin që resurset e tyre t'i drejtojnë në diçka tjetër për shkak të kohës së shkurtër. Ankesa e parë e secilit komision për të vërtetën qoftë nëse funksionon gjashtë muaj apo nëntë vjet, është se nuk kanë mjaft kohë, që kanë shumë raste, që nuk kanë mjaft punëtorë dhe nuk kanë mjaft para. Në këtë është gjithnjë e vërteta. Sepse, si mund të hetohen 10.000 raste në mënyrë të detajuar dhe të bazuar, në mënyrë njerëzore? Kjo është thjesht një detyrë tepër e madhe. Ajo me siguri se mund të zbatohet, por komisionet për të vërtetën gjithnjë ndjejnë, dhe do të thonë "kjo është paramenduar që t'i kontribuojë të së vërtetës", por ato janë mirë të përgatitura kur posedojnë të dhëna të mjaftueshme si pikë fillimi. Shumë komisione i kanë pasur ato dhe ato në përgjithësi janë ato

që kanë treguar sukses në punën e tyre. Pra, përderisa puna në dokumentimin zbatohet tani dhe kjo përfaqëson një kontribut të madh. Gjërat tjera praktike të cilat më së shpeshti i realizon shoqëria civile dhe si shembull për këtë sot e shohim këtë konferencë, janë konsultimet ku njerëzit nga spektrat e e ndryshme civile dhe qeveritare vijnë, diskutojnë, këmbejnë mendime etj. Por gjithashtu, mund të vijnë nga diaspora njerëz dhe të flasin për përvojat e tyre, vetëm për ta ofruar dimensionin krahasues të tërë problemit. Shpeshherë, komisionet për të vërtetën dalin pjesërisht në sipërfaqe për shkak të disa konsultimeve kyçe apo ndonjë konference ndërkombëtare ku të gjithë mbliidhen tre-katër ditë dhe aty krijohet ai moment, që ka qenë rasti me disa komisione.

Edhe dy gjëra. Njëra është se koalicionet krijohen përbrenda shoqërisë civile, në sektore të ndryshme të shoqërisë civile, të cilën angazhohen për realizimin e ndonjë qëllimi të caktuar, themi, të një komisioni për të vërtetën apo ndonjë projekti tjetër, por ka numër të madh të rasteve të tilla. Dhe, aq më shumë, që është shumë me rëndësi, trajnimi, ndërtimi i kapaciteteve, aktivitete të ndryshme të drejtuara kah ngritja e vetëdijes së njerëzve në lidhje me atë se çfarë janë ata e çfarë nuk janë. Poashtu do të thoja që është shumë me rëndësi që shoqëria civile është mjaft e përkushtuar dhe e gatshme që të propozojë një model shumë specifik për funksionimin e të drejtave, qoftë nëse bëhet fjalë për ndonjë ligj apo mandat, dhe që ai propozim t'i kalohet parlamentit apo presidentit. Kjo mund të kontribuojë angazhimit më të mirë. Kjo vjen pas konsultave dhe analizave dhe gjërave tjera, por deri më tani kemi parë disa raste në të cilat shoqëria civile ka hartuar planin për komisionin për të vërtetën. Ky ka qenë rasti në Peru. Ky ishte rasti në Maroko, vetëm ti potencoj disa shembuj. Qeveria ndoshta në esencë ka futur disa ndryshime, por ata kanë pasur një mandat shumë të qartë të cilin është dashur ta shqyrtojnë. Gjatë punës së komisionit janë paraqitur edhe shumë çështje të tjera – përcjellja e viktimave dhe dëshmitarëve gjatë dhënies së dëshmimeve, paraqitja në dëgjimet publike dhe çfarëdo mbështetje tjetër psikologjike, emocionale e mbështetje tjetër. Ekzistojnë edhe njerëz të tjerë në shoqërinë civile të cilët punojnë për komisionin për të vërtetën, të cilat ndoshta edhe bëhen anëtarë të komisionit, apo personelit të tij, e kjo është edhe njëra ndër çështjet. Gjithashtu, konsideroj se gjatë jetës së komisionit për të vërtetën një rol të rëndësishëm luajnë edhe mediat dhe shpeshherë është e rëndësishme që të kihet një strategji, cak i së cilës do të ishin mediat. Për shembull, në Afrikën Jugore komisioni ka pasur njësitin për media i cili ishte në gjendje që të bindë stacionin kryesor të TV, radio-stacionin dhe shtëpitë gazetareske që të caktojnë një reporter i cili do të mbulonte vetëm punën e komisionit për të vërtetën dhe ashtu përmes rrugës së raportimit të krijojnë një marrëd-

hënie ashtu që kualiteti i raportimit dhe vëllimi i raportimit si dhe frekuenca e raportimit të zmadhohet, e dini, njëkohësisht dhe unë mendoj se kjo ishte një çasje vërtetë e mirë. Dhe kur komisioni të përfundoj me punën e tij, për këtë do të bisedojnë nesër më gjatë. Roli kryesor i shoqërisë civile është në të vërtetë që të angazhohet rreth implementimit të rekomandimeve, sepse më nuk ka komision, nuk ka anëtarë komisioni, zyre, nuk ka asgjë dhe i tërë procesi në masë të madhe varet nga angazhimi i shoqërisë civile në realizimin e rekomandimeve.

*

Sa i përket Komisionit për të Vërtetën në Serbi, do t'ju them që nuk pajtohem plotësisht me qëndrimin tuaj mbi atë se çfarë do të duhej bërë me problemin në lidhje me këtë Komision në Serbi. Do t'ju them çfarë mendoj. Pajtohem me analizën tuaj të problemit të komisionit, por unë gjithmonë them që ashtu siç ekzistojnë gjykime të këqija, gjykime të padrejta, ekzistojnë edhe gjykime të drejta. Mendoj që vetë fakti që bëhet fjalë për gjykim të padrejtë nuk do të thotë që nuk bëhet fjalë për gjykim. Komisionet për të Vërtetën, ekzistojnë shembuj të mirë e të këqij. Por për mua të gjitha komisionet në të ardhmen janë komisione për të vërtetën nëse plotësojnë kriteret themelore. Mendoj që do të duhej të themi që kjo ka qenë thjesht një komision shumë i keq për të vërtetën. Për mua është me rëndësi që komisioni për të vërtetën të jetë i keq apo i mirë deri në atë masë kur ne, shoqëria civile dhe anëtarët e komisionit, e bëjmë vetë ashtu. Ato nuk kanë vlera trashëguese, në një mënyrë janë gjykatë e thatë, si dhe çfarëdo të vihet në të ai do të prodhojë ose rezultate shumë të rëndësishme ose jo. Ekzistojnë pika të ndryshme kur ato mund të përmirësohen apo keqësohen, apo do të paraqiten sfida, por kjo ka të bëjë thjesht me pikë-vështrime të ndryshme.

*

Sa i përket kalimit të kohës. Lirisht paraqitni qëndrimin tuaj nëse nuk pajtoheni me mua, sepse në fund të fundit edhe unë paraqes vetëm mendimin tim. Sa i përket kalimit të kohës – a lehtëson apo vështirëson gjërat – mendoj që të dyja janë të mundura. Nëse flasim përgjithësisht, aty ku ka numër të madh të rasteve të pazgjidhura të personave të zhdukur gjithmonë është kohë e rëndë, si dhe gjithmonë ekzistojnë argumente që flasin në favor të këtij Komisioni, sepse natyrisht që për familjet e personave të zhdukur është e kaluar, e kaluar jo vetëm deri në masën që shteti nuk është në gjendje të zgjidhë ato raste. Konsideroj që ekziston gjithmonë një argument i fuqishëm në favor të këtij Komisioni, sepse rastet e tilla duhen çartësuar, duhet zgjidhur fati i personave të zhdukur dhe për këtë mendoj që janë së paku shumë relevantë në këto raste. Por, prapë mund të jetë relevant; edhe në Kanada kemi një komision; këto shkolla kanë përfunduar punën e tyre në vitet e 60-ta, por ka 80.000 të mbijetuar të cilët kanë arritur ta ngrejnë

këtë rast para gjykatës. Mendoj që ekzistojnë mundësi të ndryshme. Mendoj që në një moment komisioni mund të kuptohet si i parakohshëm si dhe që njerëzit të mendojnë që ka kaluar shumë kohë, por pyetja kryesore është se në cilën masë njerëzit e asaj shoqërie mendojnë që e ardhmja e tyre, e ardhmja e tyre më e mirë varet apo kufizohet me mos-hetimin dhe mospranimin e fakteve nga e kaluara. Mendoj gjithashtu që derisa njerëzit mendojnë që e kaluara iu bllokoi të ardhmen, nuk është me rëndësi sa kohë ka kaluar, sepse ekziston një problem i cili pengon të ardhmen më të mirë.

*

Ndërsa komenti i fundit ka qenë mbi, në të vërtetë Natasha paraqiti qëndrimin mbi përqendrimin tek faktet, e më pak tek shkaqet, të cilat gjithmonë iu nënshtrohen interpretimeve të ndryshme. Disa fakte – që x personi ka vdekur në këtë mënyrë, në këtë vend, emri i tij/saj ka qenë ky – janë tejet të fuqishme dhe nganjëherë kjo është e vetmja e vërtetë që mund të vërtetohet, dhe mendoj që përqendrimi tek faktet krijon më pak rrezik të akuzave për anime, sepse disa fakte të vërtetuara janë shumë më të fuqishme. Por, sa më përket mua, unë vetëm do të shtoj që mendoj se faktet janë ende të pamjaftueshme për të arritur një lloj të tillë të katarzës shoqërore dhe mirëkuptimit mes grupeve, si dhe mendoj që vetë faktet, nëse nuk janë të ndërlidhura me tregime, tregimeve të njerëzve – e di që pajtoheni me mua, por vetëm po them – mendoj që këto janë dy pjesë të cilat janë më të rëndësishmet për komisionin rajonal që do të mund të themelojë këtu. Tregimet pa fakte nuk do të vlenin, por as faktet pa tregime nuk do të vlenin, por mendoj që të dyja bashkë do të mund të kishin një efekt shumë të fuqishëm. Në rregull, më lejoni t'ia jap fjalën këtij personi, e pastaj vazhdojmë.

Nuk do të doja të vonoj darkën, por më lejoni vetëm të paraqes edhe dy vështrime përfundimtare, sepse mendoj që janë të rëndësishme për një numër pretendimesh të paraqitura këtu. Mirë, do filloj me një anekdotë në lidhje me pretendimin e fundit që paraqitët. Nuk e di si do ta shikoni ju. Qeveritë dhe personat tjerë publikë, kur vendosin të shkojnë përmes procesit të përballjes me të kaluarën, thonë që qëllimi i atij procesi është hapja e një faqeje të re, mbyllja e atij kapitulli të historisë, por jam befasuar me thënien e kolegut tim të tanishëm, i cili më parë ka punuar për një prej organizatave më të rëndësishme jo-qeveritare në Afrikën e Jugut, kur Peshkopi Tutu i ka thënë “na duhet të mbyllem këtë kapitull, të përballemi me të, ta mbyllem e pastaj të vazhdojmë të ndërtojmë të ardhmen”; ai nuk ishte pajtuar me këtë dhe thoshte “jo, na duhet t’i mbajmë ato faqe para vetes, gjithmonë duhet ta kemi historinë para syve tanë si përkujtim i përhershëm”. Më nxiti mendimi juaj që ta them këtë, dhe mendova që do të ishte interesant një qëndrim tjetër ndaj kësaj. Sa i përket pyetjes së

dytë, mund të ndodhë që të përdorim terme të ndryshme, por të flasim për të njëjtën gjë, në gjuhën angleze ekziston një dallim i ndjeshëm mes hetimit të shkakut dhe hetimit të përgjegjësisë, por desha të them që për t’u pajtuar të gjithë është me rëndësi të kuptohen pasojat, faktet, ajo që ka ndodhur, ajo që i ka ndodhur atyre njerëzve, çka, ku, si. Pyetje pse është pyetje për shkaqet apo për përgjegjësinë. Konsideroj që ekziston mënyra për të përafuar këto dyja, sepse së paku përvoja tregon që nëse komisioni apo cilido organ tjetër shmanget shumë nga faktet e vërtetuara dhe ec drejt hulumtimit të shkaqeve që potencialisht mund të jenë të largëta – këtë nuk po e them unë, as ju nuk po e thoni, e di, e di – por ekziston rreziku që sa më shumë të largoheni, t’i quaj ashtu, përgjegjësive të afërta dhe arsyeve se pse ka ndodhur diçka në përgjithësi – këtë nuk e thoni ju, po e them unë – mendoj që ekziston një hapësirë e cila është kyçe për vërtetimin e shkaqeve, por shkaqeve në kuptimin e shkaqeve të afërta, përgjegjësive institucionale që mund t’iu përshkruajmë atyre pasojave, por mbi këtë do të bisedojmë nesër, sepse cilido komision që ka detyrë të hartojë raportin përfundimtar duhet të ecë përpara e prapa në lidhje me të. Historianët e komisionit gjithmonë thonë “gjithsesi duhet të ecim sa më shumë që mundemi për të kuptuar shkaqet historike, për të ardhur tek ai moment”, ndërsa juristët do të thonë “nuk duam të hyjmë në atë, sepse dëshirojmë të përqendrohemi vetëm në fakte, vetëm në fakte, vetëm në fakte, vetëm në atë që nuk mund t’i nënshtrohet interpretimeve të ndryshme”, pashmangshmërisht komisioni i së vërtetës do të gjendet në situatën që të vërtetojë faktet, por edhe përgjegjësitë institucionale dhe shkaqet të drejtpërdrejta. Nuk e di nëse kjo ndihmon në përafrimin e dyja këtyre gjërave, sepse mendoj që është me rëndësi të hetohen shkaqet duke marrë parasysh që ato janë në lidhje të afërt me faktet të cilat janë të hulumtuara dhe të vërtetuara. Më së paku kjo është përvoja e shumicës së komisioneve për të vërtetën.

*

vetëm edhe një gjë, fjala më e fundit. Nëse komisioni për të vërtetën e bën punën e vet mirë, shkaqet përfundimisht bëhen jomateriale. Dua të them që ajo që shpresoni të jetë rezultat i punës së komisionit për të vërtetën është që publiku të shohë çfarë ka ndodhur, përvojat që janë prekur dhe të thotë që për këtë nuk ekziston asnjë arsye, që nuk është me rëndësi cili ka qenë shkak; kjo do të ishte e pafalshme, kudo, dhe mendoj që është me rëndësi të kuptohen shkaqet dhe përgjegjësia, si dhe pajtohem me këtë, por shpresoj që në një moment shoqëria të shohë këto fakte dhe të dëgjojë tregimet dhe të thotë që kjo është e pafalshme dhe pikë, pa marrë parasysh shkaqet, pa marrë parasysh sa të arsyeshme apo të paarsyeshme kanë qenë, asgjë nuk mund të arsyetohet veprimet e tilla. Nesër takohemi prapë në ora 10:00. A po, Jelena?

III Dëgjimet publike të komisioneve të së vërtetës

Sot do të flasim për dy segmente të rëndësishme në punën e komisioneve të së vërtetës. Së pari do të merremi me dëgjimet publike, në mënyrë të veçantë me dëgjimet e viktimave, pastaj së bashku do t'a shikojmë një film. Për këtë mëngjes nuk kemi planifikuar pauzën për kafe. Do të fillojmë me punë në ora 10:00 dhe do të punojmë deri në 12:30. Gjatë prezantimit do të kemi diskutim, dhe pastaj do të shikoni filmin i cili do të zgjasë rreth një orë e 15 minuta. Fjala është për një film mjaft interesant, e kam fjalën për temën e tij, është mjaft i balancuar dhe mjaft i qartë. Pas kësaj do të kemi pak kohë që të bisedojmë rreth filmit, reagoimeve tuaja rreth filmit dhe këtë diskutim mund t'a vazhdojmë edhe gjatë kohës së rezervuar për drekë. Pastaj kur të kthehemi në ligjëratat e pasdites, do të kemi një sesion të shkurtë rreth një aktiviteti tjetër me rëndësi të komisionit të së vërtetës, dhe ajo është përgatitja dhe paraqitja e raportit përfundimtar rreth të cilit do të bisedojmë më detajisht. Fatkeqësisht, mua nuk më ka rënë në mend që t'u sjell shembuj të raporteve të komisioneve të së vërtetës. Në fakt, shumica e raporteve tashmë publikohet në formë të librit, zakonisht kanë nga katër ose pesë vëllime, shpesh përmbajnë edhe me mijëra faqe, duke përfshirë edhe anekset. Në ditët e sotme, poashtu i publikojnë edhe në CD-ROM, disa raporte publikohen edhe në faqet e internetit të komisioneve të mëhershme, e kështu me radhë. Do të merremi me raportet përfundimtare në mënyrë që të kuptojmë rëndësinë e tyre potenciale, mirëpo do të flasim poashtu për mënyrat se si mund të përmbliidhen raportet përfundimtare në mënyrë që të jenë më të lehtë për t'u përdorur, veçanërisht kur janë në pyetje rekomandimet dhe roli i shoqërisë civile në lidhje me ato raporte. Kjo do të zgjasë nga 15:00 deri 18:00, në kuadër të asaj ligjërate do të organizohet pauza për kafe. Poashtu në kohën prej 15:00 deri 18:00 do të flasim rreth idesë lidhur me komisionin regional dhe do të kemi sesionin në të cilin në parim secili do të mund të paraqesë pyetje, bëjnë komente dhe paraqesë brengat në lidhje me atë ide dhe shpresoj që në fund të ditës do të arrijmë një konsensus të caktuar rreth asaj se cilat mund të jenë problemet apo themelore, dhe hapat e ardhshëm vendimtarë. Kështu përafërsisht e kemi pararenduar rendin e ditës për sot. Para se të fillojmë me dëgjimet publike, dëshiroj t'u pyes a ka ndokush ndonjë pyetje në lidhje me ligjëratat e djeshme. Nëse keni, e keni rastin që të parashtroni pyetjet tani. Atëherë? Nuk ka? Në rregull. Atëherë vazhdojmë me dëgjimet publike. Ndoshta do të mund të përsërisë disa çështje nga dita e djeshme. E para, komisionet e të vërtetës, veçanërisht nga përvojat e Afrikës së Jugut, organizojnë dëgjime publike masive. Me fjalë të tjera shumica e komisioneve të së vërtetës nga komisionet jug-afrikane në vitin 1995 kanë organizuar dëgjime publ-

ike, veçanërisht dëgjime të viktimave. Kjo është bërë komponentë standarde e punës së komisioneve të së vërtetës. Poashtu është me rëndësi që të përsërisë që derisa të fokusohem në dëgjimin konkret të viktimave të përmendur më lartë, me fjalë të tjera dëgjimet e organizuara për viktimave individuale për të cilat ato dëshmojnë në mënyrë publike, në një lloj platforme publike me prezencën e mediave nacionale të cilat i përcjellin dëshmitë e paraqitura. Dëgjimet e viktimave janë vetëm një lloj i dëgjimeve publike të cilat komisionet e së vërtetës mund t'i organizojnë dhe shumë të tilla janë organizuar. Nga ana tjetër, kjo është një inovacion të cilin e ka menduar komisioni i të vërtetës në Afrikën e Jugut dhe e cila pastaj është marrë në vende të ndryshme. Mirëpo, prapëseprapë, vetëm ta përsëris që komisionet e të vërtetës në shumë raste kanë organizuar dëgjime institucionale, të cilat prapë janë dëgjime publike në të cilat institucionet ftohen që të takohen me komisionin në publik, të kenë debate të hapura dhe diskutime rreth problemeve me të cilat merret komisioni, dhe poashtu janë organizuar dëgjime tematike, për shembull dëgjime të organizuara rreth përkatësisë gjinore, dëgjime të kushtuara përvojave të fëmijëve. Këto shembuj i kam paraqitur dje. Përveç kësaj, janë organizuar dëgjime kushtuar ngjarjeve të caktuara, si dhe dëgjime kushtuar partive politike. Në njëfarë mënyre këto po i përsëris vetëm për të theksuar se sa janë komisionet kreative dhe më të mirat janë ato komisione të së vërtetës të cilat veten e shohin si akterë që mund të gjejnë qasje të reja për veprimet të cilat mund të ushtrorjnë ndikim të fuqishëm në vendosjen e të vërtetës dhe secili komision ka pasur pikat e veta të dobëta, mirëpo secili prej tyre ka bërë inovacionet/shpikjet e veta dhe në këtë kuptim nëse ju planifikoni të ecni më tutje me zhvillimin e idesë për komisionin regional këtu pandërprerë do të duhet të mendoni gjëra të reja të cilat këtu mund të kenë kuptim dhe të cilat në këtë kontekst do të mund të merren parasysh.

Atëherë, tash për dëgjimin e viktimave. Cilat janë përfitimet dhe përparësitë e dëgjimit të viktimave? Mendoj që ju tashmë e parandieni se cilat mund të jenë përfitimet potenciale nga dëgjimi i viktimave sepse mendoj që shumica nga ju, për shembull, keni prezantuar në forumet regionale dhe konsultimet të cilat janë organizuar viteve të fundit, në të cilat keni ndenjur dhe dëgjuar viktimat dhe anëtarët e familjeve të viktimave se si flasin për përvojat e tyre në mënyrë mjaft humane dhe të ndjeshme, po ashtu ndoshta keni pasur rastin që të shihni gjykimet e rasteve në shtetet tuaja, dhe sigurisht gjykimet pranë Tribunalit të Hagës. Ato sigurisht që janë lloje të tjera të dëgjimeve, mirëpo sigurisht e parandieni pse dëgjimet e viktimave në organizimin e komisioneve të së vërtetës kanë një ndikim të thellë, por unë dëshiroj që të shpjegojë se cilat janë disa nga përfitimet potenciale dhe arsyeve se pse duhet të organizohen dëgjimet e viktimave.

Mendoj se arsyeja më e rëndësishme, të paktën sipas mendimit tim, në atë se herë pas here organizohen ngjarje në të cilat vendin kryesor e marrin viktimat dhe anëtarët e familjeve të viktimave. Në gjuhën spanjolle ekziston një fjalë shumë e bukur, e cila nuk mund të përkthehet në anglishte siç duhet, dhe ajo është *dignificacion*, që do të thotë t'i kthehet dinjiteti viktimës apo anëtarëve të familjes së viktimës, dhe i vetmi veprim që mund të ndërmerret në atë drejtim është që t'u mundësohet që thjeshtë të paraqesin tregimet e tyre në një ambient zyrtar dhe para organeve zyrtare, para publikut/opinionit të vendit, dhe kështu me radhë. Kjo nuk është ndonjë gjë e madhe, por mund të jetë me rëndësi dhe të ketë efekt. Sigurisht arsyeja tjetër për organizimin e dëgjimeve të viktimave është potenciali i tyre për të pastruar debatin publik dhe diskutimin publik dhe me kalimin e kohës, gjatë javëve dhe muajve të dëgjimeve dhe ekspozimit para publikut në ato dëgjime shpresojmë që të ndryshohet natyra e atyre diskutimeve dhe që njerëzit do të kenë më tepër kujdes para se të thonë diçka lidhur me ndonjë krim të kryer në të kaluarën dhe që këto dëgjime do të ndikojnë në atë që çdonjëri të tregojë më tepër respekt. Disa njerëz do të vazhdojnë të tregojnë mosrespekt, mirëpo shpesh vërehet një ndryshim mjaft diskret që lind duke u falënderuar këtyre dëgjimeve dhe këtyre tregimeve.

Nga pikëpamja e drejtësisë në tranzicion është me shumë rëndësi që me ndihmën e dëgjimeve të viktimave mund të krijohet ndjeshmëria të publiku dhe solidariteti jo vetëm me viktimat me të cilat ndjejnë solidaritet tashmë por edhe për viktimat për të cilat në të kaluarën kanë refuzuar t'i shohin si viktimë apo të cilat kurrë nuk kanë mundur as t'i shohin si viktimë.

Dhe arsyeja pse është me rëndësi, mendoj, ka më shumë arsye pse është me rëndësi që të krijohet solidariteti i publikut me viktimat është në atë që komisioni i të vërtetës apo cilido organ tjetër i ngjashëm do të propozojë reparacionin e viktimave, do të bëjë propozime për reforma institucionale, ndjekje penale, dhe në këtë kuptim rritja e keqardhjes për viktimat do të siguronte duhej të siguronte mbështetjen e publikut/opinionit për realizimin e rekomandimeve. Në rast se nuk ekziston mbështetja e publikut në përfundim të punës së komisionit të së vërtetës, tatimpaguesve në atë shtet do t'u vijë vështirë që të pajtohen me faktin për të ndarë dhjetëra apo qindra miliona euro për programe të reparacionit për një grup relativisht të vogël njerëzish. Për këtë përfitimi praktik potencial nga dëgjimet është i madh. Edhe një arsye pse dëgjimet e viktimave mund të jenë shumë të rëndësishme bie në atë se për dallim nga aktivitetet tjera të komisioneve të së vërtetës, këto aktivite me të vërtetë arrijnë deri tek njeriu i thjeshtë. Debatet e sofistikuar politike, përfundimet e komplikuar juridike në

raportin përfundimtar nuk kanë për qëllim të arrijnë deri te shumica e njerëzve të thjeshtë, të paktën nuk i prekin në mënyrë të thellë, emotive dhe psikologjike. Dëgjimet e viktimave kanë fuqinë që të sjellin çështjet juridike dhe politike dhe që të prekin njerëzit e thjeshtë, dhe prapë ndoshta këtu nuk është e ndonjë rëndësie të veçantë, por veçanërisht në kontekst të një analfabetizmit të gjerë kjo paraqet të vetmen mënyrë reale që të arrihet te këta njerëz dhe kjo paraqet edhe një përfitim potencial të dëgjimit të viktimave.

Po ashtu të përkujtoj që dje kemi folur për dallimet në mes të fakteve dhe tregimeve, dhe për rëndësinë e tregimeve dhe është vështirë që të mohohet, që pas dëgjimit dhe shikimit të atyre tregimeve, krime të caktuara që janë shkaktuar, pasi që ekziston gati një vërtetësi dhe një pranim i lindur nga këto dëgjime të cilat nuk mund të mohohen. Njerëzit mund të kundërshtojnë statistikën, por është shumë vështirë që të mohohet fuqia e të drejtave të njeriut dhe trauma që mund të shihet gjersa këta njerëz tregojnë tregimet e tyre.

Dhe përfitimi i fundit për të cilin mendoj që është me rëndësi që t'a përmend dhe e cila prek temën për të cilën kemi folur dje ka lidhje me të mësuarit e historisë për periudhë të gjatë. Këto dëgjime, kryesisht në çdo rast, incizohen dhe në disa raste shndërrohen në mjete për të mësuar gjeneratat e reja, ashtu sikur që sot fëmijët në Gjermani shikojnë gjykimet e Njrenbergut, ata në fakt kanë rastin të shohin pjesë nga ato gjykime dhe këtë edhe e bëjnë. Këto dëgjime shumë lehtë mund të shndërrohen në instrumente mësimi dhe ekzistojnë disa shembuj. Të gjitha këto i përsërita për të arritur një pikëpamje më të detajuar të paktën në arsyet e mësuar nga përvojat e të tjerëve se pse dëgjimet e viktimave mund të jenë aq të fuqishme.

Në disa rast nuk mund të organizohen dëgjimet e viktimave, dëgjimet publike të viktimave, nganjëherë mund të ekzistojnë edhe arsye kulturore, për shembull në disa vende nuk është mirë që dhimbja të ekspozohet. Pra, ekzistojnë kultura të cilat, themi, nuk e mbështesin idenë që të tregohet dhimbja publikisht dhe që ka vende në të cilat dëgjimi i viktimave do të konsiderohej e çuditshme dhe skajshmërisht jo kulturore ne parim dhe ne ambiente të tilla nuk do të mund të kishin asnjë kuptim. Nuk e di se cili është mendimi juaj lidhur me këtë çështje, mirëpo mua më kujtohet që në kohën kur ka filluar themelimi i komisionit të së vërtetës dhe pajtimit në ish RFJ dikush në një intervistë i bëri pyetjen kryetarit të atëherëshëm Koshtunica në lidhje me dëgjimet publike dhe se a do t'i organizojë ato komisioni i së vërtetës, dhe ai u përgjigj, „Ne në këtë vend nuk i pëlqejmë shkumëzat.“ Tash ju mund të mendoni çfarë të doni, por nëse une kam marrë pjesë personalisht në konsultime dhe

forume këtu, atëherë ky pohim nuk duket aspak si mënyrë në të cilën dëgjimet publike do të duhej të vështrohen këtu. Sidoqoftë poenta e asaj që dua të them është që dëgjimet publike nuk do të pranohen mirë dhe njësoj gjithandej, në mënyrë të veçantë aty ku ekziston tendenca kundër paraqitjes së dhembjes në publik.

Natyrisht që mund të ketë edhe arsye të tjera të cilët flasin në favor të asaj që dëgjimet publike nuk do të jenë të mundshme dhe arsyeja kryesore të cilën ua thashë dje është e lidhur me çështjen e sigurisë dhe problemet rreth sigurisë. Ndonjëherë nuk mund të organizohen dëgjimet publike për shkak të problemeve me sigurinë.

Shumë komisione të së vërtetës duhet të ndërrojnë datën dhe vendin e mbajtjes së dëgjimit të viktimave, dëgjimeve publike vetëm për shkak kërcënimeve të sigurisë apo në disa raste duket t'i anulojnë fare dhe do të ishte naive të mendohet që të mos ekzistojnë rreziqe apo kërcënime rreth sigurisë edhe këtu nëse do të themelohej komisioni regional dhe të mos drejtohen kërcënime direkte këtyre dëgjimeve publike, mirëpo do të mund të mësonim nga përvojat e deritanishme, veçanërisht nga gjykimet, që ekzistojnë mënyra të organizimit të dëgjimeve, që edhe më tutje të jenë publike, dhe le të themi që do të mund të mbaheshin në vende të fshehta.

Dëgjime të tilla do të incizoheshin dhe do të emitoheheshin në televizion, dhe në fakt do të mbaheshin në vende të fshehta. Po ashtu ekziston mundësia që të fshihen fytyra dhe zëri i personit e cila dëshmon. Kjo nuk është ideale, mirëpo në rast nevojë që të balancohen rreziqe të caktuara, ndoshta është më mirë se sa dëgjimet të mos mbahen fare. Gjithashtu, kufizimi i njerëzve që do të marrin pjesë në dëgjim poashtu paraqet një mënyrë që të ruhet publikimi i dëgjimit. Mirëpo që të balancohen nevojat dhe interesi duhet të tregohet kujdes që të mundësohet siguria, para se gjithash të atyre që dëshmojnë, atyre që marrin pjesë në dëgjim, anëtarëve të komisionit dhe stafit. Nganjëherë për kategori të caktuara të njerëzve ekzistojnë arsye të mira që dëgjimet të mbahen të mbyllura. Shumica e komisioneve nuk mban sesione të mbyllura, me fjalë të tjera dëgjime prapa dyerve të mbyllura për të cilat publiku nuk duhet kurrë të dijë, t'i shikojë apo dëgjojë. Natyrisht që të gjitha përparësitë e përmendura do të mund të zhduken në rast të mbajtjes së dëgjimit publik. Mund të përmend disa raste në të cilat komisionet kanë marrë vendim që fëmijët në asnjë mënyrë të mos dëshmojnë publikisht, veçanërisht në rastet kur duhet dëshmuar për krimet që janë bërë ndaj tyre. Arsyeja pse po them që komisioni nuk organizon sesione të mbyllura apo sekrete është në atë se është vështirë që të gjendet arsye që do të arsyetonte mbajtjen e mbledhjeve të mbyllura ose sekrete apo me fjalë të tjera biseda me një person prapa dyerve të mbyllura nuk do të ishte e mjaftueshme, pse do të duhet të kishte takim zyrtar

të komisionit dhe dëgjim formal në rast se kjo nuk do t'i përcillet publikut. Shumica e komisioneve thjeshtë thotë „Hajde të intervistojmë këtë person dhe ta bëjmë këtë në privaci (pa publik)“, mirëpo ndonjëherë, dhe këtu do të doja të theksoja në veçanti rastet në të cilat kryesit e veprave dëshirojnë të nxjerrin dhe tregojnë të vërtetën, ata në disa rast jo vetëm që insistojnë që të japin deklaratat në fshehtësi të plotë, por që edhe biseda të organizohet sikur intervistë e thjeshtë, por që edhe sesioni të jetë zyrtar, kështu që duhet ta përmend edhe këtë mundësi. Të paramendojmë tash që, të kthehemi të dëgjimi i viktimave me paramendimin që dëgjimin i viktimave të veçanta do të mbahet publikisht, cilat do të ishin çështjet praktike të cilat cilido komision i së vërtetës do të duhej t'i kishte parasysh me rastin e organizimit të këtyre dëgjimeve? E para përkundër pritjeve të shumicës, mundësia që të dëgjohet publikisht mund të ndihmojë, në të njëjtën kohë mund të shkaktojë përsëritjen e traumatizimit dhe thjeshtë është e pamundur që të garantohet se çfarë mund të ndodhë në momentin kur viktimat apo anëtarët e familjes së viktimës vendosin të dalin para publikut, veçanërisht duke pasur parasysh jo vetëm traumat nga ngjarjet të cilat u kanë ndodhur këtyre personave por edhe faktin që këta njerëz, që dëshmojnë, janë vetëm njerëz të thjeshtë, dhe që kurrë me parë nuk janë paraqitur në televizion, kurrë nuk kanë dalë në skenë, duhet të tregojnë tregimet e tyre për gjërat më të shëmtuara të cilat u kanë ndodhur në jetë.

Kjo është një e vërtetë me rëndësi për të cilën duhet të jemi të vetëdijshëm gjatë organizimit të këtyre proceseve. Gjëja e dytë, për të cilën duhet të jemi të vetëdijshëm gjatë organizimit të dëgjimeve të viktimave është që dëgjimet publike dhe dëgjimet e viktimave janë aktivitetet larg më kërkuese, të cilat i organizojnë komisionet e të vërtetës – në kuptim financiar, logjistik, në fakt në çdo kuptim të mundshëm. Dëgjimet publike, të cilat i organizon komisioni i të vërtetës në të vërtetë janë aktivitetet më kërkues dhe kjo është arsyeja që kryesore që edhe komisionet që kanë punuar edhe me nga tri vite nuk kanë arritur të organizojnë dëgjime në të cilat do të mund të kishin rastin të dëshmojnë më shumë se disa qindra njerëz, viktimat të familjeve të tyre. Dhe shumica e komisioneve do të thoshin që organizimi i dëgjimeve të tilla do të zgjasë edhe me muaj të tërë dhe kjo kohë merr edhe nga aktivitetet hetimore të komisionit, mirëpo meqenëse këto kanë ndikim kaq të fuqishëm komisionet i organizojnë ato gjithmonë, veçanërisht nga përvojat e komisioneve të Afrikës së Jugut. Megjithatë ato kanë problem sepse atyre u duhet më shumë kohë, energji dhe resurse se sa në çfarëdo aktiviteti tjetër të komisionit të së vërtetës. Dhe shkurt do të shpjegojë pse është kështu menjëherë pas filmit. Poashtu është me rëndësi të thuhet që dëgjimi i viktimave nuk janë momentet e vërtetimit të

së vërtetës. Çfare mendoj me këtë? Në zgjedhjen e individëve të cilëve do tu mundësohet të dëshmojnë, komisioni nuk vendos 'hajde t'i marrim këta apo ata persona'. Kur përzgjidhen njerëzit, komisionet paraprakisht bëjnë biseda në privatësi (të besueshme), apo siç thuhet marrin deklaratat nga ata njerëz. Pastaj, pasi që bëjnë bisedat me një numër të madh njerëzish, vendosin se kujt ti japin rastin që të flas në dëgjimin publik. Në këtë kuptim, kur personi del të dëshmojë në dëgjimin publik, komisioni tashmë e din tregimin e personit, kjo për komisionin nuk paraqet momentin e të vërtetës, por siç e thash ky është momenti i tregimit të së vërtetës. Natyrisht, mund të ndodh që disa të dhëna mund të dëgjohej për herë të parë gjatë dëshmimit publik, por ato janë të dhëna të paketa dhe që do të mund të jenë të dobishëm për hetimit të cilin e kryen komisioni. Të them përsëri, fuqia e dëgjimit është në të folur/treguar dhe jo në atë se çfare arrin të kuptojë komisioni në kuptim të hetimit.

Gjithashtu, kjo tani i përket komentit të kryetarit Koshtunica, por poashtu ndonjëherë ndodh që të ekzistoj rezistencë e fortë çfarëdo lloji të dëgjimeve publike, apo që ata që mbështesin apo që ata që janë kundërshtar të komisionit do të thonë –nuk do të ishte mirë që të organizoni dëgjime publike sepse ato do të shndërrohen në cirkus, apo njerëzit do të flasin gjithçka dhe do të gënjejnë, si do të kontrolloni gënjeshtat kjo do ti përngaj në një gjykim të rrejshëm pa garanci të siguruara dhe ju këtë nuk do të duhej që ta bëni. Në realitet dëgjimet e viktimave janë ngjarje solemne dhe në këtë moment unë nuk dëshiroj të them asgjë më shumë sepse dëshiroj që ju vet të shikoni disa fotografi nga këto katër komisione për të vërtetën, mirëpo vetëm dëshiroj që të dini që gjithmonë do të ketë mjaft njerëz që do të thonë se kjo është shndërruar në cirkus dhe që është më mirë që të mos bëhet spektakël publik nga këto gjëra. Në realitet ju do të shihni se ky është një akt solemn, serioz dhe i çmuar. Gjeja e fundit që njerëzit duhet të kanë parasysh ndërlihet me vendimin e dhimbshëm se kush do të paraqitet në dëgjim. Tanimë e përmenda që kjo do të jetë një përqindje e vogël nga nr. i përgjithshëm i viktimave i cili do të ketë rast që të dëshmojnë në publik. Gjithmonë një numër shumë më të madh të viktimave dhe familjarëve të tyre do të dëshironin të japin dëshmi sesa që do të kenë rastin. Për të kuptuar këtë do të jap disa statistika. Psh. në Afrikën e Jugut më pak se 10 % të viktimave kanë dëshmuar, në Marok një përqindje nga numri i përgjithshëm i viktimave ka pas rastin të dëshmoj por kjo nuk e zvogëlon fuqinë e dëgjimeve publike. Me keqardhje, ekziston problemi që komisionin në një periudhë të caktuar kohore duhet të punon me resurse të limituara dhe buxhet të limituar, duke ndërmarrë edhe aktivitete të tjera, dhe një numër shumë i vogël i njerëzve ka rastin për të treguar, për këtë është

shumë me rëndësi që të krijohen kritere të qarta të drejta dhe transparente për të zgjedhur njerëz të cilëve do të iu jepet ky rast, dhe kjo nuk e lehtëson zgjedhjen, por së paku kriteret e qarta përdoren. Do të ju ceki disa shembuj të këtyre kritereve të qarta që janë përdorur nga komisionet e së vërtetës deri tani në marrjen e këtyre vendime se kujt ti ipet rasti që të fletë në një dëgjim publik.

Një nga kriteret bazë është stabiliteti emocional in një individ. Nuk është në asnjë interes të Komisionit që të bie në pozitë të tillë një person për të cilin ekziston mundësia e madhe të kaloj edhe një herë nëpër një traumë dhe nëse ai person nuk është në gjendje të flet në mënyrë të qetë. Pra ky është një kriter ndërsa kriteri tjetër mund të jetë fuqia e tregimit individual. Disa njerëz thjesht i tregojnë tregimet e tyre, në mënyrën e cila është më e fuqishme se të tjerat. Natyrisht disa njerëz nuk mundin të thënë asnjë fjalë ndërsa të tjerët mund të flasim për çdo gjë tjetër përpos gjërave që ju kanë ndodhë tyre dhe ju duhet në mënyrë indirekte të zbuloni se çfarë ju ka ndodh atyre. Gjërat janë kështu, fuqia e një tregimi paraqet një faktor të zakonshëm por ekzistojnë edhe kritere tjera për të cilat Komisioni do të përkuqdeset duke marrë parasysh se mund të organizohet numri i kufizuar i dëgjimeve në të cilat mund të dëgjohej tregimet e më tepër se qindra njerëzve brenda disa javëve, zakonisht Komisioni do të mundohet të siguroj laramanin e tregimeve, te moshës, gjinisë, fesë, racës por edhe të periudhës kohore në të cilën është kryer krimi. Për shembull, Komisioni shumë shpesh vendos që përveç dëgjimit të tregimeve të njerëzve, të cilat kanë vuajtur në rrethana të ditura, që në dëgjim të fus edhe disa ngjarje tjera për të cilat publiku nuk di gjë në mënyrë që të krijohet një lloj balancë. Këto janë disa nga kriteret e përbashkëta, por po ashtu kisha pas dëshire të qartësoj një gjë. Marrja në pyetje e viktimave, të peronave të cilët do të vinë të dëshmojnë në rolin e viktimës apo të anëtarëve të familjes, do ta bëjnë këtë vetëm në baza vullnetare. Asnjë Komision asnjëherë nuk do ta shtyj me forcë as viktimën e as anëtarët e familjes që të japin dëshmi. Është një gjë tjetër nëse Komisioni ka autorizim të ftoj personat për dëshmi dhe kur insiston që personi i akuzuara apo personi i cili është emëruar si kryes i krimin paraqitet para Komisionit. Marrja në pyetje e viktimës është thjesht një proces vullnetar. Megjithatë kisha dashtë të cek edhe disa gjëra, mbas së cilës mund të kalojmë në rrethin e pyetjeve dhe komenteve tuaja, dhe pastaj mund ta shikojmë filmin. Gjëja e fundit për të cilën desha të flas është e dini... Thash që organizimi i marrjes në pyetje është një aktivitet shumë i madh të cilin e ndërmerr Komisioni. Këtë do tua shpjegoj në atë mënyrë që do të ju tregoj për të gjitha aktivitetet të cilat i ndërmerr për tu organizuar dëgjimi i viktimave, natyrisht nëse doni ta bëni këtë gjë në mënyrë të duhur. Gjëja e parë për të cilën Komisioni duhet të marrë vendim në mënyrë

shumë specifike është sa marrje në pyetje do ti organizoj sepse duhet të keni parasysh gjë që e kam cekur edhe më herët se Komisioni ka kapacitet njerëzor të kufizuar të cilët në të njëjtën kohë merren me punë mediave, me hulumtime me polic, hulumtime forenzike, bisedojnë me mijëra viktime, vizitojnë varrezat, vizitojnë gjykatat, organizojnë debate publik, ndoshta fillojnë të përgatisin raportin final, mbledhin të holla, d.m.th. Komisionet kryejnë aq shumë gjëra në të njëjtën kohë dhe për këtë nuk është e mundur të vendosin edhe për numrin e dëgjimeve që duhet organizuar. Të gjitha aktivitetet tjera të cilat i ndërmarim e dini kanë për qëllim përfundimin e hulumtimeve, nuk mund të marrin më tepër se një vjet të mandatit tanimë të kufizuar. Parashtrahet pyetja si të balancohen këto gjëra. Pra, pyetja është si të përcaktohet numri i dëgjimeve publike që është një pyetje shumë praktike, por një vendim të tillë mund ta merrni gjatë fazave të ndryshme të punës.

Ku duhet organizuar dëgjimet publike. Këto gjëra marrin kohë. Nëse doni të organizoni dëgjime në pjesë të ndryshme të vendit, në pjesët urbane dhe rurale apo në shtete të ndryshme. Në fakt, më duhet të ju përmend një shembull interesant të Komisioni të së vërtetës në Liberi e cila mu tani është duke i organizuar dëgjimet jo vetëm në Liberi por edhe në SHBA në disa qytetet ku jetojnë komunitete Liberiane të cilëve ju është dhënë mundësia që të flasni. Në çdo rast, është shumë me rëndësi çështja se ku do të organizohen dëgjimet, por kjo pyetje nuk parashtrahet vetëm në kuptim të vendit ku do të organizohet por edhe në pikëpamje të zgjedhjes së ndërtesës së përshtatshme. Edhe pse kjo mund të tingëllojë prozaikë, megjithatë zgjedhja e ndërtesës është me shumë rëndësi dhe për këtë duhet të vendoset. Në disa raste dëgjimet janë organizuar... Do të shihni në Afrikën Jugore disa dëgjime janë mbajtur në kisha. Kjo ka qenë një zgjedhje shumë e vetëdijshme. Në rastet tjera janë mbajtur në lokale e bashkësi lokale apo në disa ndërtesa të cilat janë banka. Tash, nëse Komisioni dëshiron që lokacioni të ketë ndonjë vlerë simbolike me dëgjimet, zgjedhja e lokacionit ka rëndësi. Në çdo rast, nëse keni dëshirë që me qindra njerëz fizikisht të jenë prezent në dëgjimet publike atëherë ju duhet pajisje teknike e konsiderueshme, e cila në shumicën e rasteve mungon, e ndërlikohet edhe operacione të mëdha logjistike dhe financiare kështu që është shumë me rëndësi mënyra se si bëhet e tërë kjo dhe mënyra e zgjedhjes së ndërtesës është shumë me rëndësi. Nëse thoni do ti organizoni tetë dëgjime në tetë vende të ndryshme atëherë do të keni tetë herë më shumë punë në fakt 70 herë më shumë punë në praktikë.

Po ashtu, është me rëndësi të dini si do ta rregulloni lokalitë në të cilin do të mbahet dëgjimi. Është e pamundur se bëhet fjalë për këtë punë. Do të shihni disa fotografi që të keni pasqyrën e zgjedhjes së lokaleve të ndryshme

në vende të ndryshme. Është shumë me rëndësi si duket dhoma. Dëgjimi nuk do të jetë i suksesshëm nëse lokali i ngjason shumë gjykatës kështu që është shumë me rëndësi si i poston personat në dhomë. Do të shihni përgatitjet të ndryshme. Edhe pse do të flasim më vonë për këtë do të cek disa shembuj Afrika Jugore.... Mund ta vizitoni. Në Afrikën Jugore ka qenë një dhomë e dëgjimeve dhe këtu në bazë keni një lokal ku janë të gjithë dhe viktimat shikojnë nga kjo anë kurse anëtarët e komisionit qëndrojnë pak më lartë. Pra, keni pas njerëz. A shihni? Këtu kanë qenë njerëzit, viktimat kanë shikuar kah komisioni, anëtarët e komisionit janë në një nivel më lartë të ngjajnë pak në gjykatës. Ky është një model që është adoptuar në Peru siç do të shihni më vonë. Kjo ishte ndërtesa. Njerëzit edhe më tej qëndronin aty, vetëm se anëtarët e komisionit dhe njerëzit të cilët kanë dëshmuar të gjithë kanë qenë në një tavolinë në nivel të njëjtë, viktimat dhe anëtarët e familjes ishin në fakt të kthyer kah komisioni. Në Marok publiku ka qenë simbolikisht e kthyer kah kombi duke shikuar në kamera, ndërsa komisioni rrinte anash sepse poenta ishte që viktime të jetë në planë të parë e jo komisioni. Përveç kësaj, kjo ishte shumë interesante meqë komisioni maroken nuk ka pas mundësi të ju ofroj të gjithëve mundësi të dëshmojnë atëherë ajo i ka ftuar disa prej tyre që të dëgjojnë dëshminë e tjerëve por që vuajtjet e tyre të njihen pa marr parasysh që ata nuk kishin mundësi të flasni. Në cilin do rast, vetëm desha të cek se këtu ka shume gjëra për të cilat duhet menduar. Duhet përmendur edhe një gjë është shumë me rëndësi të dihet dallimi në mes dëgjimit të viktimës dhe rolit të cilin e ka në gjykim, këtu thjeshti i lejohet familjes të jetë prezent gjatë gjithë kohës.

Po ashtu në Marok, është dashur ta përmend edhe këtë, se të gjitha komisione tjera kanë pas vetëm nga një person që do të dëshmojë në skenë derisa të tjerët kanë prit mbirap të cilët një nga një do të vinin në skenë. Në Marok të gjithë shtatë apo më tepër persona që do të dëshmoni vendoseshin në një vend që të dëgjonin edhe dëshmi tjera. Po e përsëris, desha tua prezantoni këtë pasqyrim sepse ekziston një lloj i ndërlikueshmërisë së organizimit të dëgjimeve të viktimave sa që prej tyre mund të bëhet një shkencë. Por e gjithë kjo ndërron dhe çdo komisioni i rri hulumton komisionet të mëparshme dhe gjen zgjedhje të ndryshme në situata konkrete në të cilat gjendet.

Sa i përket traumës, e cila mund të parashihet kur ti ftoni njerëzit të cilët kanë kaluar nëpër vuajtje të dëshmojë në dëgjime publike, komisioni patjetër ka për obligim që këta njerëz të përgatis për dëshmi, tu tregoj se çka do të ndodhë aty e çka jo, çka të presin por ti përgatis edhe nga aspekti psikologjik. Në momentin e mbajtjes së dëgjimit, komisioni po ashtu duhet të jetë prezent që eventualisht të ofroj përkrahje morale që personi mos të kalojë nëpër

traumë edhe një herë. Edhe nëse ndodh që personi të traumatizohet, komisioni është i obliguar të siguroj shërbim mjekësor. Do ta cek një rast. Në Gana njeriu që ka dalë në skenë ka pas sulm në zemër dhe ka vdekur. Në çdo dëgjim pas kësaj është siguruar mjetei i ndihmës së shpejt. Do të shihni se në Marok kanë bërë kontrollin mjekësor të gjithë atyre që kanë dëshmuar para se të dalin në skenë. Dhe sinqerisht kjo është më së paku që komisioni mund të bëjë për viktimën. Pastaj, çka me vetë dëgjimin? Sa gjatë do të ketë drejtë të flas viktimën apo anëtarin e familjes? Jam i sigurt se disa njerëz do të flasin me orë të tëra. Si të përmblihdni 20 vjet burg në më pakë se katër orë? Nga ana tjetër çdo herë duhet pas parasysh që duhet të mbahet vëmendja e publikut dhe mundësia e dhënies së fjalës të gjithë atyre që do të dëshmojnë. A duhet të ekzistojë një mënyrë e ndërprerjes? Ky është një problem shumë i madh por komisioni me siguri do të gjendet në një situatë ku duhet ta ndërpret dëshmitarin. Jo gjithnjë. Disa njerëz flasin shumë shpejt disa jo. Disa komisione e caktojnë kohën por në çdo rast komisioni do të provoj të bëjë me dije dëshmitarin për kohe të limituar. Por, në momentin kur ata janë në skenë çdo gjë mund të ndryshoj. Kështu që edhe kjo është një çështje e komplikuar. Çka ndodh nëse personi del në skenë dhe fillon të flas për gjëra të cilat nuk kanë të bëjnë me rastin por fillon të drejton gishtin duke thënë Personi X ma ka bërë këtë? Çfarë do të duhej të bëhej këtu në aspektin procedural në rast të një akuze të tillë? Në disa raste komisioni do të tërheq vëmendjen dëshmitarit dhe do ta pyes se çfarë e ka në plan të flas para komisionit, dhe nëse dihet paraprakisht që disa individ do të jenë të emëruar atëherë më së paku edhe ai person duhet të ftohet të jetë prezent. Disa komisione kanë provuar të bindin disa dëshmitarë të heqin dorë nga një gjë e tillë. Ta lusin viktimën që të fokusohet në atë që i ka ndodh atyre sepse nëse një individ do të ishte i akuzuar në rrethana të tilla, atëherë këtij personi duhet ti njihet e drejta të përgjigjet. Kjo nuk do të thotë se ai individ duhet të ketë dëgjim të ndarë, por pasojat që akuzat mund të ketë në personalitetin e tij mund të jenë serioze. Nëse nuk iu jepet rasti që të japin përgjigje kjo mund të paraqes shkelje të të drejtave procedurale të këtij personi. Në të vërtetë, kjo paraqet shkelje të të drejtave të njeriut. Në të gjithë kemi të drejta të njeriut në bazë të marrëveshjeve më të rëndësishme politike dhe civile të cilat na mbrojnë nga sulmet arbitrare në dinjitetin tonë. Kjo është një prej të drejtave themelore të njeriut. Edhe pse viktimën mund të emëron personin e duhur, ne nuk guxojmë që këtë ta pranojmë paraprakisht si të vërtetë, thjesht nuk guxojmë as të supozojmë. Kjo është edhe një çështje tjetër themelore për të cilën duhet menduar. Maroku ka qenë veçanërisht kontraverz, ata në parim kanë arritur një marrëveshje morale themelore e cila nuk ka qenë marrëveshje me shkrim, por vetëm morale, me njerëz që do të paraqiten për të dëshmuar me të cilën

marrëveshje personat janë detyruar që të mos përmendin individ të caktuar sepse komisioni ka deklaruar se nëse kjo do të ndodhte, dëgjimi do të merrte pamjen e një gjykimi dhe do të shndërronte në një lloj të mini-gjykimi, gjë që do të merrte kohë dhe resurse dhe do të tërheq vëmendjen nga viktimën gjë që ne nuk e dëshirojmë. Ky vendim i komisionit ka qenë shumë i kritikuar dhe kontraverz por poashtu ka patur shumë ithtarë.

Këto janë problemet të cilat duhet të i luftojmë. Kjo nuk është mënyra për ti shmangur ato. Ju duhet që të uleni dhe të mendoni dhe të vendosni se çfarë zgjidhje të bëhet në këtë rrethanë. Ka edhe shumë çështje mbi të cilat mund të diskutohet, por me lejoni që vetëm të përfundoj, dhe pastaj mund të më bëni disa pyetje ose mund drejtpërdrejtë të kalojmë në film.

Edhe një rol i cili është shumë i rëndësishëm janë natyrisht mediat, posaçërisht roli i mediave në këto dëgjime publike. Shkurtimisht thënë, nëse mediat nuk janë prezentë atëherë vetëm ata njerëz që janë në sallë do të kenë mundësinë për të dëgjuar ose përjetuar këto tregime, më së shumti disa qindra njerëz. Këto tregime dhe fuqia e tyre mund ta mbërrijë te publiku i gjerë vetëm përmes mediave, së pari përmes televizionit. Kështu që angazhimi i mediave në fazën e hershme të këtij procesi dhe roli i tyre në momentin e dëgjimit është e rëndësishme së posaçme. Edhe këtu duhet të merren disa vendime themelore dhe të bëhen disa aranzhime. Ju si komision nuk mund të detyroni mediat që të interesohen ose të jenë prezent në takimet tuaja. Si mund të binden ata? Me ata së pari fillohen bisedimet, ju dërgohen ftesat, ju i intrigoni ata në mënyrë që të mendojnë se kjo është një çështje e rëndësishme dhe të caktojnë gazetarë dhe reporter me detyrë që të përcjellin këto tregime. Duhet të i bindni dhe në disa raste kjo është arritur me sukses.

Në çdo rast, këto dëgjime të viktimave kanë ndikim të fuqishëm mbi të gjitha për shkak të fuqisë së tregimit, që mund të arrihet vetëm përmes mediave, dhe sinqerisht funksionon vetëm nëse komisioni investon mendim të mjaftueshëm dhe resurse në organizimin e tyre. Nëse kjo nuk bëhet ashtu si duhet, dëgjimet mund të dështojnë, dhe jo vetëm dështim në kuptimin në raport me publikun, legjitimitetin, por edhe dështim njerëzor për ata persona që do të dëshmojnë. Pra është me rëndësi të posaçme të ketë sens në këtë proces.

Më lejoni që këtu të përfundoj komentet e mia. Mendoj që këto çështje do të ju jenë edhe më të qarta pas shikimit të filmit. Ky film nuk është dedikuar vetëm dëgjimeve publike por edhe për aktivitete të tjera të komisioneve për të vërtetën dhe mendoj që do të ju jep një ide të mirë për përparësitë dhe mangësitë e tyre të mundshme. Por para se të lëshojmë filmin, të shikoj nëse ka ndonjë koment, pyetje apo replikë eventuale?

Tentimet e organizatave joqeveritare apo jo zyrtare për të organizuar dëgjime të këtij lloji janë gjithmonë të mundshme dhe në shumicën e këtyre vendeve janë organizuar edhe dëgjimet jozyrtare, por mendoj që dallimi themelor – duke mos marrë parasysh burimet shtesë, resurse financiare dhe njerëzore të duhur për të organizuar këto spektakle publike. Nuk e di nëse përkthyesit e zotërojnë frëngjishten por fjala e duhur është *misonse*, e unë nuk e di se si ta përkthej atë. Në çdo rast, dhe në ashtu përngjan, përafërsisht sikur ndonjë teatër publik por me tregime të vërteta dhe normalisht me njerëz të vërtetë. Dhe kjo në të vërtetë nuk është teatër, por gjëra të vërteta. Mund të thuhet se se kjo është lloji më i vrazhdë i realitet programeve (reality programme). Mirëpo, në esencën e iniciativës jo-formale, mendoj çka është dallimi mes këtyre komisioneve, përveç resurseve, resurseve shtesë, është gjithashtu edhe ato që iniciativa joformale dhe natyrisht për shumicën e atyre që do të dëshmojnë fakti që ata që e bëjnë në kontekstin e iniciativës zyrtare e cila nënkupton pranim dhe vërtetim nga ana e shtetit e asaj që iu ka ndodhur dhe fakti i thjeshtë që ata dëshmojnë jep një dimension shtesë i cili sipas meje shkon më larg se që mund të shkojë iniciativa jo-formale. Në rregull, hajde pra të shohim filmin. Para kësaj më lejoni që vetëm të tërheq perdet. Tani po e lëshojmë filmin.

IV Xhirimi filmik mbi komisionet për të vërtetën

Vetëm do të mund të shtoja që prej asaj liste do të mund të hiqim edhe disa komisione, por jam i lumtur që të heq Jugosllavinë me qëllim të pajtimit. A ka ndonjë koment apo pyetje që do ta ndanit me ne mbi atë që pamë? Vetëm do të kthehem pak në disa gjëra. Kemi parë këtë film: ai mbulon shumë aspekte të ndryshme të komisionit për të vërtetën, por para filmit është mbajtur prezantimi mbi dëgjimet publike, dëgjimit të viktimave, dhe mendova vetëm ta cek... Sigurisht që mund të vëreni disa aspekte të ndryshme të dëgjimeve dhe ta shihni që disa prej tyre duken më tepër si gjykime, disa më pak, por më lejoni t'ju tërheq vëmendjen tek disa mënyra me të cilat komisioni është mundur të krijojë një atmosferë ndryshe për këto tregime. Ndoshta keni vërejtur, për shembull, që lulet qëndrojnë në tavolinë kur dikush dëshmon. Nuk keni pasur rastin ta shihni sepse në film nuk është paraqitur, por përgjithësisht para dëshmimeve zakonisht, varësisht nga shteti apo zgjedhja, më së pari thuhet një lutje, në rastin e Afrikës së Jugut para dëgjimit është kënduar himni shtetëror, që ka qenë shumë interesante sepse himni shtetëror është ndërruar pas tranzicionit dhe me ardhjen e Mandelës në pushtet. Në shumicën e dëgjimeve që keni parë, pra më përjashtim të Afrikës së Jugut, nuk ka pasur avokatë, nuk ka pasur pyetje. Në të vërtetë, rasti më ekstrem ka qenë në Marok, ku anëtarët

e komisionit nuk bënin pyetje, as komente, thjeshtë ftonin njerëzit, në frëngjisht ata quheshin *les eccute*, dëgjues, dhe një prej anëtarëve të komisionit thoshte që “puna jonë është të dëgjojmë, dhe të dëgjojmë mirë e mirë”, dhe në fakt kjo ishte e vetmja punë që ata kishin marrë, duke u mundur që të bëheshin vesh i gjithë shoqërisë. Gjithashtu, keni mundur të shihni që komisionet kanë krijuar logot e veta, duke krijuar një emër që përfaqëson misionin që ata mundohen të arrijnë, dhe ajo logo, që është tjetër në secilin rast, është paraqitur edhe në dëgjimet publike. Nganjëherë janë ngritur edhe flamuj të shtetit, por në secilin rast pozitë qendrore gjithmonë merr logoja e komisionit, zakonisht me një rresht, apo një përshkrim, i cili thotë “me të vërtetën deri në shërim” apo një slogan tjetër që zgjedhet nga komisionit, i cili vendoset në logo. Është shumë me rëndësi të përmenden edhe qasjet tjera ndaj organizimit të procedurës së hyrjes së viktimave apo personave që japin dëshmi në sallat e dëgjimit. Zakonisht ajo procedurë është plotësisht e kundërt me procedurën gjyqësore, ashtu që anëtarët e komisionit ulen, ndërsa në momentin kur viktimat apo familjarët e viktimave hyjnë në atë mjedis ata qëndrojnë në këmbë në shenjë respekti për viktimat, e pastaj ulen. Pra, janë ata anëtarë të cilët shprehin respektin për viktimat, viktimat janë boshti i ngjarjes. Vetëm do të doja të dëgjoj mendimin tuaj në lidhje me këtë çështje shumë të ndjeshme me të cilën përballen komisionet, apo ndoshta është vërtetë e ndjeshme. Kemi edhe pesë minuta dhe do të doja të shfrytëzonim këtë kohë për të dëgjuar komentet dhe përgjigjet tuaja në këtë pyetje. Nëse jo, mund të vazhdoni deri në drekë.

Një nga gjërat që keni mundur të shihni në tri përvojat është që anëtarët e komisionit filluan të qajnë gjatë dëgjimeve publike, gjatë tregimeve; keni parë Peshkopin Tutu duke qarë; keni parë anëtarin e komisionit në Peru duke qarë; keni parë edhe anëtarin e komisionit maroken. Edhe ai qante, megjithëse mbulonte fytyrën me dorë për të ndaluar lotët. Këtë e theksoj sepse ekzistojnë dy vështirime të ndryshme ndaj kësaj pyetjeje, sepse për shembull, kur Peshkopi Tutu... ndërsa në fakt kjo ishte dëgjimi i parë... në fakt kjo është fotografia... Ky ka qenë dëgjimi i parë në Afrikën e Jugut. Ky ka nxitur shumë frustrime tek anëtarët tjerë të komisionit, qendër e kritikave të mediave ka qenë edhe ajo që Peshkopi Tutu, të cilin e patë duke ulur kokën nën tavolinë, si dhe në fund, para përfundimit të dëgjimit, ngritet nga karrigia sepse ishte i ngarkuar me emocione, ndërsa kritikant dhe frustrimet bëheshin sepse mendohej që në këtë mënyrë ai po tërhiqte vëmendjen për vete, duke hequr vëmendjen nga personat që po dëshmonin. Ai dhe disa anëtarë tjerë të komisionit kishin mendim plotësisht të kundërt. Ata mendonin që një gjë e tillë ishte tejet më e mirë sesa të kontrolloheshin emocionet, ashtu që viktimat të mbeteshin në qendër të vëmendjes, sepse bëhej fjalë për viktimat dhe familjarët e tyre, e jo për anëtarët e komisionit

dhe emocionet e tyre; kjo ishte sekondare; Tutu dhe të tjerë deklaruan që është me rëndësi që të mos ndalohen ndjenjat deri në atë masë që të dukemi që nuk kemi fare ndjenjë, që nuk na plasi për këto tregime që na japin dhe që është me rëndësi të reagohet në mënyrë njerëzore, por arsyeja që po e përmend këtë është që komisionet duhet paraprakisht të mendojnë për gjërat që e dinë se do t'i dëgjojnë, si dhe duhet të vendosin nëse duhet, dhe si duhet, dhe deri në cilën masë do të mundohen të kontrollojnë emocionet duke marrë parasysh që të gjithë pajtohen që qendra e vëmendjes prapë duhet të jetë viktima apo familjari i viktimës që po dëshmon. Këtë pyetje e bëra sepse mendoj që është e rëndësishme, si dhe e vështirë. Por, për t'ju dhënë një pasqyrë mbi hollësitë e planifikimit dhe mendimeve në lidhje me secilin aspekt të dëgjimeve, ekzistojnë regjistra të tërë me dhjetëra faqe të shkruara mbi atë se çfarë duhet të mendojnë dhe çfarë vendimesh duhet të marrin si dhe për të planifikuar ashtu që të jenë të përgatitur, dhe kjo është njëri prej tyre: pra edhe vetë mënyra në të cilën do të reagoni emocionalisht ndaj këtyre gjërave. Pra, desha t'ju paraqes edhe mendimin që tani mund ta përmbyllim, por para se ta bëjmë këtë duhet të pyesim nëse ka ndonjë koment për fund.

V Raportet finale të komisioneve për të vërtetën

Keni parë që autorët e filmit në fund të tij kanë prekur edhe këtë çështje, çështjen e raporteve finale. Gjithashtu, në rastin e Perusë keni parë kryetarin e komisionit t'i dorëzohë kryetarit të shtetit ata libra; kjo nuk ishte vetëm një nga librat, por pesë apo gjashtë vëllime të librit, nuk po më kujtohet tash, që është raporti final. Megjithatë, tash do ta bëj një prezantim për këtë temë, e pastaj në ora 15:00 do të dalim në një format tjetër; në të vërtetë do të fillojmë diskutimin zyrtar mbi idenë e komisionit rajonal për vërtetimin dhe tregimin e fakteve mbi krimet e luftës të kryera në ish-Jugosllavi. Sandra nga Fondi për të Drejtën Humanitare do të jetë moderatorë e atij diskutimit dhe do të shohim si do të shkojë ai diskutim, por në esencë kemi ndarë një orë në fund të ditës, që pas seancës së diskutimeve mes 15:00 dhe 15:30, të mundohemi të nxjerrim disa konkludime të drejtëpërdrejta, të propozojmë hapat në vijim, apo rekomandime të cilat mendoni se duhen përmendur.

Pra, raportet finale të komisioneve të së vërtetës. Për raportet finale të komisioneve të së vërtetës mund të thuhet që deri në momentin kur komisionet nuk kanë filluar të organizojnë dëgjime publike, raportet finale kanë paraqitur segmentin më të rëndësishëm të punës së komisionit për të vërtetën. Kjo ka qenë kurorëzimi i punës së komisionit dhe në shumë raste, deri në botimin e raportit përfundimtar, njerëzit dëgjonin për atë komision, por nuk dinin më shumë për të sepse në parim ai merrej me hulumtimet e tij dhe

marrjen e deklaratave në mënyrë private, e tjera. Komisioni nuk ishte në qendër të vëmendjes deri në lëshimin e raportit përfundimtar. Pastaj, me botimin e atij raporti, vëmendja publike përqendrohej në atë raport. Tani, me fillimin e organizimit të dëgjimeve publike, deri në momentin e botimit të raportit përfundimtar komisioni e kalon kulminacionin e vet, ashtu që ai moment përpara më shumë është një qetësim i punës sesa kulmim i saj. Kjo përfaqëson fundin në kuptimin e heshtjes, sepse fuqia e dëgjimeve publike aq shumë ka preokupuar njerëzit që në momentin kur del raporti përfundimtar, ai më nuk ka atë efektin e goditjes si ai i dëgjimeve publike. Në çdo rast, ai moment ende përfaqëson momentin kyç në shumë drejtime, dhe do të flasim për arsyet pse është i tillë. Sa i përket anëtarëve të cilitdo komision për të vërtetën, trashëgimia e komisionit, përveç që shprehet me zërat e njerëzve që dëshmojnë dhe personat të cilat mbesin në kujtesën e secilit, shprehet gjithësesi me raportin përfundimtar. Tani, cilat janë përfitimet e një raporti përfundimtar? Prapë, ekzistojnë raporte përfundimtare të cilat janë të mirë, të këqij, të përgjithësuar, të shkurtë, me fotografi, vetëm tekst. Mendoj, ekzistojnë kaq shumë raporte të ndryshme, por cila është vlera e tyre themelore, cila është vlera e raportit përfundimtar? E para, për shumicën e komisioneve të së vërtetës, raporti përfundimtar shërben për shmangien e revizionizmit historik. Kuptimi i tij është që të vendoset një gjurmë autoritative. Sigurisht jo tërë e vërteta, e vërteta mbi gjithçka që ka ndodhur, vetëm një përshtkrim, shpresojmë objektiv dhe tejet i hollësishëm, si dhe gati gjithëpërfshirës i ngjarjeve nga e kaluara. Si i tillë, shpresojmë t'i shërbejë parandalimit të përsëritjes së historisë.

Raportet përfundimtare të komisioneve për të vërtetën gjithashtu në shumë raste shërbejnë edhe si burim faktesh, në lëndët penale apo civile. Për shembull, në Guatemala, raporti përfundimtar i komisionit për të vërtetën është përdorur si burim provash, jo vetëm për kallëzimin e përgjegjësive personale të një individi, por edhe në zgjidhjen e rasteve të krimeve sistematike, nëse ka nevojë të vërtetohet si element i sulmeve masive në popullsi civile në një vend të caktuar dhe në kohë të caktuar, gjitha këto janë shumë mirë të dokumentuara në këto raporte përfundimtare. Kjo gjithësesi është vlerë tjetër.

Ngjashëm me xhirimet e dëgjimeve publike, edhe raportet përfundimtare do të duhet të shërbenin si mjet për arsimin e gjeneratave të ardhme, për të arsyetuar shprehjen *kurrë më* dhe për t'i dhënë kuptim asaj. Qartësisht vlera më e madhe e raportit përfundimtar ka të bëjë me rekomandimet e tij, qëllimi i të cilave është që të zgjidhë krimet nga e kaluara dhe të ndalojë përsëritjen e atyre krimeve në të ardhmen.

Pra, në përgjithësi këto janë disa nga vlerat e mundshme të raportit përfundimtar.

Ajo çfarë do të doja të bëj është që në mënyrë praktike të përpunojë katër format e aspekteve të ndryshme të raportit përfundimtar, ndër të cilat i pari ka të bëjë me përpilimin e raportit ku ekzistojnë shumë çështje të komplikuar, pyetje interesante por ekzistojnë edhe disa sfida: aspekti tjetër ka të bëjë me përmbajtjen konkrete të raportit përfundimtar, se çfarë duhet të shkruhet në të, çfarë nuk duhet shkruar në të; aspekti i tretë ka të bëjë me shpërndarjen, publikimin dhe distribuimin e raportit final për çfarë është përgatitur, cilat janë strategjitë e difuzionit, distribuimi i raporteve përfundimtare, dhe në fund fare gjëja e katërt për të cilën do të flas janë mënyrat e zbatimit të rekomandimeve të cilat i kemi përmendur por tani do të shpalos më shumë detaje.

Kështu pra pyetja e parë. Si përpilohet raporti përfundimtar? Dhe kush e shkruan raportin përfundimtar? Dhe kjo është pyetje shumë e vështirë sepse nëse ekzistojnë 200, 300 apo 400 anëtarë të ekipit të cilët kanë marrë deklarata dhe janë takuar me viktimat por që ndoshta kurrë nuk kanë dalë në terren dhe as që kanë mbajtur dëgjime publike aëtherë, ndërsa në anën tjetër keni njerëz të cilët kanë patur role të ndryshme, ndoshta kanë futur të dhëna në kompjuter apo ndoshta janë hulmues që kurrë nuk janë takuar me viktimat por që kanë studiuar historikisht tërë kontekstin, pra si të merret vendimi se kush do të shkruaj një pjesë të caktuar të raportit duke qenë në një komision ke ekspertë të një fushe të caktuar dhe jo të një fushe tjetër. Pra këto janë gjithmonë vendime të vështira por që duhet të merren dhe kështu zhvillohet e tërë qasja. Dhe unë mendoj që qasja më e mirë është të bashkohen raportet e të gjitha atyre njësitë në kuadër të komisionit për të vërtetën, dhe komisionet zakonisht kanë nga 3-12 nënkomisione të tilla: për financa, komunikim, marrjen e deklaratave, dëgjime publike, për çdo gjë tjetër edhe për dëgjime- por duhet që të krijohen ekipe të ndryshme që nxjerrin mësimet nga pësimet e komisioneve tjera të cilat kur është dashur që të formojnë ekipin e specializuar për të shkruar raportin ata e kanë humbur urgjencën dhe kanë dështuar në kuptim, të cilat do ti kishin sikur ti kishin shkruar raportet njëzëri nga linja e paë e punës, apo ata që janë takuar me viktimat sepse humb momenti i duhur për raportet nëse punësoni një ekip të posaçme për të shkruar raportin i cili nuk e përjeton dhe nuk është afër punës së përditshme të komisionit. Dhe përveç ekipeve të ndryshme ajo çfarë është me rëndësi për një komision është të jetë multidisiplinuar dhe që ekipi i njerëzve që shkruajnë raportin të jenë multidisiplinuar që të mos përbëhet vetëm nga juristët apo historianët por që të jenë njerëz të profiëve të ndryshme. Jam jurist dhe e njoh kur një tekst është tekst ligjor dhe nuk ka asgjë më të shëmtuar sesa kur teksti duhet të jetë një memorandum ligjor. Në anën tjetër juristët nuk e pëlqejnë që teksti të jetë i tejzgatur i ngarkuar dhe i mër-zitshëm për tu lexuar, pa fakte dhe pa analiza. Dhe nga këto dolën nevojat për një qasje multi disiplinare.

Kur fillohet me shkrimin e raportit? Ekziston rreziku që komisioni të pres shumë gjatë para se të fillojë të shkruaj raportin përfundimtar? për raportet që shkruhen sot, ku janë të mijëra faqe, përfshirë këtu anekse, lista të viktimave, dëshmi dhe të tjera dhe më së paku ka nevojë për 6 muaj që të fokusoheni në raport dhe që ky të jetë aktiviteti kryesor i komisionit. Pra është mirë që të ndahen 3-6 muaj vetëm për shkrimin e raportit edhe pse kjo gjë është e vështirë për të ndarë kaq kohë. Sa i përket fuqisë së hetimeve që do të zhvillohen si dhe për logjikën e planit të veprimit që në javët e para të punës të ketë një draft të raportit përfundimtar që do të jap një orientim se çfarë do të bëhet sepse ekziston rreziku nëse fillohet vonë me këtë, të mos ketë kohë pastaj të vendoset që në raport të futen apo të mos futen disa gjëra, gjëra për të cilat nuk keni harxhuar as para as kohë deh as resurse për ti hulmuar dhe dikur bëhet vonë që të mendoni për to.

Sa do të duhet të ishte i gjatë ai raport? Natyrisht nuk ekziston një gjatësi e përcaktuar. Raportet mund të jenë të gjata apo të shkurtra, por më shpesh janë të gjata. Pjesa narrative zakonisht përmban disa qindra faqe. Gjatësia totale e raportit është me anekse zakonisht. Dhe siç e thashë anekse përmbajnë lista të viktimave dhe të dhënat elementare për ta. Dhe tani lind pyetja kush do ti lexoj 6000 faqe qofte edhe 300 faqe. Sigurisht jo të gjithë njerëzit do ti lexojnë të gjitha prandaj duhet të shkruhen një pasqyrë e lëndës. Çfarë bëjnë komisionet zakonisht? Komisionet zakonisht përgatisin versione të shkurtra ku i theksojnë disa gjana më kryesore, dëshmi apo grafikone, tabela dhe të kihet vëmendje tek mediat që gjërat më të rëndësishme, si dhe rekomandimet të përcillen në media dhe që opinioni publik të njihet me të gjeturat më të rëndësishme dhe dëshmitë. Është e pamundur që të lexohen të gjitha prandaj duhet të ketë një pasqyrë të lëndës një përmbledhje e shkurtër

Duhet të përmend edhe dy gjëra sesi duhet të bëhet një raport, dhe kjo ka të bëjë me gjuhën në të cilën shkruhet raporti dhe kjo është çështje me rëndësi. Dhe gjithmonë them se është një e arritur e pabesueshme që raporti i komisionit të Afrikës jugore është përkthyer në 11 gjuhë zyrtare. Sepse kjo është një gjë dhe punë e madhe sepse nuk është lehtë që të përputhet secila fjalë dhe mund të dalin versione paralele prandaj duhet të ketë më shumë kohë dhe raporti duhet dhe është më rëndësi të publikohet në më shumë se një gjuhë. Dhe të them edhe një gjë për mënyrën sesi duhet përpiluar raportet. Dhe kjo ka të bëjë me atë se kush e merr përgjegjësinë për të draftuar atë raport apo të drejtat autoriale mbi atë raport. Në aspektin ligjor janë anëtarët e komisionit që janë përgjegjës për raportin. Dhe nganjëherë nuk ka patur ujudi nga anëtarët e komisionit për përmbajtjen e raportit përfundimtar dhe kështu shfaqet një çështje e ndjeshme: çka nëse një anëtar

komisioni dëshiron që të shënoj ndonjë mendim të vetin sepse për atë person është me rëndësi për të treguar se ka pikëvështrime të ndryshme

Por një gjë e tillë mund edhe të ulë autoritetin e gjetjeve të raportit nëse ke anëtarë që nuk pajtohet me fakte të caktuara. Kjo rrallë ka ngjarë por gjithsesi është doçka që kërkon të mendohet. Mospajtimi në mesin e anëtarëve të komisionit nuk duhet nënvlerësuar nëse shfaqet. Por këto janë gjëra që duhet të kihen parasysh gjatë përpilimit të raportit.

Kur është në pyetje përmbajtja e raportit përfundimtar ekzistojnë dy gjëra , konkluzione në lidhje me faktet dhe rekomandimet. Sa i përket përmbylljes, këtë e bëjnë komisionet tani më shumë se përpara, dhe jo vetëm që nxjerrin konkluzione por edhe në metodologjinë e punës ata fusin shumë detaje. Kjo është shumë me rëndësi sepse gjithmonë do të ketë njerëz qe do të donin të vënin në pikëpyetje besueshmërinë e raportit dhe kjo varet nga cilësia e metodologjisë me të cilën siguroheni që mos të bëhen gabime po të tregohet anshmëri gjatë hetimeve, sepse nuk mund të studiohet tërësia, ka aq shumë krime dhe ka aq shumë qasje të ndryshme metodologjike prandaj është shumë e rëndësishme ti përkushtoheni këtij problemi me një kaptinë të tërë në raport.

Lidhur me përmbajtjen kur kam përmendur që në Guatemalë lka patur një risi ku përveç analizave janë futur edhe deklaratat e papërpunuara të njerëzve që iu kanë dresuar komisionit, nga radhët e viktimave dhe familjeve të viktimave. Për shembull një kaptinë e posaçme në atë raport *Maria Jimenez* apo diçka e ngjashme me të, thjeshtë ka emrin e viktimës si kaptinë dhe pastaj ka tregimin përkatës. Sot shpesh kjo është pjesë përbërëse e raportit për të bërë baraspeshën e analizës dhe dimensionit kuantitativ dhe me aspektin kualitativ që hyn më thelle. Ti kthehemi edhe njëherë çështjes së emrave, publikimeve të përgjegjësve individuale. Të themi që disa komisione kanë një përgjegjësi të tillë dhe disa të tjera edhe jo. Kur komisioni ka një përgjegjësi të tillë të shpalos disa përgjegjësi individuale- të cilat nuk paraqesin fakte juridike, por mund të kenë ndikim në reputacionin e njerëzve . Dhe këtu mund të diskutohet nëse këta persona kanë mundësi të shohin këto fakte dhe të japin anën e tyre të tregimit para publikimit. Një gjë e tillë duhet të ndohë. Por ka këtu edhe pyetje të tjera. Për shembull cili është standardi i fakteve të cilën do ta zbatoj komisioni nëse vendos që të filloj me gjetjen e fakteve të përgjegjësive të tilla? Nuk bëhet fjalë këtu për gjykimet për vepra penale Ndërsa në anën tjetër këtu ku ka garancione për siguri si në gjykata Pra cili është standardi i fakteve?sa kohë paraprakisht mund të njoftohet përpara se të publikohen të gjeturat? A mjaftojnë 30 dite? A mjafton 3 muaj në krahasim me peshën e veprave që ia përshkruani individit?do të duhet që atyre personave të ju jepet mjaft kohë që

të japin një përgjigje të detajizuar . Ndërkohë që duhet të kemi parasysh që një përgjigje e detajizuar gjithashtu mund të shtojë përgjegjësitë e juaja si komision që të hulumtoni dhe të mundni atë version gjë që merr kohë. Duke i bërë të gjitha këto njëkohësisht të gjitha këto aktivitete dhe ju i keni gjashtë muaj për tu përqendruar të shkruani këtë raportin përfundimtar. A do të ketë të drejtë personi të ketë revidim të rastit në gjykata? Dhe sigurisht po , personi mund të dalë në gjykatë kur raporti të ketë dal dhe komisioni më të mos ekzistojë. Por këto janë çështje praktike të cilat kërkojnë ndonjë përgjigje. Në thelb ekziston tendenca , ka patur raste më herët, që komisioni në vend se të janë të gjeturat e vet për përgjegjësitë individuale në raport të fus disa anekse me lista konfidenciale për përgjegjësishin institucionale dhe ti doreyojë ato tek autoritetet në mënyrë të fshehtë me nevojën e kallëzimeve penale. Këto janë disa prej rrugëve dhe veprimeve që kanë ndërmarrë komisionet.

Çfarë ndodhë me faktet e përgjegjësishin institucionet? Komisionet gjithmonë arrijnë edhe aq larg që të gjejnë dhe të dëshmojnë një farë forme të përgjegjësive institucionale, dhe kjo është e rëndësishme dhe paraqet një prej mënyrave sesi komisioni e ndihmon punën e gjykatave sepse gjykatat kanë përgjegjësi që të vërtetojnë përgjegjësitë individuale përveç gjykatave ndërkombtare të cilat verifikojnë përgjegjësitë e shtete e, por kur kemi të bëjmë me vepra penale atëherë kemi të bëjmë me përgjegjësi individuale dhe komisionet mund të kontribuojnë mjaft në dhënien e një pasqyre të përgjegjësishin institucionale përmes përgjegjësishin së individëve. Si?

Në rregull do ti jap edhe disa gjëra për përfundimet e komisionit lidhur me përmbajtjen dhe pastaj kalojmë tek rekomandimet. Dhe kjo ka të bëjë me identifikimin e viktimave. Disa viktimat nuk dëshirojnë që emrat e tyre të përmenden në raporte, të tjerë nuk dëshirojnë që tregimet e tyre të publikohen në raport. Dhe tash ju keni një situatë ku duhet të bisedoni me 17.000 deri 30.000 individë dhe kur për herë të parë flisni me ta të keni pëlqimin e tyre . dhe duhet ti pyesni dhe ju duhet të parashikoni gjëra të tlla sepse nuk do ti keni gjithmonë adresat dhe kontaktet e atyre personave që ti pyesni për shembull a mund ta publikojë emrin apo storien tende në raport? Pra ka aq shumë gjëra për të cilat duhet menduar në fazat e para. Ndërsa në parim , është parimi operati i cili gjithashtu duhet të ketë pëlqimin dhe ujdinë.

Pjesë e raportit përfundimtar me rekomandime zgjon një sërë pyetjesh strategjike, Dhe unë mendoj që komisionet gabojnë kur japin shumë rekomandime të tepërta. Ndoshta ata dëshirojnë.. në një anë ata kanë zbuluar shumë probleme gjatë hetimeve të tyre dhe ndjenjë për obligim të japin sa më shumë rekomandime. Por çfarë ngjan? Natyrisht nëse ju dilni me 350 rekomandime atëherë mund të mendoni

se qeveritë me lehtë i injorojnë ato dhe e kanë vështirë të kuptojnë se cilat rekomandime kanë prioritet. Dhe tani kur kemi pervojën e komisioneve tjera para vetes, kur ata kanë dhënë qindra rekomandime shohim se ato nuk janë përfillur apo fare pak është punuar. Komisionet në ditët e sotme kanë strategji më të mira dhe edhe kur dëfalin me shumë rekomandime ata i japin prioritetet, prioriteti një, dy duke treguar se cilat gjana duhet të kenë prioritet gjatë zbatimit dhe cilat rekomandime marrin më shumë. Pra ka aq shumë çështje strategjike lidhur me këto dhe duhet që të ketë një konensus në komision jo vetëm për rekomandimet por edhe cilat rekomandime kanë prioritet. Dhe duhet planifikuar edhe buxhetin për diskutime të tilla.

Gjëja e vetme që do ta them lidhur me idenë e formimit të organit monitorues për implementimin e rekomandimeve. Dy apo tri komisione më herët kanë deklaruar që do të ketë organ për monitorim por nuk e kanë paraparë me kohë dhe nuk i kanë dhënë mandat. Nuk mund të thuash që do të ketë komision për monitorim pasi të zhvillosh fazën e hetimeve. Dhe është një gjë tjetër që komisioni të përfundojë hetimet e pakryera dhe një gjë tjetër që të kesh një komision mbikëqyrës për implementimin e rekomandimeve.

Ky ishte vetëm një sqarim sa i përket kësaj pike dhe tani aspekti i tretë i raporteve përfundimtare. Siç e përmenda më herët, do të doja të bisedonim për çështjen e publikimit dhe distribuimit të raporteve përfundimtare.

Nganjëherë nuk publikohen fare këto raporte apo publikohen me shumë vonesë pas shumë; vitesh mund të themi që ekziston që në fillim të mandatit obligimi për të publikuar raportin menjëherë pasi ti dorëzohet qeverisë. Është me rëndësi që të ekzistojë një obligim i tillë i shprehur.

Çfarë në lidhje me shpërndarjen e raporteve të tilla? Së pari prodhimi kushton, kushton edhe shtypja dhe distribuimi mund të mos kushtojë shumë por ndodhë që strategjia e prodhimit dhe botimit të mos kalkulohet mirë dhe të realizohet dobët dhe tani është mundësia që raporti të vihet në portalin e internetit por vite më parë u desh shumë kohë përpara se ato të arrijnë në biblioteka apo universitete, kisha dhe për financimin e këtyre gjërave duhet menduar paraprakisht, dhe në mënyrë konkrete dhe të sigurojë nga një kopje për secilën viktimë apo familjar. Unë mendoj që një gjë e tillë duhet të sigurohet edhe pse kjo lehtë mund të thuhet por është më vështirë të realizohet për shkak të buxhetit dhe nga fakti që secila familje apo viktimë ia kushton së paku një orë nga koha e vet dhënies së dëshmimeve në mos tjera atëherë mendojë që më e pakta që mund të bëhet për ta është që tua japin një kopje nga raporti përfundimtar. Por kjo nënkupton që duhet të porositen së paku 50.000, 60.000, apo 70.000 kopje për personat. Kaq për këtë temë.

Gjëja e fundit që desha të përmend është kaptina në lidhje me zbatimin e rekomandimeve, dhe kjo është një

kyçe. Është mendoj fatkeqësi kur njerëzit 3 vite pas publikimit të raportit dalin dhe thonë 'rekomandimet nuk janë implementuar dhe e tëra ishte vetëm humbje kohe'. Dhe kjo shkon shumë larg, sidomos nëse komisioni ka angazhuar një opinionin dhe vëmendjen e tyre në një proces të gjatë madje edhe në gjëra interaktive siç mund të jenë ekspozitat me fotografi, gara artistike etj... komisioni maroken ka organizuar shfaqje nëpër tërë vendin me temë në këto probleme. Ka aq shumë gjëra që mund ti bëjnë vet artistët dhe që në fund të mësohet që rekomandimet nuk po implementohen është një gjë e tmerrshme. Komisioni i bën rekomandimet dhe në fund duhet që institucionet dhe shoqëria qytetare të angazhohen. Është edhe një shembull, sërish nga Maroku. Ata kanë marrë një vendim shumë të mençur, dhe duke qenë që qeveria morekene dhe komisioni ka thënë, 'implementimi i rekomandimeve është paraqitur pikë e dobët në shumë raste, ne nuk dom që kjo të ngjajë, çfarë të bëjmë?' dhe ata vendosën që, 'ne do të fillojmë bisedat me partitë politike, institucionet publike, ministrinë e shëndetësinë, ministrinë e drejtësisë që të bisedojmë me ta dhe të na japim garanci përpara që do ti përbushin rekomandimet'. Pra një mënyrë për të zgjidhur këtë problem është që disa hapa të ndërmerren paraprakisht. Dhe konsideroj që për shkak të kredibilitetit të tyre dhe ekzistimit të garancioneve paraprake angazhohen më shumë për zbatimin e këtyre rekomandimeve.

Edhe një gjë tjetër, prapë kërkoj shumë leksione dhe ato mund të gjenden.

Përfundimisht, një gjë tjetër lidhur me rekomandimet dhe ato kanë të bëjnë me riparimet në kuptim të kompensimit, rehabilitimit, kërkimit të faljes, ri-konstituimit të së drejtës, lirisë, pasurisë etj. Si dhe akteve simbolike, qendra-ve memoriale, ngritja e përmendoreve, varrimet sepse ato paraqesin kërkesat urgjente të viktimave. Aty është edhe çështja e rëndësisë së drejtësisë, kur gjykimet ndoshta edhe janë kryer apo janë në proces e sipër dhe kërkojnë angazhime financiare urgjente dhe mund të them se shpesh riparimet nuk janë në shumat që i sugjeron komisioni. Prandaj disa shtete kanë marrë përgjegjësinë që të implementojnë programe të riparimeve urgjente apo riparimeve të përkohshme, por mund të shtrohet pyetja të si të riparohet zhdokja e përnjëhershme e dikujt? Nuk ekziston ndonjë mënyrë e veçantë por akoma ka çfarë të bëj shteti për të ofruar një riparim urgjent. Shumë njerëz kanë humbur duart, këmbët pjesë tjera të trupit dhe janë paaftësuar dhe si riparim urgjent nga qeveria ka qene sigurimi i protezave që ata të aftësohen për ndonjë punë. Natyrisht të kërkosh falje nuk kushton asgjë edhe pas publikimit të raporteve. Dhe qeveritë pas kërkimit të faljes kanë marrë masa për implementimin e rekomandimeve dhe pikërisht këto rekomandimet me implikime financiare janë rekomandimet më të vështira që duhet ti merr komisioni.

Në çdo rast, ka akoma shumë gjëra të pathëna, por le të themi që do të mund të bëjmë diçka për këto 10 minuta para se të kalojmë në seancë të hapur, sepse mund të përmbyll këtu meqë kam dhënë një pasqyrë të tërësishme mbi gjërat më me rëndësi dhe përvojat e disa komisioneve për të vërtetën dhe nga disa vende edhe ka çfarë të mësohet. Po ndalem këtu dhe po ju kërkoj nëse keni ndonjë koment apo pyetje..

*

Për këtë kemi biseduar dje dhe ndoshta do të mund të zgjerohesha pak lidhur me të sepse konsideroj që është një përvojë tipike e ekzistimit të shumë presioneve të ndryshme, nganjëherë presione nga jashtë, nganjëherë presione të brendshme brenda sektorëve të caktuar të qeverisë, ndoshta kjo bëhet për të gjetur arsye, argumente se si është në interes të të një qeverie të caktuar që të themelojnë një komision të tillë. Do të flas për Marokun, por ndoshta do të shtojë edhe disa gjëra të përgjithshme. Në Marok kjo ishte pikërisht parashikimi i shoqërisë civile; kjo ka qenë 90% e arsyes. E këni parë atë njeri. Emri i tij është Tristem Zekriem dhe ai tani fatkeqësisht është i vdekur, por ai ka qenë kryetar i Komisionit për të vërtetën në Marok dhe ka qenë njeri vizionar, ai e ka kuptuar para shumë viteve para themelimit të komisionit që Maroku ka nevojë një proces i tillë. Ai në fakt kishte vendosur që të lëshojë punën dhe për një vit të studiojë komisionet për të vërtetën. Në Angli kishte magjistruar gjashtë vite para themelimit të komisionit, bile edhe para se mreti i ri të fillonte të mobilizonte në masë të duhur shoqërinë civile për fillimin e punës për themelimin e komisionit për të vërtetën. Por atje kishte ekzistuar edhe një faktor i cili i kishte ndihmuar mjaft Marokut. Ai në disa raste kishte ekzistuar edhe në vende tjera. Pikërisht në qeverinë e tyre..., pra në Marok ekziston monarki kushtetuese por edhe qeveria. Pushtetin kryesor e mbanë monarku, por pushteti i ligjvënies atje i përket kuvendit, dhe në kuvend në atë kohë kishte mjaft njerëz që i përkisnin të së majtës së mëhershme, që kanë qenë pjesëtarë të një grupi, i cili në të kaluarën ka qenë i ndjekur dhe kjo ka paraqitur një presion të brendshëm i cili gjithashtu ka qenë i dobishëm. Pra ka qenë një situatë e tillë, por gjëja themelore siç thashë se, në përgjithësi besoj që kërkohet një përzierje e vullneteve dhe përpjekjeve si në nivel të shoqërisë civile ashtu edhe në nivel të shoqërisë politike dhe aty ku ka nevojë edhe në nivel ndërkombëtar. Besoj që sot nuk do të ekzistonte komisioni për të vërtetën në Liberi nëse qeveritë e huaja nuk do të kishin bërë presion, e posaçërisht OKB-ja, që marrëveshja për paqe të përbajë dispozita të tilla. T'ju them të vërtetën ekzistojnë shumë shembuj të ndryshëm dhe në fakt nuk ekziston një rrugë standarde drejt arritjes së këtij qëllimi, por shoqëria civile...Nuk mund ta kujtoj asnjë shembull në të cilin shoqëria civile nuk e ka luajtur rolin kyç në themelimin, krijimin e ideve dhe momentit për themelimin

e komisionit dhe në disa raste iu është dashur që të punojnë edhe me vite të tëra në mënyrë që të marrin mbështetjen e popullatës për këtë ide, dhe si parim, sa më e mirë që të jetë strategjia, aq më të mira do të jenë rezultatet. Nëse grupet e shoqërisë civile, nëse ekziston një koalicion i gjerë, nëse ekziston strategji e mirë mediale, nëse ekziston kontakt i drejtpërdrejt me njerëzit me qëndrime të ngjashme brenda qeverisë, të cilët pastaj mund ta ndër marrin shkopin, do të thosha se do të vijë deri të krijimi i strategjisë, kurse pastaj është e nevojshme që të dihet se kur është momenti i duhur, dhe siç e thash dje, mendoj se përderisa ekziston qëndrimi që e kaluara paraqet pengesë për të ardhmen, atëherë konsideroj që gjithmonë ekziston mundësia për fitimin e mbështetjes së publikut për një ide të tillë. Kjo është bindje personale e imja.

*

Do të tërheq një paralele ndërmjet Marokut dhe Perusë. Në Marok ka ekzistuar një marrëveshje, dhe asnjëherë ndonjë marrëveshje me shkrim, por ka ekzistuar një marrëveshje ndërmjet komisionit dhe mbretit e ky ka qenë që komisioni në analizat e tij mund të shkojë lart sa të dojë të takohet me kë të dojë dhe me ta të flasë për çfarëdo që dëshiron, të iu lejojë që të zbulojnë emrat e kryerësve, por të mos publikojnë gjetjet e tyre me emrat e individëve, si dhe të mos shkojnë shumë larg me akuzat e tyre ndaj monarkisë. Mendoj se kështu ka qenë rasti dhe se ka ekzistuar një marrëveshje e tillë dhe do të thoja që kjo në parim ka qenë një marrëveshje politike. Tani konsideroj se është në rregull që njerëzit të kritikojnë atë marrëveshje, por gjithashtu konsideroj që duhet ta pranojmë faktin që një marrëveshje e tillë ka çuar drejt rezultateve të duhura, gjë që nuk e pakëson kritikën por jep një vështrim tjetër mbi këtë problem. Si rezultat i punës së komisionit të është zgjidhur secili rast i personave të zhdukur, viktimave të zhdukjeve të dhunshme, përveç 65 rasteve. Komisioni e ka shkruar emrin e secilit keqbërës, që është emëruar gjatë intervistimeve dhe secila nga këto dosje ju është dorëzuar organeve publike. Secili person që ka ardhur në komision, pjesëtarët e familjeve të viktimave apo vetë viktimat që kanë vuajtur nga krime të ndryshme, kanë pranuar dhe ende pranojnë shumën të ndryshme parash në emër të kompensimit. Nuk e di shumë në saktë por bëhet fjalë për disa qindra miliona euro gjithsej për riparimin e dëmeve të paguara nga monarkia për individë të caktuar. Gjithashtu ka ekzistuar edhe skema e riparimit të dëmit për komunitetet e cila është duke u realizuar tani. Tani janë bërë reformat në sektorin e sigurisë, reforma në ligjvënie, dhe një sërë gjërash tjera. A janë ndjekur penalisht kryerësit? Jo. A munden që edhe më tutje të ndiqen penalisht? Po sepse nuk ekziston amnistia. Përse nuk ka pasur asnjë gjykim deri më tani? Nuk e di dhe nuk ka arsytim përveç se komisioni e ka vlerësuar që edhe po të ekzistonte vullneti për ndjekjen penale të kryerësve,

nuk do të kishte gjykime të drejta dhe ata prapë do të lir-oheshin. Gjëja e parë që duhet ta bëjmë është reformimi i gjyqësorit dhe pastaj duhet të organizojmë gjykimet dhe kështu po thonë edhe ata. Tani kjo mund të kritikohet nga perspektiva të ndryshme, por konsideroj që është e nevojshme të dihen të gjitha, si gabimet ashtu edhe lëshimet, por edhe rezultatet reale. Por sipas mendimit tim po të mos kishte qenë komisioni dhe kjo marrëveshje politike nuk do të kishte as rezultate.

Tash të shohim shembullin e Perusë. Një shembull plotësisht tjetër. Në Peru komisioni me të gjitha forcat është munduar të atakojë çdo individ të përzier në krime, madje edhe tërthorazi çdo institucion dhe parti politike gjithashtu e ka atakuar. Kanë prodhuar një raport shumë të fuqishëm. Por fatkeqësisht raporti ka patur efekte kontraproduktive. Me fjalë të tjera komisioni nuk ka bërë kurrfarë marrëveshje politike. Ajo ka patur lirinë në çdo kuptim dhe ka patur sovranitet. Në mënyrë të pavarur ka marrë vendime dhe ka hetuar si ka dashur, ka paraqitur faktet për përgjegjësinë individuale, përgjegjësinë institucionale, ka organizua 350 raste dhe i ka dorëzuar atp tek prokurorët publik. Pra janë mbajtur shumë gjykime. Ndërsa reparacioni ka qenë katastrofal. Qeveria në fjalë ka qenë qeveria kur Toledo ka qenë kryetar, dhe ai ka qenë kryetari i cili e keni parë ka marrë raportin. Ai është kryetar i cili ka trashëguar një komision. Por kjo ka qenë shumë e komplikuar. Qeveria e përkohshme ka formuar komisionin, Toledo është zgjedhur ka trashëguar komisionin dhe para se ai të përfundonte mandatin e tij komisioni ka përfunduar punën dhe ka dhënë raportin ku është kritikuar qeveria e Toledos si dhe çdo parti tjetër politike. Çfarë ndodhi pastaj? Alan Garcia, zëvendësoi Toledon në funksion dhe u zgjodh kryetar. Si edhe partitë tjera, partia e tij ka qenë e atakuar me raport dhe ai pastaj i ka deklaruar komisionin dhe ka kërkuar falje' ne nuk kemi asgjë me këtë kjo ka qenë vetëm një lojë politike'. Dhe nuk ekziston asnjë parti politike as sot e kësaj dite e cila sinqerisht mbështet një komision apo rezultatet e këtij komisioni, por prapë mendoj që është tepër herët të vlerësojmë këtë proces sepse besoj që gjërat do të realizohen me kohë por natyrisht janë këto 'dilema djalli', kur duhet të vendosni sesa kritik duhet të jeni, a praktik duhet të jeni, në cilat kompromise duhet të pajtoheni dhe a do të mbeteni kritik deri në fund? Rasti i Timorit Lindor është i ngjashëm. Është publikuar raporti me shumë kritika dhe kryeministri e ka pranuar dhe një orë të plotë ka deklaruar sesi ky raport e ka lënduar dhe frustruar. Por këto zgjedhje i ka bërë komisioni dhe këtë do ta bëj përherë. Vetëm desha të sqarojë që janë këto zgjedhje të vështira që duhet të bëhen: Tash është ora je 15:05 dhe kështu mendoj është koha që fjalën t'ia jap Sandrës, dhe unë do të ulem.

VI Komisioni rajonal për ish Jugosllavinë

Do provojë të jem sa më i shkurtër, mirëpo do doja të flas nga perspektiva e dikujt që nuk jeton këtu, dh t'i vë në pah disa gjëra të cilat i kam mësuar gjatë këtyre viteve të fundit si dhe gjatë këtyre dy ditëve të fundit meqenëse jam i angazhuar që të provoj ta ndihmoj dhe përcjell këtë proces. Para kësaj më lejoni që t'ju falenderohem përkthyesve. Ndonjëherë harroj ta bëjë këtë. Mirëpo, ajo më e rëndësishmja që desha t'ua them është se ju gjendeni në një fazë shumë të rëndësishme dhe mendoj se është shumë me rëndësi vet fakti se një grup e tillë po formohet është pozitive. Natyrisht, qëllimi i këtyre dy ditëve, së paku sa më përket mua, ishte që vetëm t'i prezantoj komisionet mbi të vërtetën, dhe ky ishte edhe qëllimi im, mirëpo unë personalisht kisha dëshirë ta potencoj edhe faktin se sa të kufizuara janë faktet të cilat ua kam prezantuar. Në të vërtetë ne vetëm sa e kemi gërvishit sipërfaqësisht këtë temë dhe do të doja të ju kurajoja të gjithë ju të cilët do të jeni të ndërlidhur me këtë iniciativë që ta keni parasyshë idenë e të lexuarit të sa më shumë materialeve. E di se disa nga ju tanimë kanë lexuar goxha shumë materiale sikur dhe atë se disa nga ju janë edhe ekspert në këtë fushë, mirëpo nëse nuk e bëni këtë ju do të jeni promovues shumë të dobët të kësaj ideje, ndërsa sa i përket aspekteve shumë praktike, kam dëgjuar se shumë njerëz thonë se tanimë janë të gatshëm që të veprojnë. Unë desha të përmend vetëm disa nga vrojtimitet e mia, ndërsa sa i përket asaj se sa shpejt apo ngadal duhet të reagohej, unë do të thoja se vetëm nëse ekziston arsyeja për të ngadalësuar, se përndryshe duhet të shkohet shpejtë, edhe pse mund të ekzistojnë arsye të mira për shkak të së cilave duhet të ngadalësohet. Ajo që dua të them është se ju pëlqeu apo jo juve, po afrohet momenti i shkarkimit të ICTY dhe pas 2010 nuk do të mbetet as edhe një mekanizëm regjional për luftimin e mosdënimit. Kjo do të mund ta plotësonte zbrazëtirën shumë të madhe e cila patjetër do të paraqitet ngase MKTJ ka bërë mjaft, por jo sa duhet, në të gjitha aspektet mbi të cilat kemi biseduar deri më tani, kështu që mendoj se roli i kësaj iniciative është shumë me rëndësi, nëse e keni ndërmend ta zhvillonin edhe më tutje.

Edhe një sqarim. Gjithashtu ka ekzistuar edhe një diskutim mbi atë nëse kjo trupë duhet të ketë fokus regjional apo nacional. Siç e kam kuptuar idenë, kur përmendet komisioni regjional, ky komision regjional do të kishte zyra nacionale, pra, nuk është regjional e as nacional, por është edhe njëra edhe tjetra. Kështu që kjo pyetje mbi qasjen në fakte, dëshmi, etj, paraqitet ekskluzivisht në nivelin nacional ngase komisioni regjional i cili funksionon në shtete të ndryshme ka zyra nacionale. Ndërsa, zyrat e mundshme nën-nacionale, si psh. Zyra e Bonjës, ku mund ta dishë mund të sjell një vendim se zyra duhet të jetë në Federatë dhe në Republikën Serbe, mirëpo gjithë këto janë pyetje

praktike mbi të cilat jun duhet të diskutoni gjatë muajve në vijim. Gjithashtu më kanë lutur që, nëse e kam kuptuar mirë përkthimin, që të ua shpjegoj analizën time të një komisioni mbi të vërtetën i cili ka ekzistuar në regjion. Sa i përket kësaj, unë do ta përsëritja se konsideroj se është shumë e rëndësishme që të analizohet mirë pamare parasysh nëse e quajmë komision mbi të vërtetën apo nëse është kjo vetëm një iluzion i komisionit mbi të vërtetë. Mendoj se kjo nuk është e rëndësishme përderisa nga she mbujt e tillë nxirren mësim me vlerë, ndërsa për mua janë dy apo tre mësim më të rëndësishme: nën një, se sa janë të rëndësishme konsultimet që të sigurohet kredibiliteti i iniciativës. Konsultimet nuk kanë ekzistuar para se kryetari ta themelojë këtë trupë. Gjithashtu, pyetja e animit është mëse e evidente, një çështje shumë e rëndësishmeje të cilën duhet të merremi. Komisioni një-etnik e cila merret me realitetin multi-etnik është shumë e mundshme që kurrë mos të jetë kredibile; gjithashtu në këtë kontekst do të doja ta potencoj se për mua një prej leksioneve e cila e mbështetë idenë mbi komisionin regional ishte e më saktësisht e pamundur, e trashëguar, mendoj, mbase edhe gaboj, mirëpo unë kështu mendoj, pamundësia që një komision nacional të flasmbi shkaqet ose efektet të cilat i janë atribuuar shteteve tjera. Ç'është e vërteta do të thosha se rreziku më i madh, sikur të isha unë ai që do të merrte vendime do të ishin komisionet multi-etnike të cilat do të themeloheshin, para se të krijohej zgjidhja e problemit, të cilin tentoni ta zgjidhni, duke bërë garë me të vërtetat nacionale, duke mos e ngritur mirëkuptimin, tolerancën dhe një variant regional të faktëve të akceptueshme, atëher mund të lajmërohen edhe më shumë ndarje. Megjithatë, unë mund edhe të mos kem të drejtë, mirëpo për mua janë këto disa leksione të nxjerrura nga përvoja në Serbi.

Mirë, meqenëse nuk dua të flas shumë gjatë, më lejoni që t'i prezantoj vetëm edhe disa gjëra për në fund. Njëra ka të bëjë me mediet, dhe shumë nga ju e kanë përmendur, dhe ka të bëjë me nevojën për të arritur deri të opinionit i gjërë, që të fitohet përkrahja e opinionit për këtë koncept dhe ajo që dua të theksoj është se kur flasim për medie nuk duhet të fokusohemi vetëm në mediet vendore por edhe në ato ndërkombëtare. Konsideroj se mund të krijohet një pikë tjetër shtytëse me anë të fokusimit në medie, në mediet ndërkombëtare sepse asgjë më shumë nuk do t'i shtyjet apo frikësoj qeveritë të cilat nuk kanë vullnet politik që të kryejnë punë dhe të bëjnë gjëra kurajoze; gjërat dhe faktet të cilat paraqiten në editorialet dhe komentet e gazetave të mëdha ndërkombëtare mund të kontribuojnë shumë edhe

në aspektin financiar që t'i ndihmoni kësaj iniciative. Konsideroj se kjo është shumë me rëndësi, dhe kujdo që ja kam përmedhur si të tillë, ka në qenë shumë të emocionuar dhe janë pajtuar se mund të jetë e suksesshme përkundër sfidave që mund të dalin në realizimin e saj. Unë konsideroj se është shumë sfiduese dhe interesante si ide e që duhet të jetë temë e debatit jo vetëm në regjion, por edhe ndërkombëtarisht, le të them në Bruksel, ku unë jetoj, në nivel të Bashkimit Evropian.

Dhe vetëm edhe disa vërejtje përfundimtare. E kuptoj se njerëzit duan shumë shpejt të kalojnë në vepra dhe që ta shtyjnë këtë ide përpara, mirëpo më lejoni që t'ua prezantoj vetëm edhe disa mendime mbi atë se pse konsideroj se iniciativa regionale, komisioni regional dhe gjëra që njëkohësisht do të jetë edhe zyrtare është shumë me rëndësi në ngritjen e vlerave të gjithë atij mundi të investuar deri më tani. Sa i përket arsyeshmërisë së ekzistimit të një komisioni zyrtarë karshi linjës së çështjes në nivele jozyrtare, e që prapë se prapë të pranohet mundi dhe puna për vërtetësinë e fakteve të cilat janë investuar në nivelin jozyrtar. Konsideroj se është punë shumë praktike ekzistenca e listave zyrtare të viktimave, jo vetëm për shkak të listës, por për shkak të ndarjes së reparacioneve sepse, së paku nga përvoja ime me viktima dhe familjarët e tyre çoftë këtu apo diku tjetër, kjo paraqet një nevojë imediate të shumë njerëzve. Gjithashtu, përveç drejtësisë mendoj se reparacionet paraqesin një prej fushave të cilat në këtë regjion as që është iniciuar, sa i përket disa reparacioneve serioze për viktimat, deri të ajo që dikush ta kompiloj një listë zyrtare me emra të viktimave në mënyrë që komisioni ta kompiloj një dokument për qeverinë, e cila duhet të jetë pjesë e procesit, e të cilët duhet ta miratojnë këtë ide në mënyrë që ajo të funksionoj. Konsideroj se kjo do të ishte një prej arsyeve praktike të cilat do duhej së paku të përmenden. Ka dhe të tjera, mirëpo konsideroj se kjo është një pyetje shumë praktike, të cilën do ta leja vetëm si mendim.

Ndërsa sa i përket arsyes në favor të komisionit regional para atij nacional apo më shumë komisioneve nacionale, unë i kam emëruar disa nga arsyet, mirëpo një që më brengosë është ai i tejkalimit të ndarjeve, le të themi, mes, për fat të mirë, grupeve të ndryshme etnike të cilat ende ekzistojnë dhe konsideroj se ideja mbi komisionin regional mund të krijoj atë që dikush e përshkruan si mirëkuptim dhe tolerancë, dhe, mbase, janë këto terme më të mira se ai i pajtimi, mirëpo konsideroj se më parë mund të arrihet me ndihmën e një iniciative regjionale se sa të një iniciative nacionale.